



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

E

PËRFAQËSUAR

NGA

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

si Autoriteti Kontraktor

dhe

si Shoqëria Koncesionare

“.....” sh.p.k.

KONTRATË KONCESIONI/PPP

PËR

**PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA)**

2019

¹Draft kontratë, subjekt ndryshimi

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 PËRKUFIZIMI I TERMAVE

Neni 2 INTERPRETIMI I KONTRATËS

Neni 3 OBJEKTI I KONTRATËS

Neni 4 KONCESIONARI DHE SHOQËRIA KONCESIONARE

Neni 5 REFERENCAT NDAJ KONCESIONARIT DHE SHOQËRISË KONCESIONARE

Neni 6 KUSHTET PARAPRAKE, DATA E HYRJES NË FUQI DHE DATA E FILLIMIT TË ZBATIMIT TË KONTRATËS

Neni 7 MOSPËRMBUSHJA E KUSHTEVE PARAPRAKE

Neni 8 GARANCIA E KONTRATËS

Neni 9 PERIUDHA E KONCESIONIT

Neni 10 NËNKONTRATAT

Neni 11 NDRYSHIMI I KONTROLLIT

Neni 12 GARANCITË DHE ANGAZHIMET E KONCESIONARIT/ SHOQËRISË KONCESIONARE

Neni 13 GARANCITË DHE INFORMACIONI I DHËNË NGA AUTORITETI KONTRAKTOR

Neni 14 PAGESAT DHE TARIFAT

KREU 2 PRONA

Neni 15 PRONËSIA DHE PËRDORIMI I PRONËS

Neni 16 “OBJEKTET ARKEOLOGJIKE” OSE “OBJEKTET E TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 17 MATERIALET E RREZIKSHME

2 | F a q e

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

Neni 18 LEJET E NEVOJSHME

Neni 19 INXHINIERI I PAVARUR

KREU 3 DETYRAT E KONCESIONARIT

Neni 20 MASTERPLANI I AEROPORTIT, PROJEKTI I ZBATIMIT DHE PROJEKTI I ZBATUAR FAKTIKISHT

Neni 21 ZONA ZHVILLIMORE DHE ZONA E MBROJTUR

Neni 22 MENAXHIMI I OBJEKTIT DERI NË DORËZIMIN E TIJ DHE MARRJA E ÇERTIFIKATAVE

Neni 23 DEFEKTET

Neni 24 OPERIMI I AERODROMIT

Neni 25 MIRËMBAJTJA

Neni 26 AMENDAMENTET NË MANUALIN E OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES

Neni 27 DETYRIMET E SHOQËRISË KONCESIONARE GJATË FAZËS SË OPERIMIT

Neni 28 SHËRBIME TË TJERA

KREU 4 NGJARJE TE VECANTA

Neni 29 SHKAK KOMPESIMI

Neni 30 SHKAK LEHTËSIMI

Neni 31 NGJARJE E FORCES MADHORE

Neni 32 VEPRIMI MATERIAL I PAFAVORSHËM QEVERITAR

KREU 5

Neni 33 NDRYSHIMET NË LIGJ

Neni 34 NDRYSHIMET NË PUNË APO SHËRBIME

KREU 6

Neni 35 ZHDËMTIMET NË RAST PËRGJEGJESIE DHE SIGURIMI

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

Neni 36 SIGURIMI I NEVOJSHËM

KREU 7 DISPOZITA PËR PËRFUNDIMIN DHE ZGJIDHJEN E PARAKOHSHME TË KONTRATËS

Neni 37 KTHIMI I PRONES DHE PERFUNDIMI I KONTRATËS

Neni 38 ZGJIDHJA E PARAKOHSHME E KONTRATËS DHE KOMPENSIMI

Neni 39 VAZHDIMI I DETYRIMEVE DERI PËRFUNDIM

Neni 40 TRANSFERIMI I AKTIVEVE DHE TE DREJTAVE PAS PERFUNDIMIT TE KONTRATES

Neni 41 SHUMA E KOMPENSIMIT

Neni 42 LLOGARITJA DHE PAGESA E KOMPENSIMIT

Neni 43 NDËRHYRJA E AUTORITETIT KONTRAKTOR

KREU 8 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 44 KONFIDENCIALITETI

Neni 45 TË DHËNAT E KONCESIONARIT

Neni 46 TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

Neni 47 TRANSFERIMI

Neni 48 GJUHA E KONTRATËS

Neni 49 NJOFTIMET

Neni 50 TË PJESSHME

Neni 51 MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 52 LIGJI RREGULLUES

Neni 53 PËRSHKALLËZIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 54 AMENDAMENTET E KONTRATËS

Neni 55 KOSTOT DHE SHPENZIMET E PALËVE

Neni 56 KONFLIKTI I KONTRATËS KUNDREJT MARRËVESHJES/VE TË TJERA

DRAFT

SHTOJCAT

SHTOJCAT VIJUESE JANË PJESË PËRBËRËSE TË KËSAJ KONTRATE:

- SHTOJCA 1 VENDODHJA/TERRITORI I PROJEKTIT DHE TË DHËNAT E VËNA NË DISPOZICION NGA AUTORITETI KONTRAKTOR
- SHTOJCA 2 DOKUMENTET E PROJEKTIT
- SHTOJCA 3 PROJEKT IDEJA, SKICAT, PLANIMETRITË DHE GRAFIKU I PUNIMEVE, SHËRBIMET SIPAS OFERTËS SË PARAQITUR NË TENDER
- SHTOJCA 4 SHËRBIMET E AEROPORTIT
- SHTOJCA 5 TREGUESIT KYÇ TË PERFORMANCËS
- SHTOJCA 6 PREVENTIVI
- SHTOJCA 7 MODELI FINANCIAR I PARAQITUR NË TENDER
- SHTOJCA 8 SIGURIMET QE KERKOHEN
- SHTOJCA 9 DOKUMENTACIONI I TENDERIT
- SHTOJCA 10 PLANI I TARIFAVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMIT,
- SHTOJCA 11 DETYRAT KRYESORE TË INXHINIERIT TË PAVARUR
- SHTOJCA 12 MANUALI I OPERIMIT DHE MIRËMBAJTES
- SHTOJCA 13 PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR
- SHTOJCA 14 PLANI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE
- SHTOJCA 15 PËRFAQËSUESIT E PALËVE.
- SHTOJCA 16 MASTER PLANI DHE PLANI NDERTIMOR
- SHTOJCA 17 SISTEMET E LUNDRIMIT AJROR
- SHTOJCA 18 TE ARDHURAT MINIMALE TE GARANTUARA DHE PRAGU PER NDARJEN E TE ARDHURAVE

Çdo referencë në shtojcë nënkupton një shtojcë të kësaj kontrate, përveç nëse është përcaktuar ndryshe.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si me i suksesshmi.

Shtojcat : 2, 6, 11, 12, 13, 14, 16 dhe 17, bëhen pjesë e kësaj kontrate, pas miratimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë.*

DRAFT

**KONTRATË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP
PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA)**

PALËT:

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si ministria përgjegjëse për infrastrukturën (në vijim “**Autoriteti Kontraktor**”), përfaqësuar nga.....; dhe
2. **Shoqëria Koncesionare (SPV)**, “.....” sh.p.k., me numër identifikimi (NUIS):me adresë në, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, përfaqësuar nga

Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare do të referohen në këtë Kontratë secili si “**Pala**” dhe së bashku “**Palët**”, sipas varianteve të tyre gjuhësore në njëjës ose në shumës, siç mund ta kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Kontrate.

Duke marrë parasysh që

Në bazë të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion /partneritet publik privat”, i ndryshuar,

Rregullores së e Ministrit të Transportit Nr.130 datë 09.11.2012 “Për certifikimin dhe regjistrimin e Aerodromeve”, si dhe Dokumentacionit të Procedurës së Tenderit,

Me anën e Urdhrit **nr.....** datë 27.11.2019 AK Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ngriti Komisionin për dhënie me koncesion/PPP “**Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) nga Koncesionari te AK**”

Autoriteti Kontraktor fton ofertuesit për të paraqitur ofertat e tyre, për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktor pas përfundimit të periudhës së kësaj kontrate koncesioni.

Kjo Kontratë pasqyron, ndër të tjera, kushtet bazë të Koncesionit sikundër do te përcaktohet edhe në ofertën e paraqitur nga ofertuesi i përzgjedhur si me i suksesshmi (koncesionari) në Datën e Paraqitjes së Ofertës.

DRAFT

NENI I

PËRKUFIZIMI I TERMAVE

Në lidhje me këtë kontratë vlejné përkufizimet vijuese, përveç nëse lënda ose konteksti kërkojnë interpretim tjetër:

“**Autoritet Kontraktor**” është Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

“**Autoritet Përkatës**” janë entet, agjencitë, autoritetet, organizmat ose Personat shtetërorë, bashkiakë, kombëtarë, rajonalë ose vendorë që ushtrojnë aktivitetet në Republikën e Shqipërisë dhe/ose kanë autoritet dhe kompetencë për të ushtruar tagrat zyrtarë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

“**Autoriteti i Aviacionit Civil**” (AAC) nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë, i themeluar me Ligj Nr.10 233, datë 11.2.2010, “*Për Autoritetin e Aviacionit Civil*” të ndryshuar, dhe ka autoritetin dhe përgjegjësitë e përshkuara në Ligjin e Zbatueshëm, ose cdo pasardhës i tij.

“**Albcontrol**”- nënkupton shoqërinë që menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore Shqiptare (FIR), në përputhje me standartet ndërkombëtare të lundrimit ajror, ose çdo pasardhës i tij.

“**Avion**” është një mjet, i cili mund të qëndrojë në atmosferë nga kundërveprimi i ajrit, përveç kundërveprimit të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës

“**Avionë civilë**” janë të gjithë avionët, përjashtuar avionët shtetërorë

“**Avionë shtetërorë**” janë avionët e përdorur në shërbimet e forcave të armatosura, doganës dhe policisë

“**Aerodrom**” është një zonë e përcaktuar (duke përfshirë çdo ndërtesë, instalim, dhe pajisje) në tokë ose mbi ujë, ose mbi një strukturë fikse në tokë, fikse në det, ose strukturë lundruese që do të përdoret tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen e avionëve mbi sipërfaqe.

“**Aeroport**” është një aerodrom me aktivitetet dhe facilitetet të zgjeruar, kryesisht për transport ajror tregëtar.

“**Borxh i Pasiguruar**” ka kuptimin e borxhit të pasiguruar që i jepet Shoqërisë Koncesionare nga Ortakët e saj ose shoqëritë e lidhura direkt ose indirekt me to.

“**Braktisje**” ka kuptimin e ndërprerjes të Punimeve të parashikuara në Kontratë, përgjatë një periudhe prej Ditë Pune të njëpasnjëshme. Dështimi për të kryer Punimet ose të një pjese të Punimeve brenda afateve të përcaktuara në Kontratë, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të Autoritetit Kontraktor apo në rast të një Ngjarjeje të Forcës Madhore, nuk do të konsiderohet si Braktisje.

“**Certifikata e Aeroportit**” është një dokument i lëshuar nga AAC, e cila dëshmon se aeroporti plotëson të gjithë standardet dhe kërkesat e lidhura me operimin dhe facilitetet e tij dhe se ai ka aftësinë për të përmbushur në vazhdimësi këto standard dhe kërkesat e aplikueshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës.

“**Certifikata e Përdorimit**” janë certifikatat e nxjerra (përfshirë certifikatat paraprake), ose lejet e shfrytëzimit, në përputhje me Ligjin, të cilat vërtetojnë përfundimin në përputhje me Standardet dhe mundësinë për përdorim të aeroportit.

“**Data e Fillimit**” ka kuptimin e dhënë në Nenin 6.7

“**Data e Dorëzimit të Projekt Zbatimit**” është Muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës.

“**Data e Hyrjes në Fuqi**” është data e përcaktuar sipas Nenit 6 të Kontratës.

“**Data e Përfundimit të Kontratës**” është data më e hershme nga sa më poshtë: Data e fundit e mbarimit të Periudhës së Koncesionit; dhe Data e Përfundimit të kësaj Kontrate e përcaktuar në përputhje me këtë kontrate.

“**Zgjidhja e Parakohshme**” ka kuptimin e dhene ne Nenin 38 të kësaj kontrate.

“**Data e Përfundimit të Punimeve Ndërtimore**” është data kur lëshohet Certifikata e Përdorimit, në përputhje me Punimet e aeroportit.

“**Data e Përfundimit Paraprak të Punimeve të Aeroportit**” është data kur lëshohet një Certifikatë Përdorimi Paraprake në lidhje me Punimet e aeroportit.

“**Defekt**” është një defekt i objektit që vjen si rezultat i mospërmbushjes sipas standardit të detyrimeve të Koncesionarit

“**Detyrimet Kundrejt Huadhënësve**” janë shumat e të gjithë komponentëve të mëposhtëm:

- a. principalit, interesave (përfshirë edhe penaltitetet për mospagesë, por vetëm atë të konstatuar përpara zgjidhjes së kësaj Kontrate si rezultat i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor), komisioneve bankare, kostove dhe shpenzimeve të bëra apo të kryera në mënyrë të rregullt apo që Koncesionari i detyrohet apo kanë mbetur pa paguar tek Huadhënësit nga ana e Koncesionarit, në bazë të Marrëveshjeve të Financimit deri më Datën e Përfundimit të Kontratës (ku përfshihen edhe kostot e pagesave në rast shlyerjeje kredie përpara kohe); dhe
- b. të gjitha shumave që Koncesionari u detyrohet Huadhënësve për shkak të zgjidhjes përpara kohe të marrëveshjeve mbrojtëse “hedging” për normën e interesit (ku përfshihen edhe kostot për shlyerje përpara kohe dhe komisionet e angazhimit të pagueshme si rezultat i kësaj) me kusht që Koncesionari dhe Huadhënësit do të mundohen në mënyrë të arsyeshme t’i zbusin këto vlera, për aq sa është e mundur.

“Ditë Pune” është çdo ditë pune pa përfshirë të shtunën, të dielën dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

“Ditë kalendarike” është çdo ditë e muajit, përfshirë të shtunën, të dielën dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

“Dokumentacioni i Autoritetit Kontraktor” është i gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, gjatë procedurës së shpalljes së Kontratës, por jo vetëm, në lidhje me Projektin.

“Dokumentat e Ofertës” është çdo dokument që ofertuesi i përzgjedhur si me i sukseshmi (Koncesionari) do të paraqesë si pjesë të ofertës gjatë procedurës konkurruese.

“Dokumentacioni Tenderit” janë dokumentet e procedurës konkurruese të hartuara nga Autoriteti Kontraktor, të publikuara në faqen elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe njoftimi i Kontratës, për ofertuesit e mundshëm në lidhje me këtë Projekt, përfshirë vlerësimet, dokumentacionet e vëna në dispozicion, dhe Projekt-Idenë si pjesë e procedurave të koncesionit/PPP në lidhje me këtë Kontratë.

“Dokumentet e Projektit” janë:

- a. Nënkontratat; dhe
- b. çdo kontratë tjetër e rëndësishme e lidhur nga Koncesionari në funksion të zbatimit të Projektit dhe të identifikuar si të tilla, në përputhje me Shtojcën 2.

“Dorëzimi i Territorit të Projektit” do të thotë dorëzimi i Territorit të Projektit nga Autoriteti Kontraktor te Koncesionari, në çdo rast të çliruar nga (i) të gjitha pengesat për të filluar Punimet, përfshirë shembjen e objekteve të shpronësuara apo objekteve të ndërtuara pa leje si dhe largimin e personave prej tyre dhe prej Territorit të Projektit apo nga të gjitha pretendimet e palëve të treta për të cilat Autoriteti është përgjegjës.

“Efekt Negativ Thelbësor” do të thotë një pasojë apo grup pasojash që veç e veç apo së bashku e bëjnë të pamundur zbatimin nga Shoqëria Koncesionare apo Koncesionari të detyrimeve të lindura në bazë të kësaj Kontrate.

“Eurokontroll” është Organizata Europiane për Sigurinë e Lundrimit Ajror

“Euro” është monedha e ligjshme e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar European, apo çdo monedhë tjetër me të cilën Bashkimi Ekonomik dhe Monetar European mund ta zëvendësojë atë.

“Ekskluziviteti” është e drejta për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) pas periudhes së koncesionit nga Koncesionari të AK.

“Garancia e Kontratës” ka kuptimin e dhënë në nenin 8 të Kontratës.

“Garancia e Ofertës” është garancia prej e vlerës së ofertës, që Koncesionari ka paraqitur në përputhje me ofertën dhe Shtojcën 3 të Dokumentave të Tenderit.

“Gjykatë” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 53.

“GSE - Pajisjet e Shërbimit në Tokë” përdoret si akronim për spektrin e plotë të automjeteve dhe pajisjeve, të cilat janë të pranishme për shërbimet ndaj avionëve në aeroport gjatë kohës midis fluturimeve.

“Huadhënës” janë institucione krediti ose financiare ose organizma të tjera të ngjashme financiare të angazhuara profesionalisht në dhënien e hua të parave, të cilat mund të jenë palë në Marrëveshjet për Financimin, ose mund të kenë të drejta në bazë të Marrëveshjeve për Financimin, dhe/ose i japin Koncesionarit financim në formë linje financimi me obligacione, borxhi me përparësi ose borxhi me të drejtë kthimi në kapital apo të ngjashëm (dhe marrëveshje mbrojtëse “hedging”) në përputhje me Marrëveshjet të tilla për Financimin dhe do të përfshijnë edhe siguruesit që lëshojnë dorëzani apo sigurime të ngjashme për këto linja financimi apo Persona të tretë që bien dakord të kryejnë Punime pa pagesë, me kusht që shumën e papaguar t’u kthehet në borxh apo Persona që blejnë dhe zotërojnë obligacione për të financuar Projektin.

“Identifikimi i Objekteve për Shpronësim” do të thotë përpilimi nga Koncesionari i një liste të pronave dhe pronarëve të tyre brenda Territorit të Projektit, të cilat në datën e firmosjes së Kontratës ndodhen të regjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (“ZRPP”) që duhen kryer procedurat e Shpronësimit dhe dorëzuar nga Autoriteti Përkatës, si dhe i objekteve të paregjistruara në ZRPP dhe që duhen prishur nga Autoritetet Kompetente si pjesë e Dorëzimit të Territorit të Projektit. Procesi i identifikimit përfshin aty ku është e mundur asistencën nga Koncesionari për hartimin e dokumentave shtesë për procesin shpronësimit.

“INSTAT” është Instituti i Statistikave të Shqipërisë.

“IATA” - nënkupton Shoqatën e Transportit Ajror Ndërkombëtar

“ICAO”- nënkupton Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil

“**Inxhinieri i Pavarur**” është Personi ose Personat e pavarur me përvojë, të huaj dhe/ose shqiptarë, të cilët kontrahohen nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me këtë Kontratë, për të mbikëqyrur Punimet dhe të cilët kryejnë detyrat e Inxhinierit të Pavarur në lidhje me objektin e kësaj kontrate koncesioni, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe Kontratës me Inxhinierin e Pavarur. Detyrat kryesore të Inxhinierit të Pavarur jepen të renditura në Shtojcën 11 të Kontratës.

“**Indikatorët Kyç të Performancës**” nënkupton, ato qëllime, parametra dhe indikatorë të tjerë të performancës në lidhje me operimet në aeroport, të listuar në Shtojcën 5 dhe “Indikatorit Kyç të Performancës” do të thotë ndonjëri prej tyre.

“**Këshilli i Ministrave**” është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

“**Kapital i Investuar**” janë shumat që Ortakët e Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare i investojnë në funksion të përmbushjes së kësaj Kontrate si Kapital Neto ose si Borxh i Pasiguruar.

“**Kapital Neto**” është kapitali i Koncesionarit, përfshirë të gjitha vlerat monetare/të pagueshme si rezultat i nënshkrimit/pagimit të kuotave/aksioneve, nga kontributet apo huatë e dhëna nga Aksionerët e tij, huatë e dhëna nga Shoqëritë e Lidhura ose kontrolluese të Koncesionarit (direkt apo indirekt), të cilat nuk rezultojnë si borxh i paguar, si dhe të gjitha asetet e Koncesionarit.

“**Kërkesa të Autoritetit Kontraktor**” janë:

- a) Kërkesat e Autoritetit Kontraktor për Punimet; dhe
- b) Kërkesat e Autoritetit Kontraktor për Shërbimet.

“**Konventa**” janë konventat dypalëshe ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Europian protokollat dhe rregulloret e aeroportit, kontrollit të trafikut ajror dhe industrive të shoqërive ajrore të nënshkruara nga ose që prodhojnë detyrime për Republikën e Shqipërisë.

“**Konventa e Chicagos**” është konventa për aviacionin civil ndërkombëtar, e hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944, si dhe ndryshimet dhe shtojcat e saj, të pranuar ligjërisht nga Republika e Shqipërisë.

“**Kompesimi i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor**” është shuma e barabartë me vlerën kumulative të:

- a. Detyrimeve Kundrejt Huadhënësve për këtë kontratë;

- b. Vlerën e Punimeve të realizuara deri në momentin e ndërprerjes së Kontratës për shkak të mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor, vlerën e detyrimeve ndaj të tretëve që lindin nga kjo Kontratë dhe që Koncesionari u detyrohet, përfshirë edhe fitimin e munguar të Koncesionarit, deri në datën e ndërprerjes së Kontratës, të rakorduar nga Inxhinieri i Pavarur;
- c. Vlera e paisjeve, makinerive, sistemeve të blera ose të porositura për këtë kontratë;
- d. Pagesave për shkurtrim të vendeve të punës dhe/ose kostove të tjera të cilat Koncesionari duhet t'u paguajë punëmarrësve të tij si pasojë e përfundimit të kësaj Kontrate në bazë të Ligjit;
- e. Kostove të Zgjidhjes Përpara Kohe të Nënkontratave si dhe detyrimeve kundrejt furnitorëve;
- f. Shpenzimet apo kostot e operimit;
- g. Fitimin e munguar për periudhën e mbetur të koncesionit referuar normës reale të brendshme të kthimit. Penalitetet e parashikuara në këtë Kontratë për Autoritetin Kontraktor;
- h. Çdo dëm tjetër apo e drejtë për kompensim që i lind Koncesionarit, ose që këtij i është dashur të përballojë apo mbulojë, si pasojë e mospërmbushjes së Autoritetit Kontraktor si dhe të zgjidhjes së Kontratës për shkak të kësaj mospërmbushjeje; dhe
- i. Kthimin e Garancisë së Kontratës, pas verifikimit dhe zbritjes së ndonjë detyrimi (nëse ka) nga Koncesionari, deri në datën e Mosplotësimit nga Autoriteti Kontraktor.

“**Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës**” është shuma e pagueshme nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Nenin 41 të Kontratës.

“**Kompensimi për Zgjidhje të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore**” është shuma e barabartë me vlerën agregate të:

- a) Detyrimeve Kundrejt Huadhënësve;
- b) Vlerën e Punimeve të realizuara deri në momentin e ndërprerjes së Kontratës;
- c) Vlera e paisjeve, makinerive, sistemeve të blera ose të porositura për këtë kontratë
- d) Pagesave për shkurtrim të vendeve të punës dhe/ose kostove të tjera të cilat shoqëria koncesionare duhet t'i paguajë punëmarrësve të tij si pasojë e përfundimit të kësaj Kontrate në bazë të Ligjit;
- e) Kostove të Zgjidhjes Përpara Kohe të Nënkontratave si dhe detyrimeve ndaj furnitorëve për paisjet, makineritë, sistemet e blera ose të porositura për këtë kontratë;
- f) Shpenzimet apo kostot e operimit;
- h) Kthimin e Garancisë së Kontratës, pas verifikimit dhe zbritjes së ndonjë detyrimi (nëse ka) nga Koncesionari, deri në datën e zgjidhjes së Kontratës për shkak të Forcës Madhore.

“**Koncesionari**” ka kuptimin e dhënë në hyrje të kësaj Kontrate.

“**Kontratë**” ka kuptimin e kësaj kontrate.

“Kontrata e Inxhinierit të Pavarur” është kontrata e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur në lidhje me realizimin e detyrave të Inxhinierit të Pavarur në përputhje me këtë Kontratë.

“Kosto të Zgjidhjes Përpara Kohe të Nënkontratës” janë kostot që i kanë lindur ose do t’i lindin në mënyrë të arsyeshme Koncesionarit ose humbjet që ka pësuar Koncesionari në lidhje me Nënkontratat ose furnitorët vetëm si pasojë e përfundimit përpara kohe të kësaj Kontrate në lidhje me kostot e mëposhtme, të cilat Koncesionari duhet t’jua paguajë Nënkontraktorëve apo furnitorëve:

- a. kostot e lindura në lidhje me kryerjen e Punimeve, operimin, mirëmbajtjen ose ofrimin e Shërbimeve për aq sa këto kosto nuk mund të zbuteshin ose parandaloheshin, ku përfshihen:
 - i. kostot e mallrave ose materialeve të porositura;
 - ii. shpenzimet e lindura në rrjedhën normale të biznesit me kushte tregu në pritje të ndërtimit të Punimeve ose ofrimit të Shërbimeve;
 - iii. humbjet e lindura në lidhje me Nënkontratat që janë lidhur në rrjedhën normale të biznesit me kushte tregu, të cilat nuk mund të anulohen/zgjidhen pa humbje/kosto, sikurse parashikohet në këto kontrata;
 - iv. kostoja e zhvendosjes së pajisjeve të përdorura në lidhje me këtë Kontratë; dhe
 - v. kostoja e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punëmarrësit e prekur, në bazë të Ligjit;

me kusht që (i) Koncesionari dhe çdo Nënkontraktor të kenë bërë përpjekje të arsyeshme për minimizimin e kostove të tilla; dhe (ii) Nënkontraktorët të mos kenë të drejtë për asnjë fitim të munguar në masën që ky fitim i munguar është më i madh se fitimi që do të kishte marrë Nënkontraktori në 12 (dymbëdhjetë) muaj pas Datës së Përfundimit të Kontratës

“Ligj” është çdo akt i zbatueshëm kombëtar ose vendor, urdhëresë, dekret ose akt tjetër, rregullore, akt nënligjor ose çdo rregull, kod ose udhëzim apo licencë, miratim, leje, autorizim ose aprovim tjetër i Republikës së Shqipërisë ose i çdo entiteti ose nënndarjeje të saj, ose të një Personi i krijuar me Ligj (i pavarur ose jo), që ka juridiksionin e duhur, në masën që një akt i tillë është publikuar dhe që disponohet publikisht, dhe që është objekt i zbatimit të vendimeve të gjykatave të ndryshme dhe të trupave të ngjashme gjyqësorë të Republikës së Shqipërisë, të urdhërave, udhëzime a vendimeve të ministrave, të udhëzimeve a qarkoreve të departamenteve të ndryshme të Autoriteteve Përkatëse, si dhe interpretimet e organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, që kanë juridiksion mbi çështjen në fjalë, siç mund të ndryshohen hera herës gjatë afatit të Kontratës.

“Letër Marrëveshje – Letter of Agreement (LoA)” është marrëveshja me shkrim midis Shoqërisë Koncensionare dhe Ofruesit të Shërbimeve të Navigimit Ajror Albcontrol ku përcaktohen përgjegjësitë e palëve në lidhje me ofrimin e shërbimit(ve) të navigimit ajror.

“**Miratim i Nevojshëm**” është çdo Certifikatë Përdorimi, miratim, licensë, aprovim, lejim ose autorizim, i përkohshëm apo përfundimtar, që është i nevojshëm në lidhje me Projektin dhe që duhet lëshuar nga Autoritetet Kompetente, duke përfshirë Miratimin e Nevojshëm nga Autoriteti Kontraktor.

“**Miratimi i Nevojshëm i Autoritetit Kontraktor**” është çdo Certifikatë Përdorimi, miratim, licensë, aprovim, lejim ose autorizim, i përkohshëm apo final, që është i nevojshëm në lidhje me Projektin dhe që duhet lëshuar nga Autoriteti Kontraktor, duke përfshirë Miratimin e Nevojshëm.

“**Model Financiar**” është:

- a) Modeli Financiar i paraqitur në ofertën e Koncesionarit; dhe
- b) pas kësaj date, modeli i përditësuar në përputhje me këtë Kontratë.

“**Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktor**” është secila prej ngjarjeve ose fakteve të mëposhtme:

- a. shpronësimi, sekuestrimi, marrja në përdorim të përkohshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor, e një pjese me rëndësi të aktiveve të Koncesionarit ose të një Nënkontraktori ose i aksioneve/kuotave të Koncesionarit apo Shoqërisë Koncensionare;
- b. dështimi nga ana e Autoriteteve Përkatëse për të rimbursuar TVSH – në favor të Koncesionarit në kohë dhe në përputhje me Ligjin;
- c. kalim i Kontratës tek të tretë nga Autoriteti Kontraktor në kundërshtim me dispozitat e saj;
- d. shkelje e detyrimeve të Autoritetit Kontraktor parashikuar në këtë Kontratë që e bën të pamundur ose e pengon në mënyrë të konsiderueshme Koncesionarin që të realizojë Punimet dhe/ose Shërbimet për një periudhë më të gjatë se 1 (një) Muaj;
- e. çdo Ndryshim në Ligj i cili është i paparashikueshëm dhe që e bën të pamundur ose e pengon në mënyrë të konsiderueshme zbatimin e Kontratës nga ana e Koncesionarit apo/dhe dëmton interesin e tij financiar dhe ekonomik sipas kësaj Kontrate;
- f. çdo Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar; dhe
- g. çdo pengesë, dëm apo pamundësi e mospërbushjes së detyrimeve sipas kësaj Kontrate si rezultat i mos realizimit të Shpronësimeve të tokave/trojeve të palëve të treta, shëmbjes së ndërtesave në Territorin e Projektit, apo mos Dorëzimi i Territorit të Projektit sipas kushteve të kësaj Kontrate.

“**Mospërbushje nga Koncesionari**” janë kushtet e mëposhtme që ndodhin për faj të Koncesionarit dhe jo si rrjedhojë e veprimeve apo mungesës së veprimeve nga Autoriteti Kontraktor:

a) Shkelja e detyrimeve të Koncesionarit:

- i. prek ndjeshëm ecurinë e Punimeve dhe/ose Shërbimeve të operimit ; ose
- ii. prek ndjeshëm aftësinë e Autoritetit Kontraktor për të përmbushur detyrimet e parashikuara me Ligj dhe Kontratë; ose
- iii. prek ndjeshëm përdorimin e aeroportit nga Autoriteti Kontraktor dhe Përdoruesit;

b) Shkelje e Vazhdueshme sipas Kontratës;

- i. Në përfundim të procedurës së falimentit, vendimi përfundimtar i Gjykatës i cili pranon likuidimin kundër shoqërisë koncesionare, të lidhur me paaftësinë paguese;
- ii. Mosfillimi i Punimeve nga shoqëria koncesionare në përputhje me Projektin brenda 1 (një) Muaji nga Data e fillimit të Punimeve Ndërtimore ;
- iii. Braktisja e Punimeve nga Koncesionari; Mosrespektimi me faj i një date të përfundimit të punimeve brenda afatit përfundimtar për ato punime, sipas përcaktimeve të bëra në grafikun e punimeve pjesë e Projekt Zbatimit;
- iv. Mosnxjerrja e Certifikatës së Përdorimit/lejes së shrytëzimit për aeroportin brenda afatit përfundimtar për Certifikatën e Përdorimit/lejen e shfrytëzimit, nëse ndodh për faj të Koncesionarit;
- v. Koncesionari nuk bën fillimisht dhe në vazhdimësi Sigurimet e Nevojshme sipas Kontratës;
- vi. Koncesionari shkel kufizimet e vendosura në Kontratë për nënkontraktimin, Neni 10 dhe/ose
- vii. Koncesionari shkel kufizimet e vendosura mbi kalimin ose ndryshimin e kontrollit të parashikuara neni 11 “**Ndryshimi i Kontrollit**”.

“**Muaj**” është një muaj kalendarik gjatë Periudhës së Koncesionit. Një “Muaj” i referohet një periudhe që fillon në një ditë të një Muaji kalendarik dhe që përfundon në ditën që korrespondon numerikisht në Muajin e ardhshëm kalendarik (pa e përfshirë atë ditë), me përjashtim të rastit që, nëse nuk ka ditë që korrespondon numerikisht në Muajin në të cilin ajo periudhë përfundon, ajo periudhë do të përfundojë ditën e fundit në atë Muaj kalendarik.

“**Manuali i Aerodromit**” nënkupton manualin që do të përfshijë të gjithë informacionin për zonën e zhvillimit të aerodromit, facilitetet, shërbimet, paisjet, procedurat e operimit dhe të mirëmbatjes së aerodromit, organizimin dhe manaxhimin, duke përfshirë dhe sistemin e manaxhimit të sigurisë në operim (SMS) sipas aneksit 14 dhe SARP të ICAO.

“Manuali i operimit dhe mirëmbajtjes së aerodromit” nënkupton Manualin që përmban detaje dhe plane që nuk përfshihen në manualin e aerodromit, në të cilin do të përcaktohen detajet dhe procedurat, për operimin e sigurt dhe mirëmbajtjen e aeroportit, si dhe bashkëveprimin me palë të treta.

“MasterPlani i Aeroportit” është masterplani i aeroportit, që përgatitet nga koncesionari dhe dorëzohet për miratim te Autoriteti Kontraktues dhe/ose entitete të tjera shtetërore sipas ligjit të aplikueshëm

“Ndryshim Cilësues i Ligjit” është :

- a) Ndryshimi Diskriminues i Ligjit;
- b) Ndryshimi Specifik i Ligjit;
- c) një Ndryshim i Ligjit që ndodh gjatë Periudhës Ndërtimore, dhe operimit dhe që sjell për pasojë një Shpenzim Kapital; ose

“Ndryshim Diskriminues i Ligjit” është Ndryshimi i Ligjit, i cili zbatohet në mënyrë specifike

- a) për Projektin dhe jo për projekte të ngjashme;
- b) ose për Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare dhe për asnjë Person tjetër; ose për
- c) shoqëritë tregtare të angazhuara në projekte të ngjashme me Projektin dhe për asnjë Person tjetër;

“Ndryshim në Ligj” është ndryshimi i Ligjit që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, pa përfshirë Ndryshimet e Parashikueshme të Ligjit.

“Ndryshim nga Autoriteti Kontraktor” është ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në bazë të Kontratës.

“Ndryshim nga Koncesionari” është ndryshimi i propozuar nga Koncesionari në bazë të Kontratës.

“Ndryshim i Parashikueshëm i Ligjit” është propozimi për ndryshim i Ligjit, i bërë tridhjetë 30 (ditë kalendarike) përpara Datës së Dorëzimit të Ofertës përfundimtare në: një projektligj të qeverisë ose projektligj të paraqitur nga ministria përkatëse për konsultim dhe i bërë publik masivisht, apo i cili i është njoftuar Koncesionarit;

“Ndryshim Specifik i Ligjit” është një Ndryshim i Ligjit që i referohet specifikisht ofrimit të Shërbimeve ose Punimeve të njëjta ose të ngjashme me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë ose zotërimit të aksioneve/kuotave të shoqërive tregtare aktiviteti kryesor i të cilave është ofrimi i Shërbimeve dhe Punimeve të ngjashme ose të njëjta me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë.

“Nënkontratë” është Nënkontrata e Ndërtimit dhe/ose Nënkontrata e operimit

“Nënkontraktor” është Nënkontraktori Ndërtimor dhe/ose Nënkontraktori i operimit

Për efekt sqarimi, nëse Punimet kryhen nga Koncesionari, (i) ky i fundit nuk do të konsiderohet si Nënkontraktor, dhe (ii) nuk do të ketë nevojë që, për të’, të merret miratim nga Autoriteti Kontraktor.

“Nënkontratë e operimit” është Nënkontrata e lidhur për operimin e aeroportit apo një pjese të shërbimeve të tij, me ndryshimet dhe zëvendësimet përkatëse të bëra herë pas here në përputhje me këtë Kontratë.

“Nënkontratë Ndërtimi” është nënkontrata e lidhur ndërmjet Koncesionarit dhe Nënkontraktorit Ndërtimor për kryerjen e Punimeve apo një pjese të tyre, me ndryshimet dhe zëvendësimet përkatëse të bëra herë pas here në përputhje me këtë Kontratë.

“Nënkontraktori Ndërtimor” është subjekti i regjistruar sipas Ligjit, me seli në adresën e deklaruar në QKB dhe i përfaqësuar nga administratori apo përfaqësuesi i tij ligjor, si përfaqësues i caktuar dhe autorizuar rregullisht në bazë të Nënkontratës së Ndërtimit.

“Nënkontraktori i operimit” është subjekti i regjistruar sipas Ligjit, me seli në adresën e deklaruar në QKB dhe i përfaqësuar nga administratori apo përfaqësuesi i tij ligjor, si përfaqësues i caktuar dhe autorizuar rregullisht në bazë të Nënkontratës së Operimit.

“Ngjarje e Forcës Madhore” është një ngjarje që nuk është në kontrollin e Palëve dhe që nuk mund të parashikohet prej tyre si dhe që sjell për pasojë që Pala që e pretendon të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë (“Pala e Prekur”), përfshirë, pa u kufizuar në:

- a. çdo akt i natyrës duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në to, zjarrin, përmytjen, ose çdo katastrofë tjetër natyrore si, tërmeti, uragani, tornado ose goditja nga meteori ose nga një trup tjetër qiellor;
- b. greva, pushtimi i territorit, lufta, kryengritja, protesta më e gjatë se 48 (dyzet e tetë) orë, revolucioni, lufta civile, konflikti i armatosur, gjendja e jashtëzakonshme e vendosur me Ligj, terrorizmi ose embargoja dhe trazirat civile ose prishja e rendit civil;
- c. rrezatimi jonizues ose kontaminimi kimik apo biologjik;
- d. shpërthimet e shkaktuara nga pajisjet supersonike;
- e. shpërthimi bërthamor ose kontaminimi radioaktiv;
- f. cdo rast tjetër i parashikuar në një dispozitë të Kontratës si e tillë.

“Njoftim për Ndërprerje dhe/ose Përfundim të Kontratës” është:

- a. Njoftimi për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Koncesionari;

20 | F a q e

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit te perzgedhur si me i suksesshmi.

- b. Njoftimi për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor; ose
- c. Njoftimi për Përfundim të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore.
- d. Njoftimi për Përfundim të Kontratës Jo për Mospërmbushje, sipas rasteve të parashikuara në Kontratë.

“Njoftimi për Përfundim të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore” ka kuptimin e dhënë tek neni 31.

“Norma e Brendshme e Kthimit të Kapitalit” është norma e brendshme e kthimit të Kapitalit të Investuar të Koncesionarit, sipas përlllogaritjeve të bëra në Modelin Financiar, përfshirë ndryshimet që ai mund të ketë sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

“Numri i klasifikimit të asfaltit (PCN)” nënkupton një numër që shpreh fuqinë mbajtëse asfalti për operacione të pakufizuara.

“Njësia e Zbatimit të Projektit” (NjZP) është organi që krijohet, brenda 30 ditëve nga data e data e hyrjes në fuqi e kontratës, nga Autoriteti Kontraktues për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate.

“Materiali Potencialisht i Rrezikshëm” nënkupton ndonjë substance natyrale ose artificiale (në formë të ngurtë apo lëngshme ose në formë të gazit apo avullit) i aftë t'i shkaktojë dëm cilësdo qenie njerëzore ose ndonjë organizëm tjetër të gjallë të mbështetur nga mjedisi, ose i aftë të shkatërrojë mjedisin ose shëndetin publik ose që shfaq kërcënim për sigurinë publike duke përfshirë, pa u kufizuar në: ndonjë ndotës dhe ndonjë substancë të rrezikshme, toksike, radioaktive, të dëmshme, brejtës ose substanca të rrezikshme dhe të gjitha substancat e rregulluara, për të cilën në çdo rast të detyrueshëm ose të përgjegjshëm imponohet sipas ligjit të aplikueshëm për mjedisin;

“Objekte Arkeologjike” ka kuptimin e dhënë në përkufizimin “pasuri arkeologjike” të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

“Objekte të Trashëgimisë Kulturore” ka kuptimin e dhënë në përkufizimin “pasuri kulturore materiale” të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

“Objekte të Përkohshme” janë të gjitha strukturat dhe instalimet e përkohshme, të cilat nevojiten për ndertimin e aeroportit.

“Operatori i Aerodromit” nënkupton çdo person juridik ose fizik që vepron ose propozon të operojë një ose më shumë aerodrome

“Operator” nënkupton çdo person juridik ose fizik që vepron ose propozon të operojë një ose më shumë avionë ose një ose më shumë aerodrome.

“**Ortak**” ka kuptimin që jepet sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar apo sipas përcaktimeve të Ligjit të zbatueshëm të vendit ku është regjistruar shoqëria.

“**OSHNA**” nënkupton ofruesit e shërbimeve për navigim ajror

“**Palë**” ka kuptimin e dhënë në hyrje të Kontratës.

“**Palë e Autoritetit Kontraktor**” është veçmas Autoriteti Kontraktor dhe nëpunësit, punëmarrësit dhe agjentët e tij dhe çdo nënkontraktor apo Person i punësuar ose i angazhuar nga secili prej tyre (por pa përfshirë Koncesionarit dhe Palët Koncesionare) si dhe organet e tjera përkatëse të tjera që sipas rastit asistojnë Autoritetin Kontraktor për zbatimin e Kontratës.

“**Palë Koncesionare**” është veçmas Koncesionari, Shoqëria Koncesionare, Nënkontraktori, Përfaqësuesi i Koncesionarit, nëpunësit, punëmarrësit dhe agjentët e tyre dhe çdo Nënkontraktor apo Person i punësuar ose i angazhuar nga secili prej tyre.

“**Pista e qasjes jo-precize**” nënkupton një pistë instrumentesh që shërbehet nga ndihmat vizuale dhe një ndihmë jo vizuale që siguron të paktën udhëzime të mjaftueshme për një qasje të drejtpërdrejtë.

“**Palë e Prekur**” ka kuptimin e dhënë në përkufizimin e Ngjarjes së Forcës Madhore.

“**Paralajmërimi i Parë**” ka kuptimin e dhënë në Nenin 38.3.1 të Kontratës.

“**Paralajmërim i Dytë**” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 38.3.2 të Kontratës.

“**Periudha e Koncesionit**” ka kuptimin e parashikuar tek Neni 9 i Kontratës.

“**Periudha e Përgjegjësisë së Defekteve**” ka kuptimin e periudhës prej 12 (dymbëdhjetë) Muajsh nga data e marrjes së Certifikatës së Përfundimit paraprak të punimeve ndërtimore.

“**Periudha Ndërtimore**” janë periudhat brenda periudhës së vlefshmërisë së Kontratës gjatë të cilave realizohen Punimet ndërtimore sipas Projekt Zbatimit.

“**Periudha e Vlefshmërisë së Kontratës**” është periudha kohore që fillon me Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate dhe përfundon me Datën e Përfundimit të Kontratës, përfshirë edhe shtyrjet e parashikuara sipas kësaj Kontrate.

“**Person**” do të kuptohet çdo individ, person fizik, juridik, shoqëri tregtare, ortakëri apo organizatë e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Ligji ose ligji i një vendi tjetër, përfshirë Autoritetin Kontraktor dhe Autoritetet Përkatëse.

“**Person i tretë**” do të kuptohet çdo individ, person fizik, juridik, shoqëri tregtare, që nuk ka lidhje me asnjë nga palët dhe nuk përfshin shoqërinë e lidhur, sipas përkufizimit të dhënë në këtë kontratë.

“**Përfaqësues i Autoritetit Kontraktor**” është Personi i identifikuar për të vepruar si Përfaqësues i Autoritetit Kontraktor në bazë të Kontratës.

“**Përfaqësues i Koncesionarit**” është vetë Koncesionari ose një Personi i autorizuar me shkrim për përfaqësimin e tij.

“**PKSAC**” është Programi Kombëtar i Sigurisë së Aviacionit Civil, në kuptim të VKM Nr. 575, datë 10.02.2011, i ndryshuar

“**Problem i Trashëguar**” është çdo pretendim, kërkesë apo përgjegjësi e parashikuar me Ligj që ka ardhur nga një veprim ose mosveprim në lidhje me ndërtimin apo shfrytëzimin e bërë mbi pjesët ekzistuese të aeroportit përpara Datës së Hyrjes në Fuqi të Kontratës.

“**Procesi i Arbitrazhit**” ka kuptimin e dhënë në Nenin 53.3 të Kontratës.

“**Platformë**” nënkupton një zonë të projektuar të akomodojë avionët për qëllimet e ngarkimit ose shkarkimit të udhëtarëve, postës ose kargos, karburantit, parkimit ose mirëmbajtjes.

“**Pistë**” nënkupton një zonë drejtkëndore të caktuar në një aerodrom tokësor, e përgatitur për uljen dhe ngritjen e avionëve.

“**PRM**” nënkupton Pasagjere me aftësi të kufizuara.

“**Perimetri i rrethimit të sigurisë së aeroportit**” është perimetri i rrethimit të pandërprerë me specifikimet teknike përkatëse (Rruga Rrethuese e Aeroportit dhe Perimetri i Rrethimit të Sigurisë së Aeroportit) e cila mbyll zonën e koncesionit ose me afërsi të perimetrit të saj. Për të shmangur dyshimet, rrethime të tilla nuk kërkohen përgjatë rrugëve jashtë Zonës së Koncesionit.

“**Përdorues aeroporti**” nënkupton të drejtën e shfrytëzimit të vendndodhjes për qëllimet e projektit pa u penguar nga një person i tretë dhe pa ndonjë kërkesë monetare që mund të jetë parashtruar para datës së hyrjes në fuqi ose është çdo shoqëri ajrore me fluturime të rregullta ose dhe fluturime charter për dhe nga Aeroporti.

“**Projekti**” është tërësia e aktiviteteve të ndërlidhura për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) nga Koncesionari te AK, i përcaktuar në objektin e kësaj Kontrate sipas Projektit të Zbatimit dhe kryerja e çdo pjese

të Punimeve dhe Shërbimeve të Operimit gjatë Periudhës së Vlefshmërisë së Kontratës dhe financimi sipas ofertës së paraqitur nga Koncesionari në procedurën e koncesionit.

“Projekt Ideja” ka kuptimin e dhënë në Nenin 20.2 të Kontratës.

“Projekt Zbatimi” ka kuptimin e dhënë në Nenin 20.2 të Kontratës.

“Propozime të Koncesionarit” janë:

- a) Propozime për Punime të Koncesionarit; dhe
- b) Propozime për Shërbime të operimit të Koncesionarit.

“Punime” janë punimet ndërtimore, punimet gjeoteknike dhe çdo punim tjetër që mund të nevojitet, për t’u zbatuar nga Kompania, në lidhje me ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) sipas Projekt Zbatimit dhe MasterPlanit të Aeroportit, sic mund të ndryshojë herë pas herë në përputhje me shtojcën (MasterPlani i Aeroportit, Projekti Zbatimit dhe Punët Ndërtimore)

“Risk i Pasigurueshëm” do të thotë një ngjarje apo situatë e cila nuk mbulohet apo është e përjashtuar në kushtet e përgjithshme të kontratave të policave të sigurimit që ofrohen në tregun shqiptar të sigurimeve nga kompanitë siguroese të licencuara nga Autoriteti Përkatës.

“RFF”– Shpëtimi dhe fikja e zjarrit në përputhje me përcaktimet e Konventës së Çikagos.

“Rrugë” nënkupton një rrugë sipërfaqësore të përcaktuar në zonën e lëvizjes, e projektuar për shfrytëzim ekskluziv të automjeteve.

“Sigurimi i Kontratës” është garancia e kërkuar dhe e paraqitur në formën e kërkuar e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë /shoqëri sigurimi sipas përcaktimeve të Kontratës, me kërkesë të Koncesionarit dhe në favor të Autoritetit Kontraktor.

“Sigurimet e Nevojshme” janë sigurimet e identifikuar dhe mbajtura sipas Shtojcës 8.

“Sigurimi i Përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta” është sigurimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta që është pjesë e Sigurimeve të Nevojshme që duhen blerë dhe mbajtur në bazë të nenit 36 dhe shtojcës 8 të Kontratës.

“Situacioni” përfshin të gjitha skicat, llogaritjet, raportet etj., në format elektronik dhe të shtypur në të cilat paraqiten evidencat faktike të miratuara të ndërtimit të përditësuara për të pasqyruar vendndodhjet, madhësitë, materialet e ndërtimit dhe hollësi të tjera të Punimeve të realizuara, duke bërë lidhjen me specifikimet dhe tabelat përkatëse.

“Situatë e Jashtëzakonshme Gjeoteknike” është ngjarja e një fenomeni gjeoteknik të paparashikuar, i cili mund të ndikojë negativisht në Punimet për ndërtimin, operimin e Aeroportit, në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

“SMS”- Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë në Operim në përputhje për Konventën e Çikagos.

“SARPS”- Standardet dhe Praktikrat e Rekomanduara nga Anekset dhe Dokumentet e ICAO

“Shërbim ajror” është një fluturim ose një seri fluturimesh për transportim të pasagjerëve, ngarkesave dhe/ose postës për qëllime fitimi dhe/ose dhënies me qira.

“Shërbimet e kontrollit të trafikut ajror” gjatë Periudhës së kësaj kontrate, nënkupton, ofrimin nga Autoriteti apo Autoritetet kompetente të të gjitha shërbimeve në lidhje me kontrollin e trafikut ajror në aeroport në përputhje me ligjet e zbatueshme, rregullat, rregulloret politikat, procedurat, rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të ICAO-s, duke përfshirë, pa kufizime, të gjitha shërbimet e nevojshme;

- a) Shtyrjen përpara dhe mbajtjen e rregullt të rrjedhës së trafikut ajror si dhe të parandalimit e përplasjeve midis një aeroplani dhe aeroplanit tjetër ose pengesave në ajër apo përbrenda Hapësirës së Lëvizjes të aeroportit, duke përfshirë “route kontrollin” dhe lirimin e kontrollit të trafikut ajror.
- b) autorizimin e aeroplanëve për të vazhduar në kushte të veçanta nga një njësi e trafikut ajror, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, (i) radio lidhje me Aeroplanin nga koha kur piloti kërkon ndezje të motorit në nisje, dhe (ii) radio lidhje me Aeroplanin derisa piloti deklaron fikjen e motorit në mbërritje (aftrim, ulje),
- c) ofrimin e shërbimeve të informimit rreth fluturimit, përfshirë këshilla dhe informata të dobishme për zhvillimin e sigurt dhe efikas të fluturimeve dhe informacioneve për njësinë e trafikut ajror, në lidhje me një fluturim të synuar ose një pjesë të fluturimit të një aeroplani,
- d) njoftimin e organizatave të duhura në lidhje me aeroplanët që kanë nevojë për ndihmë në kërkim e shpëtim si dhe për të ndihmuar organizatat e tilla sipas nevojës, dhe
- e) përgjithësisht, ofrimin e shërbimeve të informimit rreth fluturimeve, shërbime këshillimore të trafikut ajror, shërbime të kontrollimit të trafikut ajror, shërbime të kontrollit të afrimit, shërbime të kontrollit tokësor, dhe shërbime meteorologjike;

“Shërbimet e Aeroportit” për kohëzgjatjen e Periudhës së kësaj kontrate, nënkupton, dispozitat nga Koncesionari të shërbimeve të listuara në Shtojcën 4.

“Shërbimet CFR” për kohëzgjatjen e Periudhës së kësaj Marrëveshjeje, nënkupton ofrimin nga Koncesionari dhe Operatori të shërbimeve të aksidenteve, zjarrfikjes, kërkim shpëtimit, shërbimeve mjekësore emergjente dhe të ndihmës së shpejtë në aeroport

“Shembja e Objekteve” do të thotë prishja nga ana e Autoriteteve Përkatëse e objekteve të shpronësuara apo objekteve pa leje që ndodhen në Territorin e Projektit pa përfshirë kostot e transportit të mbetjeve pas shëmbjes të cilat në çdo rast mbulohen nga Koncesionari.

“Shfrytëzuesit e Aeroportit” nënkupton avio-kompanitë dhe operatorët e tjerë të cilëve Koncesionari dhe Operatori do t’ju ofrojë shërbime të Aeroportit;

“Shkak Kompensimi” është:

- a. shkelje nga ana e Autoritetit Kontraktor e çdo detyrimi material të parashikuar me këtë Kontratë që e bën Koncesionarin të mospërbushë detyrimet e parashikuara me këtë Kontratë, për një periudhë më të gjatë se 10 (dhjetë) Ditë Kalendarike;
- b. dështimi nga ana e Autoriteti Kontraktor për t’i vënë në dispozicion objektin dhe siguruar Koncesionarit hyrje-dalje në objekt;
- c. Mosvënia në dispozicion e te dhenave për fizibilitetin e fluturimeve në aeroportin e Vlores, që do të merren nga Albcontrol (studimi aeronautik). Ky studim duhet të konfirmojë fizibilitetin dhe mundësinë e fluturimit në aeroport;
- d. Mosfillimi i procedurave të blerjes së pajisjeve, nga Albcontrol, brenda 3 (tre) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- e. Lidhja e zonës së koncesionit me rrjetin e infrastrukturës publike.
- f. Mosndërtimi i rrugës lidhëse me autostradën rrugore Durrës-Morinë.
- g. zbulimi i një Problemi të Trashëguar, që pengon Koncesionarin në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë;
- h. zbulimi i materialeve të rrezikshme, të paparashikueshme sipas Kontratës, që pengojnë Koncesionarin në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë;
- i. zbulimi i sistemeve të infrastrukturës publike, të paparashikueshme sipas Kontratës, që pengojnë Koncesionarin në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë;
- j. protesta që ka për pasojë mbylljen e objektit apo bllokimin e Kantierit, ose të një pjese të saj në çdo moment pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Kontratës;
- k. mungesa e miratimeve dhe lejeve të Autoriteteve jo për faj të Koncesionarit;
- l. moskryerja nga ana e Autoritetit Kontraktor e procedurave për Shpronësimin sipas Kontratës, brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e hyrjes në fuqi e kontratës, me kusht që kjo moskryerje të pengojë vazhdimin e punimeve nga ana e Koncesionarit;
- m. çdo ngjarje apo shkak tjetër që është parashikuar shprehimisht si Shkak Kompensimi në këtë Kontratë.

“Shkak Lehtësimi” është:

- a. zjarri ose shpërthimi ose çdo ngjarje e paparashikueshme e motit ekstrem (duke mbajtur në konsideratë natyrën e rajonit dhe kushtet klimatike që mbizotërojnë në rajon);
- b. humbja apo dëmtimi aksidental, që u bëhet Punimeve ose objektit

- c. mungesa ose ndërprerja e energjisë, lëndës djegëse ose transportit, bllokimi i rrugëve, porteve, aeroporteve dhe i telekomunikacioneve, ose defekte të rënda në makineri;
- d. Situata e Jashtëzakonshme Gjeoteknike;
- e. vonesa në Punime për shkak të gërmimit, largimit ose Punimeve të tjera të nevojshme të kryera në lidhje me Objektet Arkeologjike ose të Trashëgimisë Kulturore, zbulimin e infrastruktures publike, zbulimin e lëndëve shpërthyese, Forcës Madhore,
- f. greva, braktisja e punës nga punëmarrësit, ulja e tempit të punës ose çdo mosmarrëveshje tjetër zyrtare ose jo, për aq sa këto ngjarje zhvillohen në të gjithë sektorin përkatës dhe jo vetëm tek Koncesionari ose Pala Koncesionare; në çdo moment pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Kontratës;
- g. si dhe çdo rast tjetër i parashikuar në Kontratë si Shkak Lehtësimi, me kusht që, për efekt të çlirimit nga përfundimi i Kontratës në bazë të nenit 30, një ngjarje e tillë të mos jetë shkaktuar nga shkelje të vullnetshme të Koncesionarit (ose një Pale Koncesionare) dhe që një ngjarje e tillë të mos jetë shkaktuar apo ndihmuar nga veprimi ose mosveprimi me faj i Koncesionarit (ose i një Pale Koncesionare).

“Shkelje e Vazhdueshme” ka kuptimin e parashikuar në Nenin 38.3

“SHLA” nënkupton shërbimet e lundrimit ajror dhe përfshijnë manaxhimin e trafikut ajror, komunikimin, lundrimin dhe mbikëqyrjen elektronike, shërbimet meteorologjike për lundrimin ajror dhe shërbimet e informimit aeronautik

“Shoqëria Koncesionare” është subjekti për qëllime të veçanta, i themeluar nga Koncesionari për t’u bërë Palë e kësaj Kontrate, siç është përkufizuar në hyrje të kësaj Kontrate.

“Shoqëri e Lidhur”, ka kuptimin e çdo shoqërie që zotëron Kontrollin e asaj shoqërie, çdo shoqëri që është nën Kontrollin e asaj shoqërie, ose çdo shoqëri e varur, e cila ka Kontrollin mbi atë shoqëri. Çdo shoqëri e llojit holding (që zotëron Aksionet/Kuotat e shoqërive të tjera) që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare, çdo shoqëri tregtare mbi të cilën ushtrohet kontroll, çdo shoqëri e kontrolluar direkt ose indirekt nga i njëjti holding, ose çdo shoqëri e kontrolluar e një shoqërie të llojit holding që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare.

“Shpenzime Kapitale” nënkupton shpenzimet që klasifikohen nga Ligji apo parimet e përgjithshme të pranura të kontabilitetit si Investime Kapitale ose Shpenzime Kapitale.

“Shpronësim” do të thotë çdo shtetëzim ose shpronësim i asetëve të një Personi, ose çdo masë apo veprim i cili, i marrë veç e veç apo së bashku, ka efekt të barasvlershëm me shtetëzimin ose shpronësimin.

“Shënjimi” nënkupton një simbol ose grup simbole që shfaqen në sipërfaqen e zonës së lëvizjes për të përcjellë informacionin aeronautik

“**Tatim apo Taksë**” është çdo lloj tatimi, takse apo pagese e vendosur në bazë të Ligjit kohe pas kohe, pavarësisht nëse është vendosur apo jo deri më Datën e Fillimit të Zbatimit të Kontratës.

“**Tarifa e Koncesionit**” nënkupton pagesën vjetore të koncesionit e paguar nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues në përputhje me afatet dhe kushtet të parapara në nenin 14.

“**Terminal**” është terminali që do rehabilitohet, operohet dhe mirëmbahet nga shoqëria koncesionare në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 3.

“**Truall Ekstra**” është toka (pavarësisht statusit të saj, tokë bujqësore, truall, livadh etj.) që i nevojitet në mënyrë të përkohshme Koncesionarit krahas Territorit të Projektit dhe/ose Truallit Shtesë në mënyrë që të realizojë Punimet dhe/ose Shërbimet, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

“**Truall Shtesë**” është toka (pavarësisht statusit të saj, tokë bujqësore, truall, livadh etj.) që i nevojitet në mënyrë të përhershme Koncesionarit krahas Territorit të Projektit në mënyrë që të realizojë Punimet dhe/ose Shërbimet, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

“**TVSH**” është tatimi mbi vlerën e shtuar, siç parashikohet me Ligj.

“**Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar**”, ka kuptimin e dhënë në Nenin 32 të Kontratës.

“**Vit i Plotë Kalendarik**” është periudha nga data 1 Janar deri më datë 31 Dhjetor, duke i përfshirë të dyja këto data.

“**Vlera e Tregut e Projektit**” llogaritet si vijon:

Vlera e tregut = A + B - C, ku:

A = vlera aktuale e e të ardhurave të parashikuara, që do të mbledhë shoqëria koncesionare për të gjitha shërbimet e kryera.

B = çdo kompensim i pagueshëm ndaj Koncesionarit në bazë të kësaj Kontrate, si pasojë e një ngjarjeje që ndodh përpara Datës së Përfundimit të Kontratës.

C = $(D1 - D2) + E + F + G$, ku:

D1 = kostoja gjithsej më Datën e Përfundimit të Kontratës për rivendosjen e Koncesionit në Standardet dhe specifikimet e parashikuara me këtë Kontratë.

D2 = dëmi nga sigurimi që ka arkëtuar Autoriteti Kontraktor në lidhje me kostot e rivendosjes të përmendura në D1.

E = vlera aktuale neto e kostove për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Koncesionit, përfshirë Shpenzimet Kapitale që nga Data e Përfundimit të Kontratës deri në fund të Periudhës së Koncesionit (pa marrë në konsideratë, në këtë kuptim, ndërprerjen përpara kohe të Kontratës) (pa përfshirë kostot e përfshira në D1, më lart) në bazë të Modelit Financiar me përditësimet më të fundit.

F = shumat e depozituara ose të kaluara në një llogari rezervë për shlyerjen e borxhit të mbajtur në emër ose për llogari të Koncesionarit në bazë të Marrëveshjes së Financimit, për të garantuar Detyrimet Kundrejt Huadhënësve.

G = çdo vlerë, të papërfshirë në shkronjën “F” më lart, në investime në mjete monetare ose ekuivalente të mjeteve monetare dhe vlera të tjera që në rast garantojnë të drejtat e Huadhënësve dhe janë të arkëtueshme nga Huadhënësit (ose në llogari rezervë ose në një formë tjetër) dhe në çdo rast pa e llogaritur dy herë garancinë për ecurinë që është vënë në dispozicion në përputhje me nenin 8 të kesaj kontrate.

Në kuptim të llogaritjes së vlerës aktuale neto, norma e skontimit është e barabartë me Normën e Brendshme të Kthimit mbi Kapitalin të situatës bazë.

Për të shmangur çdo dyshim, kur llogaritja nxjerr rezultat një shifër me vlerë negative, vlera e tregut e Projektit është zero.

“**VQA - Vendqëndrimi i avionit**” nënkupton një zonë të caktuar në një platformë që do të përdoret për parkimin e një avioni.

“**Zona e uljes**” nënkupton atë pjesë të një zone të lëvizjes që është projektuar për uljen ose ngritjen e avionëve.

“**Zona e manovrimit**” nënkupton atë pjesë të një aerodromi që do të përdoret për ngritjen, uljen dhe tërheqjen e avionëve, duke përfshirë platformat,

“**Zona e lëvizjes**” nënkupton atë pjesë të një aerodromi që do të përdoret për ngritjen, uljen dhe tërheqjen e avionëve, që përbëhet nga zona e manovrimit dhe nga platforma.

NENI 2

INTERPRETIMI I KONTRATËS

Në këtë Kontratë, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, do të përdoren interpretimet e mëposhtme:

- 2.1** Një fjalë e përdorur në numrin njëjës përfshin dhe numrin shumës dhe anasjelltas. Referimi të njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër;
- 2.2** Një “**Palë**” i referohet Shoqërisë Koncesionare ose Autoritetit Kontraktor, sipas rasteve të zbatueshme;
- 2.3** Referimi i një Ligji, akti administrativ, urdhëri apo udhëzimi përfshin referim tek ai Ligj, akti administrativ, urdhëri apo udhëzim siç është ndryshuar, shtuar apo rimiratuar kohë pas kohe, si dhe çdo rregullore e nxjerrë në bazë e për zbatim të tij. Pasoja e çfarëdo ndryshimi, shtese apo ri-miratimi të tillë mbi këtë Kontratë do të zgjidhet në përputhje me nenet e kësaj Kontrate;
- 2.4** Referenca për një Person përfshin pasardhësit e tij apo Personat e autorizuar nga ai në bazë të Ligjit;
- 2.5** Referenca ndaj çdo Neni, paragrafi ose Shtojce, përveç kur deklarohet shprehimisht për të kundërtën, është referencë ndaj atij Neni, paragrafi ose Shtojce të kësaj Kontrate;
- 2.6** Referencat për këtë Kontratë ose ndonjë dokument tjetër të përfshirë në të nënkupton një referencë ndaj çdo ndryshimi/amendimi ose shtesë të kësaj Kontrate, siç mund të ndodhë herë pas here;
- 2.7** Kjo Kontratë përfshin edhe Shtojcat e saj;
- 2.8** Titujt dhe renditja numerike e përdorur për nenet, paragrafët, nënparagrafët, shtojcat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
- 2.9** Një referim të secili institucion apo organ vendimarrës i referohet institucionit dhe organit vendimarrës ekzistues si dhe nëse ai institucion apo organ vendimarrës pushon së ekzistuari, ristrukturohet apo ndan përgjegjësitë me institucione apo organe të tjera, i referohet institucionit apo organit vendimarrës pasardhës apo institucionit apo organit që trashëgon përgjegjësit ekzistuese apo që shërben për të kryer funksione dhe qëllime të ngjashme apo të njëjta si institucioni apo organi ekzistues.
- 2.10** Përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë, në rast të një konflikti të drejtpërdrejtë midis ndonjë dispozite të pjesës kryesore të Kontratës, të ndonjë Shtojce ose Dokumentacionit të Procedurës së Tenderit radha e përparësisë do të jetë si më poshtë:
- (i) kjo Kontratë;
 - (ii) Shtojcat e saj;
 - (iii) Dokumentacioni i ofertës
 - (iv) Dokumentat e Procedurës së Tenderit;
- 2.11** Përveç rasteve të përcaktuar në mënyrë specifike në kushtet e kësaj Kontrate, në rast të një konflikti të drejtpërdrejtë midis ndonjë dispozite të kësaj Kontrate dhe Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë, përparësi do të kenë dispozitat e Kontratës.

NENI 3

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj Kontrate është dhënia me koncesionin/PPP “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) nga Koncesionari te AK”

NENI 4

KONCESIONARI DHE SHOQËRIA KONCESIONARE

4.1 Palët pranojnë që në përputhje me Ligjin, si dhe me Dokumentat e Procedurës Konkurruese, Koncesionari ka themeluar Shoqërinë Koncesionare për të realizuar këtë Kontratë. Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare janë solidarisht përgjegjës për përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate.

4.2 Në varësi të kushteve të parashikuara në këtë Kontratë:

- a) Shoqëria Koncesionare ka të drejtën dhe detyrimin ekskluziv (i) të hartojë Dokumentacionin e Projektit përfundimtar të aeroportit, **pas vënies në dispozicion të raportit aeronautik nga autoriteti përkatës,** (ii) të realizojë Punimet sipas Projektit përfundimtar të Projekt-Zbatimit pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor apo Autoriteti përgjegjës (iii) të sigurojë financimin për zbatimin e Projekt Zbatimit, (iv) të realizojë operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit (në shkallën e përcaktuar në këtë Kontratë) (v) Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, koncesionari ka të drejtën ekskluzive për të ushtruar të drejtat e koncesionarit të përcaktuara në këtë kontratë në lidhje me këtë objekt.
- b) Autoriteti Kontraktues garanton se nuk do t’ia bartë ose cedojë ndonjë personi tjetër në çfarëdo forme, me apo pa shpërblim, të drejtat e koncesionarit ose ndonjë prej detyrimeve të koncesionarit sipas kësaj kontrate, përveç nëse me kontratë është përcaktuar ndryshe
- c) Autoriteti Kontraktor është i detyruar (i) t’i vendosë në dispozicion Shoqërisë Koncesionare të gjitha informacionet, Dokumentacionet, vlerësimet dhe Projekt Idenë e nevojshme për qëllimet e ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së objektit dhe të hartimit të Projekt Zbatimit, (ii) të plotësojë të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë, (iii) të angazhohet për të mbështetur dhe asistuar shoqërinë koncesionare për aplikimin dhe marrjen e të gjitha lejeve/licencave në lidhje me Projektin, aplikimi sipas legjislacionit në fuqi, (iv) Autoriteti Kontraktues i jep koncesionarit të drejtën ekskluzive si dhe e detyron atë që gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe sipas kushteve të kësaj kontrate të kryejë shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë, (të financojë, rehabilitojë dhe përfundojë objektet në vëndndodhje, (të operojë, menaxhojë dhe mirëmbajë objektin dhe

(v) të arkëtojnë tarifën sipas shtojcës 10 dhe tarifën e qirasë për objektet e lejuara për dhënie me qira apo edhe të hyrat tjera të lejuara me këtë kontratë si dhe (vi) Për nevojat e ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së objektit dhe për tërë kohëzgjatjen e projektit, Autoriteti Kontraktues po ashtu i jep koncesionarit të drejtën e shfrytëzimit lidhur me pronësinë e objektit të kësaj kontrate

NENI 5

REFERENCAT NDAJ KONCESIONARIT DHE SHOQËRISË KONCESIONARE

- 5.1** Referencat ndaj Koncesionarit në këtë Kontratë, përveç atyre në nenin 3, Nenin 12.1.1, Nenin 12.1.2, të cilat i referohen të dyja Palëve, konsiderohen si referime vetëm tek Shoqëria Koncesionare; dhe
- 5.2** Palët pranojnë që, në përputhje me Ligjin, si dhe me Dokumentat e Procedurës Konkurruese, Koncesionari ka themeluar Shoqërinë Koncesionare për të realizuar këtë Kontratë, në vend të Koncesionarit. Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare janë solidarisht përgjegjës për përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate.

NENI 6

KUSHTET PARAPRAKE, DATA E HYRJES NË FUQI DHE DATA E FILLIMIT TË ZBATIMIT TË KONTRATËS

6.1 Data e Hyrjes në Fuqi

Pas nënshkrimit të saj nga Palët, dhe miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë kjo Kontratë hyn në fuqi me botimin e vendimit të miratimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë (në vijim “Data e Hyrjes në Fuqi”).

- 6.2** Të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj kontrate janë të kushtëzuara me përmbushjen e parakushteve të përcaktuara në këtë kontratë. Parakushtet duhet të përmbushen nga secila palë brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, përveç nëse palët pajtohen që të shtyjnë afatin ose njëra palë ka hequr dorë me shkrim nga një ose më shumë parakushte që duhet të përmbushen nga pala tjetër pas miratimit me shkrim për heqjen dorë nga pala tjetër.

- 6.3** Pavarësisht nga parashikimet e pikës 6.1 dhe duke marrë në konsideratë dhe parashikimet e pikës 6.4, detyrimi i Shoqërisë Koncesionare për të filluar Punimet bëhet efektiv në datën, në të cilën përmbushet i fundit nga kushtet e përmendura më poshtë (“Data e Fillimit të Zbatimit të Kontratës”):

- 6.3.1 Dorëzimi nga ana e Shoqërisë Koncesionare të Garancisë së Kontratës në përputhje me nenin 8;

- 6.3.2 Paraqitja nga ana e Shoqërisë koncesionare te Autoriteti Kontraktor i Projekt Zbatimit brendaMuajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi;
- 6.3.3 Identifikimi i Objekteve për Shpronësim nëse ka nga Shoqëria Koncesionare dhe përfundimi i procedurave të Shpronësimeve nga Autoriteti Kontraktor, brenda 6 (gjashte) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, të cilat lidhen me zbatimin e Projekt Zbatimit;
- 6.4** Afati maksimal për përmbushjen e këtyre kushteve do të jetë jo më shumë se Muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës, përveç rasteve të përcaktuara në nenin 7 të kësaj Kontrate.
- 6.5** Shoqëria Koncesionare, në diskrecionin e saj të plotë dhe pasi merr pëlqimin e Autoritetit Kontraktor, sipas kësaj kontrate dhe ligjit të zbatueshëm, mund të fillojë Punimet. Kjo nuk do të konsiderohet heqje dorë e Koncesionarit nga të drejtat që ai ka në bazë të kësaj Kontrate.
- 6.6** Parakushtet e tjera të mos varura nga pika 6.3, që duhet të përmbushen nga Autoriteti Kontraktues:
- 6.6.1 Autoriteti Kontraktues ia garanton shoqërisë koncesionare posedimin e qetë të objektit që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- 6.6.2 Autoriteti garanton se i ka vënë në dispozicion studimin aeronautik të Albcontrolit shoqërisë koncesionare, studim i cili do të vlerësojë fizibilitetin dhe mundësinë e fluturimit në aeroport.
- 6.6.3 Autoriteti garanton fillimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror, për nisjen dhe mbërritjen e fluturimeve, nga Albcontrol, brenda 3 deri 6 (tre - gjashtë) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Shërbimet e ofruara dhe marrëdhënia midis Albcontrol dhe Shoqërisë Koncesionare do të rregullohet nëpërmjet Letrës së Marrëveshjes (LoA) përpara datës së fillimit të operimit.
- 6.6.4 Miratimi i Projekt Zbatimit nga Autoriteti Kontraktor brendamuajsh nga dorëzimi për miratim.
- 6.6.5 Të gjitha Miratimet e nevojshme të kërkuara që të merren nga Autoriteti Kontraktues, sipas kësaj kontrate dhe legjislacionit në fuqi, në apo para Datës së Hyrjes në Fuqi, të cilat duhet të jenë të pranueshme në formë dhe përmbajtje për Koncesionarin, brendamuaji.
- 6.6.6 Lëshimi i lejeve të nevojshme nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe mbështetjen për marrjen e lejeve nga koncesionari te Autoritetet Përkatëse, sipas kësaj kontrate dhe

legjislacionit në fuqi, me qëllim mundësimin e fillimit të zbatimit të Projekt Zbatimit, brendamuajsh;

6.6.7 Përzgjedhja e Inxhinierit të Pavarur nga ana e Autoritetit Kontraktor, sipas dispozitave të kësaj Kontrate, brenda muajsh;

6.6.8 Dorëzimi i Territorit të Projektit nga ana e Autoritetit Kontraktor te koncesionari, në çdo rast të çliruar nga (i) të gjitha pengesat për të filluar Punimet, largimin e personave prej tyre dhe prej Territorit të Projektit apo nga të gjitha pretendimet e palëve të treta për të cilat Autoriteti është përgjegjës. Për të shmangur çdo dyshim, objekti në gjendjen aktuale, i dorëzohet shoqërisë koncesionare brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Koncesionari duhet të bëjë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gati për aplikimet përkatëse si dhe të bëjë aplikimet pranë institucioneve përgjegjëse me qëllim marrjen e lejeve dhe licencave, përfshi lejen e ndërtimit.

6.7 Data e Fillimit të Zbatimit të Kontratës

Data e fillimit të zbatimit të kontratës do të konsiderohet dita e nënshkrimit nga të dy palët e dokumentit të fillimit të zbatimit të kontratës pas përmbushjes së parakushteve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj kontrate.

NENI 7

MOSPËRMBUSHJA E KUSHTEVE PARAPRAKE

7.1 Në rastin kur kushtet paraprake të përcaktuara në neni 6, nuk janë përmbushur, Palët do të takohen për të vendosur për një rrugëzgjdhje për plotësimin e kushteve paraprake të mbetura.

7.2 Në rast se kushtet paraprake të mbetura nuk janë përmbushur ende brendamuajve nga data e propozuar, ose brenda ndonjë datë tjetër, për të cilën Palët do të bien dakord me shkrim, kjo Kontratë do të zgjidhet dhe:

7.2.1 Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk i plotëson kushtet që lidhen me të, Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit, si kompensim i rënë dakord paraprakisht, kostot e pjesëmarrjes në zhvillimin e procedurës konkurruese/të tenderit, si dhe zhbllokon dhe kthen garancinë e Kontratës. Dispozitat e këtij paragrafi nuk e përjashtojnë Koncesionarin nga e drejta për të pretenduar dëmshpërblime për ndonjë investim të bërë deri në atë moment, apo dëmshpërblime të tjera, përfshirë dhe ato të marrëveshjeve financiare, të cilat do të vendosen në përputhje me këtë Kontratë. Nëse koncesionari ka pretendime të tjera të cilat nuk do të pranohen nga Autoriteti kontraktor atëherë ato pretendime do të jenë objekt shqyrtimi dhe vendimi gjyqësor.

7.2.2 Megjithatë, në përputhje me Nenin 15.1.3, vonesa e Autoriteti Kontraktor për të Dorëzuar Territorin e Projektit do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

7.2.3 Në rastin e mospërbushjeve me faj nga koncesionari të kushteve paraprake Autoriteti Kontraktor do të mbajë Garancinë e Kontratës, si kompensim i rënë dakord paraprakisht.

7.3 Gjatë periudhës kohore midis datës së hyrjes në fuqi të kontratës dhe datës të zbatimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues angazhohet që t'ia lejojë koncesionarit aksesin në vendndodhje për të kryer matje dhe testime si dhe për të kryer punë të tjera të nevojshme për të përmbushur parakushtet ose për të kryer punime të tjera. Koncesionari ka për detyrë të respektojë të gjitha standardet e sigurisë në objekt në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 8

GARANCIA E KONTRATËS

8.1 Shoqëria koncesionare dorëzon Garancinë e Kontratës në një formë të pranueshme nga Autoriteti Kontraktor sipas parashikimeve të pikave 8.1.1, dhe 8.1.3 të këtij Neni ("**Garancia e Kontratës**"):

8.1.1 Në momentin e nënshkrimit të Kontratës, një garanci e lëshuar nga një shoqëri sigurimesh në vlerën % të vlerës së Punimeve ndërtimore, sipas Projekt-Idesë të dorëzuar në ofertë, garanci e cila do të jetë e vlefshme vetëm deri në Datën e Fillimit të Zbatimit të Kontratës.

8.1.2 7 (Shtatë) Ditë Pune përpara Datës së Fillimit të Zbatimit të Kontratës, deri në përfundimin e Punimeve, një garanci të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë/ shoqëri sigurimi. Shuma e Garancisë së Kontratës për secilin vit pas Datës së Fillimit të Zbatimit të Kontratës do të jetë në vlerën% të vlerës së Punimeve ndërtimore të atij viti, e cila do t'i kthehet mbrapsht Shoqërisë Koncesionare në momentin e dorëzimit të garancisë pasardhëse në bazë të Nenit 8.1.3.

8.1.3 Pas përfundimit të periudhës së Punimeve deri në përfundim të kohëzgjatjes së Kontratës, Shoqëria Koncesionare, për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, dorëzon Garancinë e Kontratës të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë ose shoqëri sigurimesh, në vlerën% të vlerës të shpenzimeve operative vjetore të parashikuara në Modelin Financiar , me të drejtë rinovimi për çdo vit.

8.2 Garancia e Kontratës dhënë si më lart:

8.2.1 Është një instrument që mbulon të gjitha detyrimet e Koncesionarit, që rrjedhin nga kjo Kontratë, e cila mbahet nga Autoriteti Kontraktor në rastin e mospërmbushjeve të Kontratës nga Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare;

8.2.2 Emërton Autoritetin Kontraktor si përfitues të drejtpërdrejtë; dhe

8.2.3 Pas dorëzimit të Garancisë së Kontratës tek Autoriteti Kontraktor, ky i fundit menjëherë nga data e paraqitjes së saj e shqyrton atë, dhe nëse Garancia e Kontratës është në përputhje me parashikimet e mësipërme, Autoriteti Kontraktor e pranon dhe rikthen menjëherë tek Koncesionari Garancinë e Ofertës. Në rast të mos kthimit nga ana e Autoritetit Kontraktor të Garancisë së Ofertës tek Koncesionari brenda një afati prej 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga data e dorëzimit të Garancisë së Kontratës, atëherë Autoriteti Kontraktor do të paguajë një penalitet në vlerën prej 0.1 % të vlerës së Garancisë së Ofertës për çdo ditë vonesë.

8.3 Ekzekutimi i garancisë së kontratës

8.3.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin e kontratës, në masën e parashikuar në këtë kontratë, për:

- (i) Kompensimin e dëmit të shkaktuar nga koncesionari te Autoriteti Kontraktues si pasojë e shkeljes së koncesionarit të detyrimeve dhe garancive të tij parashikuar në këtë kontratë;
- (ii) Kompensimin e dëmit dhe shpenzimeve të cilat i shkaktohen Autoritetit Kontraktues për shkak se Autoriteti Kontraktues ushtron të drejtën e tij për ndërhyrje sipas kësaj kontrate;
- (iii) Përmbushjen e pagesës së penaliteteve që duhet të paguhet nga koncesionari parashikuar në këtë kontratë;

8.3.2 Autoriteti Kontraktues ka për detyrë ta njoftojë koncesionarin me shkrim për çdo ekzekutim të sigurimit të kontratës si dhe të arsyetë ekzekutimit. Në rast të ekzekutimit të sigurimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, koncesionari ka për detyrë që brenda 15 ditëve nga dita e ekzekutimit të sigurimit të kontratës të sigurojë që sigurimi i kontratës të ketë vlerën që e ka pasur në kohën kur është ekzekutuar sigurimi i kontratës dhe siç kërkohet me këtë kontratë. Ekzekutimi i sigurimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktues nuk i përjashton mjetet e tjera juridike të cilët i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kësaj kontrate.

NENI 9

PERIUDHA E KONCESIONIT

Përveçse në rastet e përfundimit të parakohshëm të kësaj Kontrate, në përputhje me kushtet e saj, Periudha e Koncesionit fillon nga dita e hyrjes në fuqi të kontratës deri në ditën e përvjetorit të 35-të të saj. Në llogaritjen e Periudhës së Koncesionit nuk do të numërohen periudhat në të cilat

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit te perzgjedhur si me i suksesshmi.

zbatimi i kësaj Kontrate është vonuar për shkak të Ngjarjeve të Forcës Madhore, Shkaqeve të Kompensimit/Lehtësimit, ose për shkak se Autoriteti Kontraktor nuk ka përmbushur detyrimin e tij sipas kësaj Kontrate, gjë që ka sjell pasoja apo vonesa në zbatimin e projektit, afat i cili mund të zgjatet në përputhje me dispozitat Ligjore të përcaktuara në këtë Kontratë si dhe legjislacionit të zbatueshëm për koncesionet.

NENI 10

NËNKONTRATAT

Gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate, koncesionari ka të drejtë të përdorë dhe t'ia besojë personave të tretë në cilësinë e nën-kontraktorëve përmbushjen e një ose më shumë detyrimeve dhe shërbimeve sipas kësaj kontrate. Koncesionari është tërësisht përgjegjës për veprimet, vonesën dhe pakujdesinë e nën-kontraktorëve të tij si dhe të përfaqësuesve dhe punëtorëve të nën-kontraktorëve sikur të ishin veprimet, vonesat dhe pakujdesia e vet koncesionarit.

Koncesionari ka për detyrë të mbajë një regjistër të të gjithë nënkontraktorëve si dhe nga një kopje të të gjitha kontratave të lidhura me nënkontraktorët. Këto kontrata janë minimalisht 30 për qind e vlerës totale të kontratës së koncesionit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për koncesionet.

NENI 11

NDRYSHIMI I KONTROLLIT

11.1 Njoftimi i ndryshimeve

11.1.1 Në përputhje me dispozitat e nenit 32, të Ligjit 125/2013, të ndryshuar, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti kontraktues, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet te një person i tretë, që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveçse nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari/partneri privat i mëparshëm.

11.1.2 Autoriteti Kontraktor do të marrë kërkesë me shkrim nga Koncesionari për miratimin e AK për çdo transferim të aksioneve/kuotave dhe të kontrollit brenda Shoqërisë Koncesionare

dhe për çdo transferim të kuotave/aksioneve dhe kontrollit nga çdo Aksioner tek/ndaj një Shoqëri e Lidhur e tij, apo tek një Aksioner tjetër, ose tek/ndaj një Shoqëri e Lidhur e një Aksioneri tjetër.

NENI 12

GARANCITË DHE ANGAZHIMET E KONCESIONARIT/ SHOQËRISË KONCESIONARE

12.1 Garancitë e koncesionarit/shoqërisë koncesionare

Koncesionari/shoqëria koncesionare deklaron, garanton, dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktor se:

12.1.1 Është themeluar dhe vepron në përputhje me Ligjin;

12.1.2 Në dijeninë e tij, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që do ta bënte Koncesionarin të mos ishte në gjëndje të përmbushte detyrimet e tij dhe nuk ekziston asnjë fakt ose ngjarje që mund të shpinte në mospërmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit; dhe

12.1.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare nuk kanë kryer asnjë veprim të ndaluar nga Ligji.

12.1.4 Koncesionari më tej garanton, deklaron dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktor se, duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi:

- (i) Çdo angazhim që buron nga Dokumentet e Projektit përfaqëson një angazhim të vlefshëm dhe të zbatueshëm të Koncesionarit dhe secili nga Dokumentet e Projektit është në formën që kërkohet nga Ligji;
- (ii) Dokumentet e Projektit janë përgatitur dhe zbatimi i tyre dhe kryerja e punës nga Koncesionari nuk bie ndesh me: Asnjë Ligj; Aktin e themelimit ose dokumente të tjera të brendshme të Koncesionarit; ose Detyrimet e Koncesionarit;
- (iii) Ndaj Koncesionarit nuk është ngritur asnjë padi dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor, arbitrazhi ose procedurë administrative në pritje për t'u zgjidhur apo ndonjë mosmarrëveshje tjetër e cila është duke u zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër, dhe Koncesionari nuk ka dijeni, me gjithë kujdesin e treguar, për ndonjë mosmarrëveshje në pritje për t'u zgjidhur apo mosmarrëveshje që mund të lindë në të ardhmen, që mund të ketë Efekt Negativ Thelbësor.

12.2 Angazhimet e Koncesionarit/shoqërisë koncesionare

12.2.1 Detyrimi i përgjithshëm

Koncesionari/shoqëria koncesionare duhet të:

12.2.1.1 Vihet në dijeni për të drejtat që do të përftojë dhe natyrën dhe shkallën e risqeve që do të ndërmerren sipas kësaj Kontrate; dhe

12.2.1.2 Brenda mundësive të tij, mbledh informacionin e nevojshëm ligjërish të disponueshëm dhe të aksesueshëm për plotësimin e detyrimeve të tij, sipas kësaj Kontrate, nëse ky informacion është i mundshëm për t'u gjetur ose është vënë në dispozicion nga Autoritetet Përkatese, pasi të jetë kërkuar në mënyrë të rregullt, duke përfshirë:

- (i) informacionin në lidhje me natyrën, vendndodhjen dhe gjendjen e Territorit të Projektit; dhe
- (ii) informacionin që lidhet me Objektet Arkeologjike ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore, zonat me interes arkeologjik, shkencor ose natyror, kushtet dhe mundësitë që ofron vendi dhe cilësinë e strukturave ekzistuese.

12.2.2 Pa çënuar përfitimet (të drejtat) e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare garanton se:

12.2.2.1 Aq sa ishte e mundur ka inspektuar dhe kontrolluar Territorin e Projektit dhe mjediset përreth dhe, sipas rastit, të gjitha strukturat që gjenden në gjithë hapësirën e Territorit të Projektit;

12.2.2.2 Aq sa është e mundur, duke marrë në konsideratë dhe përdorur kujdesin e zakonshëm profesional si dhe metodat profesionale të zbatueshme në Shqipëri, është njohur dhe ka marrë dijeni për (i) natyrën e kushteve klimatike, hidrologjike, gjeologjike, ekologjike, mjedisore dhe të përgjithshme të Territorit të Projektit dhe rrethinat e tij, (ii) natyrën e tokës dhe nëntokës, duke përfshirë të gjitha kushtet nënsipërfaqësore (iii) formën dhe natyrën e Territorit të Projektit, (iv) rrezikun e dëmtimit apo të dëmit ndaj pronave pranë tij, apo rreziqet që prekin Territorin e Projektit dhe pronarët e pronave të tilla, (v) natyrën e materialeve (natyrale ose jo) që do të gërmohen, dhe (vi) natyrën e Projektit, punën, impiantet dhe materialet e nevojshme për Projektin.

12.2.2.3 Shoqëria Koncesionare angazhohet, që me shpenzime të veta, të largojë të gjitha strukturat, ndërtesat dhe objektet tjera që pengojnë kryerjen e punëve ndërtimore në vendndodhje. Në rast se nevojitet ndonjë leje për largimin e strukturave, ndërtesave dhe objekteve që pengojnë kryerjen e punëve ndërtimore në vendndodhje, koncesionari ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të sigurojë këto leje nga autoritetet kompetente. Autoriteti Kontraktues duhet të asistojë shoqërinë koncesionare në marrjen e lejeve përkatëse. Nëse lejet janë kompetencë e autoritetit kontraktues, atëherë autoriteti kontraktues është i detyruar që në një afat sa më të shkurt dhe brenda kuadrit ligjor t'i ofrojë lejet e nevojshme për largimin e strukturave në hapësirat e përcaktuara për këtë

projekt.

- 12.2.2.4 Shoqëria Koncesionare angazhohet se do të lejojë Autoritetin Kontraktues dhe përfaqësuesit e tij të kenë akses në vendndodhje për nevojat e ndjekjes së punëve të koncesionarit dhe për të siguruar që koncesionari vepron në pajtim me detyrimet e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues ka për detyrë që të respektojë të gjitha standardet e sigurisë dhe të mos pengojë ose të ndërhyjë në punët ndërtimore ose operimin e objektit.
- 12.2.2.5 Shoqëria Koncesionare angazhohet që, me shpenzime e veta, të kryejë të gjitha matjet dhe hulumtimet në vendndodhje për nevojat e punëve ndërtimore. Autoriteti Kontraktues nuk ka asnjë përgjegjësi në lidhje me matjet, hulumtimet si dhe punët përkatëse që kryhen nga koncesionari.
- 12.2.2.6 Shoqëria Koncesionare është dakort që çdo fosil, monedhë, send tjetër me vlerë dhe mbetje arkeologjike që zbulohet në vendndodhje është në pronësi të Republikës së Shqipërisë. Në rast të zbulimit të një sendi të tillë në vendndodhje pas datës së zbatimit të kontratës, koncesionari ka për detyrë ta njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues dhe t'ia lejojë Autoritetit Kontraktues ose një autoriteti tjetër kompetent aksesin në vendndodhje për të larguar sendin në fjalë. Koncesionari ka për detyrë të zbatoj udhëzimet e Autoritetit Kontraktues dhe të autoritetit kompetent. Nëse sendi i zbuluar është i paluajtshëm, koncesionari ka për detyrë t'ia lejojë Autoritetit Kontraktues ose autoritetit kompetent kryerjen e hulumtimeve që kërkohen me ligj dhe të zbatoj udhëzimet e Autoritetit Kontraktues dhe të autoritetit kompetent lidhur me këtë. Autoriteti Kontraktues ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara që i janë shkaktuar koncesionarit si pasojë e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë.
- 12.2.2.7 Shoqëria koncesionare do të përcaktojë përfaqësuesit e saj, të cilat do të jenë pikat e kontaktit me autoritetin kontraktues dhe do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë me NjZP për zbatimin e kësaj kontrate.

NENI 13

GARANCITË DHE INFORMACIONI I DHËNË NGA AUTORITETI KONTRAKTOR

13.1 Të dhënat e vëna në dispozicion

- 13.1.1 Autoriteti Kontraktor duhet të vërë në dispozicion të Koncesionarit materiale, dokumente dhe të dhëna të caktuara të lidhura me Projektin dhe në Territorin e Projektit, të dhëna dhe

- çështje të tjera, të cilat lidhen ose mund të lidhen me Projektin dhe Territorin e Projektit.
- 13.1.2 Autoriteti Kontraktor bën përpjekjet e tij të arsyeshme për të vënë në dispozicion të Shoqërisë Koncesionare çdo material tjetër, që mund të bjerë në dorë të tij gjatë kohëzgjatjes së Kontratës dhe që është i llojit që do të ishte bërë i njohur në rast se do ekzistonte në kohën e vënies në dispozicion të të dhënave të disponueshme dhe që ka efekt për zbatimin e Kontratës së Koncesionit nga Shoqëria Koncesionare. Materiale të tilla shtesë konsiderohen Të Dhëna Të Vëna në Dispozicion në kohën që jepen (por jo më parë).

13.2 Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti Kontraktor garanton se:

- 13.2.1 Ka ndjekur të gjitha procedurat Ligjore në lidhje me organizimin e procedurave konkurruese si dhe ate të përzgjedhjes së Koncesionarit si dhe ka konsultuar, ndjekur dhe respektuar manualët, udhëzimet dhe rekomandimet e publikuara nga autoritete të tjera, të cilët ngarkohen me Ligj të mbikëqyrin sektorë të tjerë, subjekte të Ligjeve të veçanta.
- 13.2.2 Organizimi i procedurave të dhënies me Koncesion, përzgjedhja si dhe përmbajtja e Kontratës nuk rezulton në ndonjë shkëlqje të ndonjë marrëveshjeje me palë të treta, të ndonjë Ligji tjetër të sektorëve të veçantë, të manualeve dhe rekomandimeve të dhëna nga autoritete të tjera sipas Ligjeve të veçanta, të ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare, traktati apo konvente, ku Autoriteti Kontraktor dhe Republika e Shqipërisë janë palë ose në bazë të të cilave kanë marrë angazhime.
- 13.2.3 Autoriteti Kontraktor garanton se në rastin e punimeve të kryera nga një palë e tretë, mbi objektin, Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare nuk do të jetë përgjegjës për mangësi, dëmtime apo efekte të këtyre Punimeve mbi Punimet e bëra nga Shoqëria Koncesionare ose ndryshime apo rregullime të Projektit nga ana e Shoqërisë Koncesionare, që dalin të nevojshme si pasojë e mangësive, dëmtimeve apo efekteve të punimeve të bëra nga palë të treta.
- 13.2.4 Autoriteti Kontraktues garanton se nuk do të ndërmarrë asnjë veprim i cili do të ndërpresë ose do të pengojë kryerjen e shërbimeve, punët ndërtimore, operimin dhe mirëmbajtjen e objektit, si dhe arkëtimin e tarifës nga koncesionari, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë kontratë. Në rast të një ndërprerje të palejuar nga ana e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë t'ia kompensojë koncesionarit të gjitha shpenzimet, humbjet dhe fitimin e munguar, të cilat i shkaktohen koncesionarit si pasojë e kësaj ndërprerje.
- 13.2.5 Autoriteti Kontraktor garanton në lidhje me përshtatshmërinë e të Dhënave të Vëna në Dispozicion të Shoqërisë Koncesionare, të dhënave nga studimi aeronautik si dhe për çdo informacion tjetër që i është dhënë Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare.
- 13.2.6 Autoriteti Kontraktues garanton se do të mbajë të pacënuar shoqërinë koncesionare nga çdo ndryshim thelbësor, që mund të çënojë rentabilitetin ekonomik të tij, si rrjedhojë e zbatimit të projektit në përputhje me të dhënat e studimit aeronautik. Për të shmangur çdo

dyshim, me qëllim mbajtjen të pacënuar të shoqërisë koncesionare, në rast të një ndryshimi të tillë, palët do të ulen në mirëbesim për të përcaktuar që rivendosja e stabilitetit ekonomik të shoqërisë koncesionare do të realizohet duke i dhënë të drejtën shoqërisë koncesionare, që të bëjë rishikimin e tarifave të shërbimit, në përputhje me treguesit e performancës financiare të koncesionarit, të paraqitur në garë.

13.2.7 Gjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë që: (i) të ndryshojë tarifën si dhe të caktojë ndonjë tarifë, taksë ose pagesë tjetër në lidhje me objektin dhe shërbimet, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë si dhe në legjislacionin në fuqi, dhe nuk prekin fizibilitetin financiar të koncesionarit ose (ii) të ndërhyjë në mënyrë tjetër në arkëtimin e tarifës nga ana e koncesionarit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me kontratë.

13.2.8 Autoriteti Kontraktues ka për detyrë që: (i) të sigurojë gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës posedimin e qetë në dobi të koncesionarit dhe (ii) të sigurojë që pas datës së kontratës nuk do të disponojë më asnjë pjesë të vendndodhjes dhe nuk do të krijojë të drejta në lidhje me vendndodhjen ose pjesë të saj, përveç në mënyrën e përcaktuar në këtë kontratë.

13.2.9 Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të sigurojë që të gjitha rrugët përmes të cilave mundësohet aksesimi në vendndodhje në datën e kësaj kontrate do të mirëmbahen në pajtim me ligjin dhe standardet përkatëse. Autoriteti Kontraktues garanton se do të sigurojë që të gjitha rrugët përmes të cilave mundësohet aksesimi në objekt do të jenë të hapura dhe të shfrytëzueshme gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës, përveç në rast të një mbyllje të objektit ose pezullimit të punëve që mund të rezultojnë nga një emergjencë ose fuqi madhore.

13.2.10 Autoriteti Kontraktor garanton se do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për rimbursimin nga Autoritetet Përkatëse të TVSH-së në favor të Koncesionarit në kohë dhe në përputhje me Ligjin.

13.2.11 Deri në Datën e Fillimit të Zbatimit të Kontratës, Autoriteti Kontraktor nuk do të ngarkojë me përgjegjësi Koncesionarin për asnjë dëm që mund të ndodhë përpara datës kur bëhet marrja në Dorëzim e objektit. Koncesionari nuk mban përgjegjësi dhe nuk ngarkohet financiarisht për difekte, ose mangësi në funksionimin e aeroportit, të cilat duhet t'i ishin bërë të njohura, por nuk janë publikuar, ose nuk i janë vënë në dispozicion më parë nga autoriteti Kontraktor (Këtu përfshihen lidhjet e aeroportit me rrjetin e furnizimit me energji elektrike, ujë, apo kanalizimet dhe jo vetëm).

13.2.12 Autoriteti Kontraktor angazhohet se do të ndërmarrë të gjithë hapat e duhur dhe do të japë të gjithë asistencën e nevojshme konkrete si dhe do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Autoritetet Përkatëse kompetente, qendrore ose vendore, të cilat kanë kompetencë për lëshimin e lejeve dhe licencave përkatëse kundrejt Shoqërisë Koncesionare në mënyrë që këto autoritete të pajisin Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare me lejet/licencat përkatëse, në kohë dhe pa vonesë në lidhje me zbatimin e Kontratës, për sa kohë që ky i fundit ka përmbushur detyrimet e tij për aplikim në përputhje me Ligjin.

13.2.13 Autoriteti Kontraktor angazhohet se gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj Kontrate do të

sigurojë gëzimin e qetë të të drejtave që Koncesionarit i lindin nga kjo Kontratë.

- 13.2.14 Autoriteti Kontraktor gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj Kontrate do të sigurojë mos cënimin nga palë të treta të aktivitetit të Shoqërisë Koncesionare si dhe do të ndërmarrë të gjitha masat për të zgjidhur problemet që palë të treta do të kenë në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate, sidomos lidhur me çështje të Shpronësimeve nëse do te kete, apo të pretendimeve të tjera nga palë të treta. Mbulimi i shpenzimeve që lidhen me këto Shpronësime nëse do te kete, sipas angazhimit në këtë kontratë do të përballohet nga koncesionari.
- 13.2.15 Autoriteti Kontraktor do t'i garantojë Shoqërisë Koncesionare, vetë apo kur është rasti në bashkëpunim me Autoritetet e tjera Përkatëse, gëzimin e qetë dhe aksesin në Territorin e Projektit apo në Kantier gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, përfshirë, të drejtën për të hapur, ndërtuar, përdorur rrugët kombëtare apo lokale të aksesit për në Kantier dhe/apo lëvizjen në këto rrugë apo në rrugët e tjera për në Kantier të mjeteve të Koncesionarit pa pagesë, me përjashtim të rrugëve kombëtare me pagesë ("toll") për të cilat koncesionari do bëjë pagesat përkatëse.
- 13.2.16 Autoriteti Kontraktor merr përsipër që, gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të ndihmuar Shoqërinë Koncesionare në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate dhe në përputhje me të, si dhe të mos krijojë asnjë pengesë kundrejt Shoqërisë Koncesionare në lidhje me zbatimin e Kontratës.
- 13.2.17 Pavarësisht nga çdo klauzolë tjetër e kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor në të gjitha rastet bashkëpunon me mirëbesim dhe i ofron asistencë të arsyeshme Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare.
- 13.2.18 Autoriteti Kontraktor do të marrë të gjitha masat që në bashkëpunim me Autoritetet Përkatëse t'i sigurojë Shoqërisë Koncesionare venddepozitime për mbetjet në lidhje me Punimet që do të kryhen në Kantier në tokë në pronësi shtetërore. Kjo tokë do t'i vihet në dispozicion Shoqërisë Koncesionare në mënyrën dhe procedurën që parashikohet në këtë Kontratë për Truallin Shtesë. Autoriteti Kontraktor do të bashkëpunojë me Shoqërinë Koncesionare për përzgjedhjen e këtyre venddepozitimeve në mënyrë që (i) ato të jenë në distancë të arsyeshme nga Territori i Projektit, në mënyrë që Koncesionari të mos ketë kosto të paarsyeshme shtesë për transportin e mbetjeve (inerte, dhera etj) dhe (ii) të mos pengojë planet e zhvillimit të miratuara të Autoriteteve Përkatëse që kanë pronësinë e truallit ku planifikohet të bëhet venddepozitimi. Kostoja e transportit dhe e sistemimit të mbetjeve do të jenë në ngarkim të Shoqërisë Koncesionare.
- 13.2.19 Autoriteti Kontraktor do të bëjë të gjitha përpjekjet që, pas Datës së Nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare të mos të jetë subjekt i ndonjë Tatimi apo Takse të re që ndonjë Autoritet Përkatës apo Autoriteti Kontraktor mund të aplikojë mbi Shoqërinë Koncesionare për shkak të zbatimit të kësaj Kontrate lidhur me Punimet në Kantier. Për të shmangur çdo dyshim, kjo klauzolë nuk mbulon Tatimet apo Taksat që kanë karakter të përgjithshëm dhe aplikohen mbi të gjitha subjektet në Republikën e Shqipërisë.
- 13.2.20 Autoriteti Kontraktor garanton kushtet standarte të aplikueshme për përdorimin, nga avionët e çdo shteti, të të gjithë faciliteteve, sisteme dhe paisje të navigimit ajror, të cilat

do të mundësohen nga Autoriteti Kontraktor dhe Autoritetet Përkatëse, për përdorim publik, për sigurinë në operim dhe mundësimin e navigimit ajror, sipas Letrës së Marrëveshjes (LoA) që do të lidhet midis Shoqërisë Koncensionare dhe Shoqërisë së Ofrimit të Shërbimeve të Lundrimit Ajror Albcontrol, përpara datës së fillimit të operimit. Të gjitha këto përcaktohen në mënyrë të detajuar në shtojcën 17.

13.2.21 Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Entitetin përkatës garanton ofrimin në Republikën e Shqipërisë të shërbimeve të manaxhimit dhe mbikqyrjes së navigimit ajror, në mënyrë që të lehtësojë navigimin ajror ndërkombëtar në përputhje me konventat dhe sipas Letrës së Marrëveshjes (LoA) që do të lidhet midis Shoqërisë Koncensionare dhe Shoqërisë së Ofrimit të Shërbimeve të Lundrimit Ajror Albcontrol, përpara datës së fillimit të operimit.

13.2.22 Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Autoritetet Përkatëse, mundëson facilitete për doganat dhe procedurat operacionale të emigracionit për transportin ndërkombëtar të njerëzve dhe mallrave, në përputhje me praktikat ligjore dhe të rekomanduara sipas ICAO. Marrëdhënia midis Shoqërisë Koncensionare dhe Entiteteve përkatëse shtetërore në lidhje me këto shërbime shtetërore mund të rregullohet nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse

13.2.23 Autoriteti Kontraktor do të marrë përsipër garantimin e te ardhurave minimale për një periudhë 10 vjeçare ku minimumi i llogaritur i te ardhurave te garantuara është i barabartë me nivelin e te ardhurave për 10 vitet e para të operimit me të cilat NPV totale e projektit behet 0. Gjithashtu ne rastin kur te ardhurat e projektit do te tejkalohen përtej nivelit te parashikuar te të ardhurave ne skenarin bazë, atëherë këto do te ndahen midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit ne raport 50:50 ne përputhje me shtojcën 18 te kësaj kontrate.

13.3 Njësia e Zbatimit të Projektit (NjZP)

Autoriteti Kontraktues do të ngrejë një njësi për monitorimin e zbatimit të projektit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi e kontratës, gjatë gjithë periudhës së kësaj kontrate, e cila do të shërbejë si përfaqësuese e Autoritetit Kontraktues dhe monitorimit të zbatimit të Kontratës.

NENI 14

PAGESAT DHE TARIFAT

14.1 Tarifat e Rregulluara për Shërbimet e Aeroportit

- 14.1.1 Shoqëria koncesionare do të jete e autorizuar të percaktojë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit nga Përdoruesit e Aeroportit dhe të mbajë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit gjatë Afatit të Koncesionit në përputhje me Shtojcën 10 (Pagesat për Shërbimet e Aeroportit). Shoqëria koncesionare nuk të mbajë asnjë tarifë tjetër për Përdoruesit e Aeroportit, përveç se atyre të përcaktuara shprehimisht në këtë kontratë.
- 14.1.2 Në caktimin e Pagesave për Shërbimet e Aeroportit, Shoqëria koncesionare do të veprojë në një mënyrë të tillë që të mos vijë në kundërshtim me detyrimet ligjore kombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe e cila është në Përputhje me Konventën e Çikagos.
- 14.1.3 Shoqëria koncesionare do të mbledhë taksat e mëposhtme në emër të Qeverisë së Shqipërisë (që përndryshe mbledhen nga Qeveria e Shqipërisë në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm):
- Taksa e Kalimit të Kufirit dhe
 - taksa/tarifa të tjera të cilat mund të vendosen nga Qeveria e Shqipërisë, pa paragjykuar të drejtat e koncesionarit në rast të ndryshimeve ligjore.

Nepermjet lidhjes së kësaj kontrate shoqëria koncesionare autorizohet të lidh marrëveshje të posaçme me organet kompetente për procedurat e mbledhjes së taksave/tarifave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në të tilla raste, Shoqërisë koncesionare do t'i rimbursohen kostot e mundshme administrative të mbledhjes së taksave dhe tarifave të tilla dhe pagesat për vlerat e mbledhura në emër të Qeverisë së Shqipërisë do të depozitohen në ditën e fundit të punës të periudhës pasardhëse mujore, ose sik kërkojnë nga Qeveria e Shqipërisë me shkrim.

14.2 Vlerësimi Periodik i Pagesave të Shërbimeve (tarifave) të Aeroportit.

- 14.2.1 Autoriteti Kontraktues dhe Shoqëria Koncesionare do të rishikojnë Pagesat për Shërbimet e Aeroportit çdo 3 (tre) vjet gjatë Periudhës së Koncesionit.
- 14.2.2 Shoqëria mund të pergatisë dhe të paraqesë tek Autoriteti Kontraktues dhe Autoriteti përkatës për miratim propozime për ndryshime në Pagesat për Shërbimet e Aeroportit në çdo rishikim periodik të Pagesave për Shërbime të Aeroportit. Çdo propozim do të shoqërohet nga dokumentacioni i shkruar i argumenteve të përdorura dhe i përllogaritjeve të bëra.

14.3 Tarifa Koncesionare

Shoqeria do te paguaje ne favor të Autoritetit Kontraktues nje tarife ne shumen prejtë fitimit të shpërndashëm, pas vitit tëtë operimit përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, për çdo vit.

KREU 2

PRONA

NENI 15

PRONËSIA DHE PËRDORIMI I PRONËS

15.1 Territori i Projektit

- 15.1.1 Autoriteti Kontraktor deklaron se do të ndërmarrë masat e nevojshme për të qenë poseduesi i ligjshëm i tokës së Territorit të Projektit ku ndodhet objekti, si dhe do t'i Dorëzojë Territorin e Projektit Shoqërisë Koncesionare, përpara Datës së Fillimit të Zbatimit të Kontratës. Pavarësisht përcaktimit në këtë paragraf, Autoriteti Kontraktor do ta lejojë Shoqërinë Koncesionare që të futet në të gjitha pjesët e Territorit të Projektit, me qëllim për të kontrolluar kushtet, apo për të realizuar veprime paraprake për përsheptimin e fillimit të punëve ndërtimore, duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës.
- 15.1.2 Autoriteti Kontraktor garanton se Territori i Projektit do t'i Dorëzohet Shoqërisë Koncesionare i lirë nga çdo barrë apo të drejta të palëve të treta. Në përputhje me neni 7.3, çdo shkelje nga Autoriteti Kontraktor i kësaj dispozite ose ekzistenca e të drejtave të të tretëve, do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.
- 15.1.3 Pronësia apo të drejtat e tjera ndaj të gjitha pjesëve të Territorit të Projektit i përkasin Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor pranon që, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës, të mos transferojë të mos heqë Territorin e Projektit a ndonjë pjesë të tij, apo ndonjë interes në të, përveçse sa në përputhje me këtë Kontratë.
- 15.1.4 Kostot dhe shpenzimet e Dorëzimit të Territorit të Projektit dhe dhënia e Të Drejtave të Koncesionarit përballohen nga koncesionari. Autoriteti Kontraktor është dakord se çdo kosto, dëm, pengesë apo vonesë në zbatimin e kësaj Kontrate nga ana e Koncesionarit, pasi vërtetohet nga ana e Inxhinierit të Pavarur, për arsye që lidhen me Shpronësimet apo marrjen në kontroll të Territorit të Projektit, nga Autoritetet Përkatese ose palët e treta do të jetë një Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, përveç rasteve kur kjo vonesë është shkaktuar nga veprimet apo mosveprimet me faj të Shoqërisë Koncesionare.

Autoriteti Kontraktor garanton se brenda rrethimit aktual të aeroportit, nuk ka asnjë objekt për të cilin nuk është realizuar procedura e shpronësimit. Pavarësisht nga kjo, koncesionari nuk ka detyrim financiar për shpronësimet brenda rrethimit aktual të aeroportit.

- 15.1.5 Në Datën e Përfundimit të Kontratës, Shoqëria Koncesionare i kthen Autoritetit Kontraktor të gjithë Territorin e Projektit, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.
- 15.1.6 Territori i Projektit nuk përdoret nga Shoqëria Koncesionare për ndonjë qëllim tjetër, të ndryshëm nga çka parashikohet në këtë Kontrate duke respektuar kërkesat e zbatueshme të Ligjit dhe kushtet e kësaj Kontrate.
- 15.1.7 Të gjitha shpenzimet apo Taksat (nëse mund të ketë të tilla), për regjistrimin e pronësisë, apo të përdorimit të Territorit të Projektit në Zyrat Vendore të Agjencise Shtetërore të Kadastres dhe/ose kosto të tjera që rrjedhin nga aktet ligjore apo nënligjore në lidhje me regjistrimin e pronësisë se kësaj toke apo përdorimin e saj, do të përballohen nga Autoriteti Kontraktor.

NENI 16

OBJEKTET ARKEOLOGJIKE” OSE “OBJEKTET E TRASHËGIMISË KULTURORE”

16.1 Në rastin e zbulimit të ndonjë Objekti Arkeologjik ose Objekti Trashëgimie Kulturore në Territorin e Projektit, pas datës në të cilën Autoriteti Kontraktor i ka Dorëzuar Shoqërisë Koncesionare Territorin e Projektit, apo në raste kur gërmimi për Objekte Arkeologjike ose Objekte të Trashëgimisë Kulturore ka filluar përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe nuk është përfunduar në kohën e dorëzimit të Territorit të Projektit, Shoqëria Koncesionare, sipas rastit:

- 16.1.1 Njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor si dhe Autoritetet e tjera Përkatëse si dhe ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm që i kërkohen nga Ligji një operatori që kryen punime në lidhje me Objektin Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore.
- 16.1.2 Ndërmerr hapa të tillë që mund të kërkohen me Ligj nga çdo Autoritet Përkatës, të cilët mund të përfshijnë ndërprerjen dhe moskryerjen e Punimeve që mund të pengojnë gërmimet e Objektit Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore, ose që mund të kenë ndonjë pasojë mbi Objektin Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore në ndonjë mënyrë; dhe
- 16.1.3 Ndërmerr të gjitha hapat e arsyeshëm për të ruajtur Objektin Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore në të njëjtin pozicion dhe gjendje në të cilën janë gjetur.

16.2 Mos-shkaktimi i Vonesave

47 | F a q e

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit te perzgedhur si me i suksesshmi.

16.2.1 Koncesionari bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme që të sigurojë që ai apo Nënkontraktorët e tij, përgjegjës për Punimet, të bëjnë të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur që të mos jetë e nevojshme të kërkohet zgjatja e periudhës për përfundimin e Punimeve (duke riorganizuar Programin ose në ndonjë mënyrë tjetër), si rezultat i gërmimeve në lidhje me Objektin Arkeologjik ose Objekte të Trashëgimisë Kulturore të zbuluar përpara ose gjatë Punimeve.

16.2.2 Nëse ndodh ndonjë vonesë në kryerjen e Punimeve si rezultat i gërmimeve për zbulimin ose largimin e Objektit Arkeologjik ose Objekteve të Trashëgimisë Kulturore, ose të ndonjë pune tjetër të nevojshme të kryer në lidhje me Objektin Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore të zbuluara ose përpara dorëzimit të Territorit të Projektit (kur një punë e tillë nuk është përfunduar përpara dorëzimit të Territorit të Projektit), ose që është zbuluar pas dorëzimit të Territorit të Projektit, atëherë koncesionari ka të drejtë të përfitojë një Shkak Lehtësimi. Nëse vonesa është më shumë sesa..... Ditë Pune, atëherë kjo vonesë do të përbëjë Shkak Kompensimi.

16.3 Mbikqyrja/Monitorimi dhe Plani i Veprimit

16.3.1 Autoritetet Përkatëse si dhe çdo Person që vepron në emër të secilit prej tyre, ka të drejtë të hyjë dhe të dalë në Territorin e Projektit për qëllimet e hetimit për ndonjë objekt të përcaktuar sipas neni 16.1 , duke e njoftuar me shkrim Koncesionarin të paktënDitë Pune përpara. Nëse autoritetet si më lart kanë formuluar një plan për të trajtuar Objektin Arkeologjik apo Objektet e Trashëgimisë Kulturore dhe/ose çdo gërmim të lidhur me të, Shoqëria Koncesionare merr përsipër që t'u japë ndihmën e nevojshme dhe komercialisht të arsyeshme për ta zbatuar atë. Autoriteti Kontraktor si dhe Autoritetet Përkatëse dhe Personat e autorizuar prej tyre, do të veprojnë dhe do të bëjnë çdo përpjekje që të mos e pengojnë Shoqërinë Koncesionare në realizimin e përmbushjes së detyrave të saj, sipas kësaj Kontrate.

16.3.2 Koncesionari do të respektojë kushtet e çdo vendimi të çdo Autoriteti Përkatës, në lidhje me Objektet Arkeologjike apo Objektet e Trashëgimisë Kulturore. Gërmimet do të kryhen nën mbikqyrjen dhe me pjesëmarrjen e Autoritetit Kontraktor, si dhe të çdo Autoriteti Përgjegjës ose të çdo Personi që vepron në emër të tyre.

16.4 Pronësia e objekteve arkeologjike ose objekteve të trashëgimisë kulturore

Të gjitha Objektet Arkeologjike ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore janë pronë e Republikës së Shqipërisë.

NENI 17

48 | F a q e

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

MATERIALET E RREZIKSHME

17.1 Në rastin e zbulimit të ndonjë materiali apo substance të rrezikshme, toksike, apo të ndotur nën, sipër dhe/ose në Territorin e Projektit, Shoqëria Koncesionare:

- a) njofton menjëherë Autoritetin Përkatës dhe Autoritetin Kontraktor; dhe
- b) merr të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar sigurinë e njerëzve dhe të pronës.

17.2 Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare, ndërmerret të gjithë hapat e nevojshëm për largimin dhe/ose neutralizimin e materialeve apo substancave të tilla (në përputhje me miratimet, Standardet dhe Ligjin). Për qëllime të largimit dhe/ose neutralizimit të materialeve ose substancave të tilla, Shoqëria Koncesionare e lejon Autoritetin Përkatës që të hyjë në Territorin e Projektit dhe të zbatojë udhëzimet e Autoritetit Përkatës.

17.3 Nëse gjatë kryerjes së Punimeve, Shoqëria Koncesionare zbulon në Territorin e Projektit ndonjë material apo substancë të rrezikshme, toksike apo të ndotur, që (i) nuk është sjellë në Territorin e Projektit nga Shoqëria Koncesionare ose nga ndonjë Palë Koncesionare, apo (ii) Shoqëria Koncesionare nuk kishte mundësi t'i kishte identifikuar apo zbuluar ato përpara datës së nënshkrimit si nga Të Dhënat e Vëna në Dispozicion, apo nga hetimi me sy i Territorit të Projektit dhe nga hetimi i ndonjë shenje të jashtme në sipërfaqe, atëherë zbulimi në Territorin e Projektit i materialeve apo substancave të tilla të paparashikueshme, të rrezikshme, toksike ose të ndotura, në rast shkaktimi të dëmeve apo vonesave për Shoqërinë Koncesionare, do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

NENI 18

LEJET E NEVOJSHME

18.1 Lejet ekzistuese dhe miratimet e nevojshme të autoritetit kontraktor/autoriteteve përkatëse

18.1.1 Autoriteti Kontraktor i miraton Shoqërisë Koncesionare të gjitha lejet dhe miratimet e nevojshme të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me parashikimet e legjislacionit kombëtar në fuqi, të cilat disponohen dhe janë kompetencë e Autoritetit Kontraktor, dhe bën të gjitha përpjekjet që Autoritetet Përkatëse të bëjnë të njëjtën gjë me lejet dhe miratimet që janë në kompetencë të këtyre autoriteteve, menjëherë pas aplikimit të Shoqërisë Koncesionare, me qëllim që kjo e fundit të fillojë dhe përfundojë Punimet në përputhje me Projekt Zbatimin.

- 18.1.2 Në rastin kur Autoriteti Kontraktor apo një Autoritet Përkatës nuk e jep në kohën e duhur lejen ose miratimin e nevojshëm, me qëllim fillimin dhe vazhdimin e Punimeve në përputhje me Projekt Zbatimin, atëherë kjo do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku, përveç rasteve kur Shoqëria Koncesionare nuk ka përmbushur kërkesat dhe formalitetet ligjore përkatëse.
- 18.1.3 Në rastin kur një leje ekzistuese ose miratimi i nevojshëm i Autoritetit Kontraktor apo i një Autoriteti Përkatës hiqet, revokohet, ndryshohet (jo me kërkesë të Shoqërisë Koncesionare), pezullohet ose ndryshe deklarohet e pavlefshme, për shkak të një veprimi të gabuar ose të një mosveprimi që nuk ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve dhe/apo mosveprimeve të Shoqërisë Koncesionare, atëherë kjo do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.
- 18.1.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për aplikimin dhe marrjen e të gjitha lejeve që dalin në emër dhe për llogari të tij. Dokumentacioni ndihmës për këto aplikime përgatitet nga Shoqëria Koncesionare. Shoqëria Koncesionare do të jetë përgjegjëse për aplikimin dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe formaliteteve ligjore që duhen për marrjen e të gjitha lejeve dhe miratimeve shtesë (nëse duhen të tilla pas lejeve dhe miratimeve fillestare) të nevojshme pranë Autoritetit Kontraktor apo Autoriteteve Përkatëse, vetëm në rastet kur aplikimi dhe/ose marrja e këtyre lejeve apo miratimeve shtesë bëhet në emër dhe për llogari të Shoqërisë Koncesionare, ose dokumentacioni shtesë duhet të paraqitet edhe në emër të Shoqërisë Koncesionare. Autoriteti Kontraktor garanton dhe anagazhohet se do të bëjë çdo përpjekje për të mbështetur Shoqërinë Koncesionare në marrjen e të gjitha lejeve dhe miratimeve të nevojshme, si dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar që, në varësi të përmbushjes nga ana e Koncesionarit të të gjitha kërkesave dhe formaliteteve ligjore, lejet të lëshohen dhe miratohen nga ana e Autoriteteve Përkatëse. Në rastin kur lejet apo miratimet shtesë jepen në emër dhe për llogari të Autoritetit Kontraktor, atëherë Shoqëria Koncesionare, për sa është e mundur, është përgjegjëse për përgatitjen e kërkesave të nevojshme që Autoriteti Kontraktor të aplikojë për marrjen e këtyre lejeve dhe miratimeve. Në rast të vonesave në zbatimin e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, të shkaktuara si pasojë e mos dhënies apo vonesave të lëshimit të lejeve dhe miratimeve nga Autoritetet Përkatëse apo Autoritetit Kontraktor, jo për faj të Shoqërisë Koncesionare, atëherë këto vonesa mund të përbëjnë një Shkak Lehtësimi dhe në rast të kostove të shtuara, Shkak Kompensimi.

NENI 19

INXHINIERI I PAVARUR

19.1 Emërimi

19.1.1 Brendaditësh nga data e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate, Autoritetit Kontraktues përgatit dokumentacionin e tenderit që kërkohet për përzgjedhjen e Inxhinierit të Pavarur. Një dokumentacion i tillë do të përmbajë por nuk do të kufizohet me:

- (i) Objektin e punës së Inxhinierit të Pavarur, pra termat e references i cili do të bazohet në atë që përmbahet në Shtojcën 11;
- (ii) Kriteret, mbi të cilët do të përzgjidhet Inxhinieri i Pavarur; dhe
- (iii) Termat kyç të kontratës për emërimin dhe detyrat e Inxhinierit të Pavarur, sipas detyrave kyç, të përcaktuara në Shtojcën 11.

19.1.2 Autoriteti Kontraktor e kontraktin Inxhinierin e Pavarur brenda 6 (gjashtë) Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi e kësaj Kontrate dhe përzgjedhja e tij bëhet në përputhje me Ligjin shqiptar për Prokurimet Publike.

19.2 Detyrat dhe Autoriteti i inxhinierit të pavarur

19.2.1 Detyrat

Detyrat e Inxhinierit të Pavarur duhet të caktohen në kontratën për Inxhinierin e Pavarur, por as emërimi apo angazhimi i Inxhinierit të Pavarur e as ushtrimi apo jo-ushtrimi i detyrave të tilla nga Inxhinieri i Pavarur nuk duhet që në ndonjë mënyrë të clirojë koncesionarin nga ndonjë përgjegjësi apo ndonjë prej detyrimeve të tij në bazë të kësaj Kontrate.

19.2.1.1 Inxhinieri i Pavarur i plotëson detyrimet e tij për raportim te Autoriteti Kontraktor dhe te Shoqëria Koncesionare drejtpërdrejt dhe njëkohësisht;

19.2.1.2 Objekti i shërbimeve dhe shkalla e të drejtave dhe detyrimeve të Inxhinierit të Pavarur janë në përputhje me Kontratën, e cila përmban detyrimet kryesore të Inxhinierit të Pavarur të përcaktuara në Shtojcën 11;

19.2.1.3 Inxhinieri i Pavarur i ofron shërbimet e tij, në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate si dhe kontratës së Inxhinierit të Pavarur dhe këtë e bën në mënyrë të paanshme dhe të pavarur;

19.2.1.4 Përpara zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje, Inxhinieri i Pavarur u jep Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare mundësinë që të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen përkatëse;

19.2.1.5 Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të konsultohet me Inxhinierin e Pavarur në lidhje me të gjitha aspektet e çdo çështjeje, që ka të bëjë me Punimet ose me ndonjë Riparim Kapital.

19.2.1.6 Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të kërkojë tek Autoriteti Kontraktor fillimin e procedurave për zgjidhjen e Kontratës së Inxhinierit të Pavarur, ose zëvendësimin e Inxhinierit të Pavarur në rast të shkeljeve të dispozitave të Kontratës apo të Kontratës së Inxhinierit të Pavarur nga ana e tij, si dhe në rast të pengesave të pajustificuara dhe të

përsëritura të Inxhinierit të Pavarur kundrejt Shoqërisë Koncesionare, në përmbushjen e detyrimeve të këtij të fundit sipas kësaj Kontrate.

19.2.1.7 Në rast se, gjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të lindë nevoja, autoriteti kontraktor kontraktin përsëri një inxhinier të pavarur për një periudhë të caktuar, sikurse parashikuar në këtë kontratë.

Në rast të zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Inxhinierit të Pavarur nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit do ta njoftojë Shoqërinë Koncesionare paraprakisht.

19.2.2 Autoriteti i inxhinierit të pavarur

19.2.2.1 Te dy palët pajtohen që të pranojnë si final dhe detyrues çdo vendim të marrë nga Inxhinieri i Pavarur me ushtrimin e duhur të autoritetit të tij sipas Kontratës për Inxhinierin e Pavarur, përveç nëse merren vesh ndryshe në Marrëveshjen për Inxhinierin e Pavarur

19.2.2.2 Pas marrjes së raporteve apo dokumenteve me informacion nga Inxhinieri i Pavarur, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i parashtrijë Shoqërisë Koncesionare mendimet e tij në lidhje me to.

19.2.2.3 Nëse kjo Kontratë kërkon që Inxhinieri i Pavarur të japë vendimin, mendimin, pëlqimin, miratimin e tij ose të përcaktojë masat e duhura, në varësi të pikës 19.2.2.4 më poshtë, ky vendim, mendim, pëlqim, miratim ose përcaktim i masave të duhura nga Inxhinieri i Pavarur është detyrues për Palën përkatëse që duhet të veprojë në përputhje me të.

19.2.2.4 Nëse ndonjëra nga Palët është e pakënaqur me vendimin, mendimin, pëlqimin, ose masat e urdhëruara nga Inxhinieri i Pavarur, atëherë kjo Palë e njofton Palën tjetër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit përkatës nga Inxhinieri i Pavarur, me kusht që në asnjë rrethanë Shoqëria Koncesionare të mos ketë të drejtë të pezullojë, ndalojë, ose ndërpresë në ndonjë mënyrë tjetër Punimet gjatë procesit të zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje të tillë, me përjashtim të punëve që preken drejtpërdrejt nga mosmarrëveshja, si dhe të punëve përfundimi apo kryerja e të cilave varet drejtpërdrejt nga rezultati i zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në rast se njëra Palë është e pakënaqur me vendimin e Inxhinierit të Pavarur, aplikohet neni 53.

19.2.2.5 Për shmangien e çdo dyshimi, Shoqëria Koncesionare nuk mban përgjegjësi për mospërmbushjen e ndonjë detyrimi ose përgjegjësie të saj, në rast se kjo mospërmbushje vjen për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve nga Inxhinieri i Pavarur, në përputhje me këtë Kontratë si dhe Kontratën e Inxhinierit të Pavarur.

19.2.2.6 Në rast se Inxhinieri i Pavarur nuk emërohet në kohën e përcaktuar në këtë nen, apo në rast se veprimtaria e tij në funksion të zbatimit të kësaj Kontrate dhe Kontratës së Inxhinierit të Pavarur pezullohet, ndalohet apo braktiset për çfarëdolloj arsye, ose kur brenda afatit 6 mujor për emërimin e tij lind nevoja, Palët bien dakord që Autoriteti Kontraktor apo ndonjë Person i autorizuar/emëruar nga ai, do të kryejë funksionin e Inxhinierit të Pavarur deri në emërimin e Inxhinierit të Pavarur apo zëvendësimin e tij.

19.3 Inspektimi, mbikqyrja dhe raportimi

19.3.1 Inxhinieri i Pavarur kryen inspektime për të verifikuar dhe ndjekur kryerjen e Punimeve sipas Projekt Zbatimit, nga ana e Shoqërisë Koncesionare.

19.3.2 Gjatë Periudhes Ndërtimore, Inxhinieri i Pavarur, do të kontrollojë dhe mbikqyrë Punimet. Një kontroll i tillë përfshin ndjekjen e aktivitetit në çdo fazë të punës, me qëllim për të siguruar që Punimet po kryhen në përputhje me kërkesat e cilësisë së Autoritetit Kontraktor, Standardet, si dhe në përputhje me Projekt Zbatimin e miratuar.

19.3.3 Inxhinieri i Pavarur ka të drejtë të ndjekë takimet për ecurinë e Punimeve, të cilat zhvillohen ndërmjet Shoqërisë Koncesionare dhe Nënkontraktorëve të Ndërtimit, dhe të marrë njoftimet përkatëse për kohën dhe vendin e takimeve të tilla.

19.3.4 Shoqëria Koncesionare/Koncesionari pajtohet dhe merr përsipër të:

- a) sigurojë që Inxhinierit të Pavarur i është dhënë qasje e mjaftueshme në territorin e projektit dhe në objektet tjera në të cilat është duke u rehabilituar apo ku kryhet ndonjë pjesë e Punëve Ndërtimore në çdo kohë për qëllime monitorimi të Punëve Ndërtimore; me kusht që Inxhinieri i Pavarur ose përfaqësuesit e tij, sipas nevojës, do t'i nënshtrohet, dhe duhet të jetë në pajtueshmëri me procedurat e mbrojtjes dhe sigurisë në fuqi përgjithësisht të aplikuara nga koncesionari për individë të cilëve iu është dhënë qasje në objekt.
- b) sigurojë që Inxhinierit të Pavarur i është dhënë, pas një njoftimi të arsyeshëm dhe gjatë orarit normal të punës, qasje tek persona dhe dokumente të tilla të cilat i Inxhinieri i Pavarur kërkon me baza të arsyeshme;
- c) sigurojë çdo ndihmesë dhe qasje tek çdo pajisje dhe material që mund të kërkohet arsyeshëm nga Inxhinieri i Pavarur;
- d) lejohet Inxhinierit të Pavarur, me një njoftim paraprak të një (1) Ditë pune, që formalisht të inspektojë, kontrollojë, hulumtoj apo ndryshe të testojë çdo aspekt të Punëve Ndërtimore si dhe progresin tyre, me kusht që Inxhinieri i Pavarur të bëjë çdo përpjekje për të minimizuar çfarëdo ndërrpreje të panevojshme të punëve ndërtimore;
- e) mos ndërhyjë në apo ndryshe të pengoj kryerjen e detyrave dhe obligimeve nga Inxhinieri i Pavarur me këtë Kontratë apo kontratën për Inxhinierin e Pavarur; dhe
- f) menjëherë të korrigjojë çdo defekt, gabim, vonesë apo dështim tjetër të identifikuar nga Inxhinieri i Pavarur.

19.4 Kostoja

Kostot e lindura në lidhje me përzgjedhjen, emërimin dhe punën e Inxhinierit të Pavarur përballohen nga Autoriteti Kontraktor.

19.5 Afati

Kontrata fillestare e Inxhinierit të Pavarur bëhet për një kohë deri në mbarim të Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet e Punimeve (periudha e garancisë së Punimeve sipas parashikimeve të kësaj Kontrate). Më pas, çdo Kontratë e Inxhinierit të Pavarur duhet të jetë të paktën për një periudhë maksimale që parashikon legjislacioni shqiptar për prokurimet publike.

19.6 Zëvendësimi

Nëse Inxhinieri i Pavarur jep dorëheqje, ose ndryshe duhet të zëvendësohet, një Inxhinier i Pavarur i ri do të emërohet në përputhje me nenin 19.1.

KREU 3

DETYRAT E KONCESIONARIT

NENI 20

MASTERPLANI I AEROPORTIT, PROJEKTI I ZBATIMIT DHE PROJEKTI I ZBATUAR FAKTIKISHT

20.1 Masterplani i Aeroportit

- 20.1.1 Shoqëria Koncesionare ka detyrimin të përgatitë MasterPlanin e Aeroportit në zbatim të programit të punimeve, brenda Ditëve Kalendarike nga nënshkrimi i kësaj kontrate, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe standardet ndërkombëtare.
- 20.1.2 Shoqëria Koncesionare do të ketë të drejtën të rishikojë MasterPlanin e Aeroportit, cdo 5(pesë) vjet mbas datës së fillimit, në përputhje me zhvillimet teknologjike, financiare, teknike dhe zhvillime të tjera, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe standardet ndërkombëtare. MasterPlani i rishikuar i Aeroportit dorëzohet për miratim tek Autoriteti Kontraktues nëpërmjet Inxhinierit të pavarur.
- 20.1.3 Autoriteti Kontraktor bën komentet e tij në lidhje me masterplanin e aeroportit , nëse ka, dhe i komunikon ato tek Shoqëria KoncesionareDitëve Kalendarike. Komentet e Autoritetit Kontraktor lidhen vetëm me rastet kur masterplani nuk është në përputhje me me legjislacionin e aplikueshëm dhe standardet ndërkombëtare.

- 20.1.4 Autoriteti Kontraktues do të aprovojë ose refuzojë miratimin e MasterPlanit të rishikuar të Aeroportit dhe/ose Projektin e Zbatimit mbi bazën e rekomandimeve të Inxhinierit të Pavarur ose entiteteve të tjera shtetërore brendaDitëve Kalendarike, nga data e dorëzimit të tij nga koncesionari. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk jep aprovimin ose refuzimin brendaDitëve Kalendarike, miratimi do të konsiderohet i dhënë në formë të heshtur.
- 20.1.5 Nëse Autoriteti Kontraktues do të refuzojë MasterPlanin e rishikuar të Aeroportit mbi bazën e rekomandimeve të Inxhinierit të Pavarur, ai nuk duhet ta vonojë përgjigjen si dhe duhet ta argumentojë dhe arsyetojë atë në cdo rast. Çdo vonesë apo kosto e shkaktuar kundrejt Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare si rrjedhojë e vonesës së Autoritetit Kontraktor, do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

20.2 Projekt zbatimi

- 20.2.1 Shoqërisë Koncesionare i janë vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor objekti dhe informacione të tjera në lidhje me Projektin (“**Projekt Ideja**”). Projekt Ideja është pjesë e Dokumentacionit të Tenderit. Shoqëria Koncesionare ka të drejtë t’i modifikojë Skicat e Projektimit e të Ndërtimit gjatë hartimit të Projekt Zbatimit.
- 20.2.2 Projekti i hollësishëm përfundimtar do të konsiderohet në këtë Kontratë si Projekt Zbatimi (në vijim “Projekt Zbatimi”), dhe do të bëhet pjesë integrale e kësaj Kontrate. Në rast të një mospërputhje me Projekt Idenë ka përparësi Projekt Zbatimi i miratuar.
- 20.2.3 Shoqëria Koncesionare harton Projekt Zbatimin dhe siguron që të gjitha Skicat e Ndërtimit të hollësishme përfundimtare të projektimit në kuadër të Projekt Zbatimit të jenë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe Autoriteti Përkatës si dhe rregullave të përcaktuara në legjislacionin përkatës. Shoqëria Koncesionare e dorëzon Projekt Zbatimin tek Autoriteti Kontraktor brendaMuajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi e Kontratës. Autoriteti Kontraktor njofton Shoqërinë Koncesionare për vendimin e këtij të fundit.
- 20.2.4 Shoqëria Koncesionare harton Projekt Zbatimin në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me Projekt Idenë, specifikimet teknike, ofertën e tij, legjislacionin e aplikueshëm dhe standardet e ndërtimit të aeroporteve sipas Aneksit 14 të ICAO dhe MasterPlanin e aeroportit. Projekti i zbatimit të punimeve nuk mund të ndryshohet pa dakordësi mes palëve pas konsultimeve me shkrim për ndryshimet e propozuara/nevojshme, në përputhje me Projekt Idenë. Shoqëria Koncesionare do siguroj që në kërkesat për dizenjimin e aeroportit krahas kërkesave të arkitekturës dhe të infrastrukturës, të integrohen edhe masat e nevojshme të sigurisë në përputhje me PKSAC, si në fazën e dizenjimit të objekteve të reja ashtu dhe në rastet e zgjerimit të objekteve ekzistuese. (ICAO SARPs 3.2.3 Aneks 17)
- 20.2.5 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta refuzojë ose të kërkojë ndryshimin e projektit të zbatimit vetëm nëse nuk është në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, me specifikimet teknike dhe standardet e ndërtimit të aeroporteve sipas Aneksit 14 të ICAO

- dhe MasterPlanin e aeroportit. Në çdo rast këto ndryshime, nuk duhet të kalojnë masëntë vlerës së projektit të zbatimit.
- 20.2.6 Nëse Autoriteti Kontraktues e refuzon projektin kryesor të ndërtimit në tërësi apo pjesërisht, koncesionari ka për detyrë ta përpunojë projektin kryesor dhe t'ia paraqesë Autoritetit Kontraktues për miratim projektin e përmirësuar brenda afatit të caktuar nga Autoriteti Kontraktues
- 20.2.7 Çdo dokumentacion i Projekt Zbatimit i krijuar nga Shoqëria Koncesionare në kuadër të një skice të hollësishme përfundimtare të projektimit i dorëzohet Autoriteti Kontraktor për miratim. Autoriteti Kontraktor bën komentet e tij për Dokumentacionin e Projekt Zbatimit, nëse ka, dhe i komunikon ato tek Shoqëria Koncesionare brendaDitësh kalendarike. Komentet e Autoritetit Kontraktor lidhen vetëm me rastet kur Projekt Zbatimi nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 20.2.4.
- 20.2.8 Në rastin kur Autoriteti Kontraktor paraqet komente, atëherë brendaDitëve kalendarike nga marrja e tyre Palët takohen për të diskutuar mbi komentet e paraqitura. Shoqëria Koncesionare ka afatDitë kalendarike për të rregulluar Projekt Zbatimin në përputhje me komentet dhe për t'a dorëzuar Projekt Zbatimin e rregulluar tek Autoriteti Kontraktor. Pas dorëzimit nga ana e Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor ka një afatDitë kalendarike nga Data e Dorëzimit të Projekt Zbatimit, për të miratuar këtë të fundit.
- 20.2.9 Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk shprehet brenda një afati prejDitësh kalendarike, atëherë miratimi do të konsiderohet i dhënë.
- 20.2.10 Shoqëria koncesionare duhet të fillojë ndërtimin jo më vonë semuaj nga data e miratimit të projekt zbatimit nga Autoriteti Kontraktues.
- 20.2.11 Shoqëria Koncesionare duhet të garantojë që Njoftimi i Përfundimit do të lëshohet jo më vonë semuaj nga Data e Fillimit të punimeve, përvec se ku deklарohet ndryshe nga kjo kontratë.

20.3 Projekti i Zbatuar faktikisht

Menjëherë pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe nënshkrimit nga të dyja palët të certifikatës për përfundimin e punëve ndërtimore, shoqëria koncesionare ka për detyrë t'ia dorëzojë Autoritetit Kontraktues projektin e objektit të zbatuar faktikisht. Pranimi i projektit të objektit të ndërtuar të zbatuar faktikisht nga Autoriteti Kontraktues nuk e cliron koncesionarin nga detyrimet e tij të përcaktuara në këtë kontratë.

NENI 21

ZONA ZHVILLIMORE DHE ZONA E MBROJTUR

21.1 Zona zhvillimore

21.1.1 Kur ndërtimi dhe instalimi i infrastrukturës aeronautike të nevojshme për Projektin nuk mund të ndërtohet brenda Zonës së Konkensionit, atëherë ndërtimi ose instalimi do të kryhet në Zonën Zhvillimore. Procedurat për këtë shpronësim do të ndiqen nga Autoritetit Kontraktues dhe pagesat e lidhura me te do të mbulohen nga Koncesionari.

21.1.2 Autoriteti Kontraktues duhet të garantojë që:

- a) Zona Zhvillimore duhet të jetë e lirë nga cdo strukturë, godinë ose pengesa të ngjashme për ndërtimin, që janë të domosdoshme për operimin e Aeroportit sipas kufizimeve të sigurisë dhe të sigurisë në operim.
- b) Cdo planifikim urban në zonë duhet të marrë parasysh MasterPlanin e Aeroportit dhe kufizimet për zhvillime dhe ndërtime sipas kësaj Kontrate. Për të shmangur çdo dyshim, në çdo rast do merret miratimi paraprak i shoqërisë koncesionare.
- c) Asnjë autorizim nuk do tu jepet palëve të treta për të përdorur apo për të ndërtuar në Zonën Zhvillimore, e cila mund të interferojë me performancën e sistemit primar apo sekondar të radarëve dhe/ose të faciliteteve, ose të jenë në kundërshti me kufizimet e sigurisë dhe sigurisë në operim të detajuara në Aneksin 14 të ICAO dhe/ose Konventa të tjera të ngjashme ose në kundërshtim me të drejtat e shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate.

21.2 Zona e Mbrojtur e Aeroportit dhe Kufizimet Ndërtimore

21.2.1 Zona e Mbrojtur e Aeroportit dhe Kufizimet Ndërtimore do të ripërcaktohen në përputhje me MasterPlanin e miratuar të Aeroportit dhe të aprovohen nga Autoriteti Kontraktor si dhe entet e tjera përgjegjëse, brendaDitëve Kalendarike nga dorëzimi nga shoqëria Koncesionare.

21.2.2 Autoriteti Kontraktor duhet të garantojë se Zona e Mbrojtur e Aeroportit duhet në cdo kohë të jetë e lirë nga cdo strukturë, ndërtesë, facilitet, rrugë apo pengesa të tjera për sigurinë në operim të aeroportit, në linjë me kufizimet e Sigurisë së aviacionit (*Security*) dhe sigurisë në operim (*safety*) të Anekseve 2, 6, 8, 14, 17 të ICAO..

NENI 22

MENAXHIMI I OBJEKTIT DERI NË DORËZIMIN E TIJ DHE MARRJA E ÇERTIFIKATAVE

22.1 Personat e Paautorizuar

Shoqëria Koncesionare merr të gjitha masat paraprake që të mos lejojë që Personat e paautorizuar të futen në Territorin e Projektit. Gjatë kryerjes së një aktiviteti në Kantier gjatë Periudhave Ndërtimore, Koncesionari mund t'i rrethojë këto zona për evitimin e hyrjes së Personave të paautorizuar në Territorin e Projektit. Shoqëria Koncesionare merr të gjitha masat paraprake për (i) të mbajtur personelin dhe pajisjet e tij brenda Territorit të Projektit, (ii) angazhohet që secili nga Nënkontraktorët e tij të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake për të mbajtur personelin dhe pajisjet e tyre brenda Territorit të Projektit, si dhe (iii) nuk i lejon ata të futen në tokat që ndodhen pranë, përveçse kur është e nevojshme për zbatimin e detyrave të Kontratës.

22.2 Largimi i Mbetjeve

Shoqëria Koncesionare e mban Territorin e Projektit të pastër nga mbetjet apo pengesat e panevojshme dhe i magazinon ose i largon të gjitha pajisjet, Objektet e Përkohshme ose materialet e tepërta. Shoqëria Koncesionare pastron ose largon nga Territori i Projektit çdo mbeturinë, mbetje apo punë të përkohshme që nuk është më e nevojshme për Projektin.

22.3 Menaxhimi i Cilësisë

Shoqëria Koncesionare përgatit dhe zbaton, në lidhje me çdo fazë të Projekt Zbatimit, sisteme kontrolli dhe sigurimi të cilësisë, në përputhje me Standardin. Shoqëria Koncesionare angazhohet që secili nga Nënkontraktorët të respektojë të njëjtat Standarde.

Koncesionari do të marrë certifikatat për (a) ISO 9001 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, (b) ISO 10002 Sistemi i Menaxhimit të Ankesave dhe (c) ISO 14001 Sistemi i Menaxhimit të Ambientit në lidhje me aeroportin para përvjetorit të dytë të Datës së hyrjes në fuqi të kontratës. Certifikata të cilat duhet të jenë të vlefshme përgjatë Kohëzgjatjes së kontratës.

22.4 Kontrolli i Cilësisë

Autoriteti Kontraktor ose çdo institucion apo Person i ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor, duhet të bëjë herë pas here, kur e zgjedh vetë, me shpenzimet e tij, një kontroll të procedurave të kontrollit të cilësisë së Shoqërisë Koncesionare dhe të Nënkontraktorëve për të siguruar kontrollin e kryerjes së detyrimeve sipas kësaj Kontrate.

22.5 Përfundimi i Punimeve

Përfundimi i Punimeve në aeroport nënkupton se:

- a) Ndertimi për fillimin e operimit ka përfunduar ; dhe
- b) Është dhënë kolaudimi dhe/ose marrja në dorëzim (që lëshohet nga Autoriteti Përkates).

22.6 Dorëzimi Teknik dhe/ose Kolaudimi pas Përfundimit

Jo më pak seDitë kalendarike para datës kur Shoqëria Koncesionare parashikon se do të përfundojnë Punimet, njofton me shkrim inxhinierin e pavarur dhe Autoritetin Kontraktues. Shoqëria Koncesionare i paraqet Inxhinierit të Pavarur Dokumentacionin e Projektit sipas procedurës së dakordësuar të dorëzimit teknik së bashku me shtesat, nëse ka, në Skicat e Ndërtimit të përditësuar të projektimit me ndryshimet përkatëse të bëra gjatë ndërtimit, për qëllime inspektimi (vizatimet/gjendjen faktike). Kjo procedurë zbatohet nga Inxhinieri i Pavarur, Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Koncesionare, Nënkontraktori i Ndërtimit dhe çdo Autoritet Përkatës i duhur, i cili ftohet ose prania e të cilit kërkohet me Ligj. Shoqëria Koncesionare i bashkëngjijt njoftimit me shkrim të përmendur me lart, certifikatën e Inxhinierit të Pavarur, e cila konfirmon se Punimet janë përfunduar dhe janë përmbushur plotësisht.

22.7 Marrja e Certifikatave të Përdorimit

22.7.1 Shoqëria Koncesionare bën kërkesë për çdo certifikatë Përdorimi dhe Autoriteti Kontraktor detyrohet të japë ndihmën e nevojshme që ajo të pajiset me to, nëse Shoqëria Koncesionare ka përmbushur të gjitha detyrimet e kësaj Kontrate pajiset me certifikatën e Inxhinierit të Pavarur, sipas përcaktimit të pikës 22.6.

22.7.2 Shoqëria Koncesionare e njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor për datën e inspektimit të Territorit të Projektit nga Autoriteti Përkatës. Autoriteti Kontraktor mund të marrë pjesë në çdo inspektim, i cili kryhet nga çdo Autoritet Përkatës, për të përcaktuar nëse mund të lëshohet një Certifikatë Përdorimi.

22.7.3 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk e lëshon Certifikatën e Përdorimit brenda periudhës së parashikuar me Ligj, megjithëse Inxhinieri i Pavarur dhe Autoriteti Kontraktor nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim për Punimet dhe nga ana tjetër as nuk kërkohet të merren masa të tjera për përfundimin e Punimeve, me kusht që:

- a) Koncesionari të ketë përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe dispozitave përkatëse të Ligjit kur ka bërë kërkesë për Certifikatën e Përdorimit; dhe
- b) Gjatë inspektimit zyrtar nga Autoriteti Kontraktor përpara kërkesës për Certifikatën e Përdorimit, Autoriteti nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim, në përputhje me Ligjin që konstaton mos-përmbushjen e detyrimeve ose të kushteve të nevojshme për lëshimin e Certifikatës së Përdorimit;

atëherë kjo do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

22.7.4 Koncesionari do të jetë përgjegjës për zhvillimin, zbatimin, për certifikimin dhe mbajtjen të vlefshëm të certifikatës së aeroportit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, të gjithë Autorizimet e kërkuara dhe standartet ndërkombëtare.

NENI 23

DEFEKTET

23.1 Përgjegjësia për Defektet

- 23.1.1 Pa cënuar asnjë të drejtë tjetër të Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i kërkojë Shoqërisë Koncesionare riparimin e çdo Defekti në Punime me shpenzimet e veta, në përputhje me këtë Kontratë, gjatë periudhës përkatëse të përgjegjësisë së tij për Defektet ("Periudha e Përgjegjësisë së Defekteve").
- 23.1.2 Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse dhe kryen sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur çdo ndërtim, riparim ose Punime të tjera që kërkohen si rrjedhojë e një Defekti, përveç sa është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë.
- 23.1.3 Me përfundimin e një Punimi, në përputhje me pikën 22.6, Inxhinieri i Pavarur vërteton se këto Punime janë kryer në përputhje me Standardet sipas Dokumentacionit të Projektit. Në masën që Punime të tilla nuk janë përfunduar në përputhje me Standardet, Koncesionarit i kërkohet të kryejë Punime të tjera deri në plotësim të tyre.

Për të shmangur çdo dyshim, Palët Koncesionare gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe fazave të saj, nuk do të jenë përgjegjëse për Defekte të cilat janë rezultat i një Shkaku Kompensimi, Shkaku Lehtësimi apo Ngjarjeje të Forcës Madhore.

23.2 Procedura për Riparimin e Defekteve

- 23.2.1 Nëse gjatë periudhës së operimit të aeroportit, del në pah një Defekt, Koncesionari do të rregullojë Defektin/Defektet. Projekti/veprimet për eliminimin e Defektit të ndodhur do të miratohen paraprakisht nga Inxhinieri i Pavarur. Kostoja e riparimit të Defekteve do të përballohet nga Koncesionari.
- 23.2.2 Koncesionari në çdo kohë:
- a) Kryen Punimet dhe shërbimet për të mos e përkeqësuar një Defekt dhe;
 - b) Sapo merr dijeni për një Defekt, bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të zbutur pasojën e atij Defekti; dhe
 - c) Ndërmerr të gjitha hapat për të minimizuar pasojat e çdo Defekti të njohur.
- Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur brendaDitësh kalendarike nga marrja dijeni ose konstatimi i një Defekti, dhe pas kësaj i jep Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me Defektin. Inxhinieri i Pavarur, në bazë të këtij informacioni, jep mendimin e tij brenda një periudhe të arsyeshme, lidhur me aplikimin e masave për riparimin e tij.
- 23.2.3 Jo më vonë seDitë Kalendarike pasi merr dijeni ose konstaton një Defekt, Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një propozim

për punime riparuese për ndreqjen e Defektit. Jo më vonë seDitë Kalendarike pas marrjes së propozimit të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktor ose e miraton atë me shkrim, ose sugjeron ndryshimet përkatëse në propozimin e Koncesionarit.

- 23.2.4 Nëse Autoriteti Kontraktor vlerëson se i duhet më shumë kohë për shqyrtimin e propozimit, afati shtesë do t'i bëhet i ditur me shkrim Koncesionarit, por ky afat shtesë nuk mund të jetë më shumë seDitë të tjera Kalendarike. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk përgjigjet në lidhje me propozimin e Koncesionarit, atëherë propozimi do të quhet i miratuar.
- 23.2.5 Nëse Autoriteti Kontraktor sugjeron ndryshime në propozimin e Koncesionarit, Koncesionari brendaDitësh Kalendarike nga marrja e ndryshimeve të sugjeruara ia kalon propozimin Inxhinierit të Pavarur, i cili menjëherë jep një vendim përfundimtar për propozimin. Vendimi i Inxhinierit të Pavarur është detyrues për Palët, përveç kur njëra nga Palët e kundërshton atë, në përputhje me nenin 53, brendaDitësh Kalendarike nga marrja e vendimit të Inxhinierit të Pavarur.

NENI 24

OPERIMI I AERODROMIT

Që nga data e përfundimit të punimeve ndërtimore dhe marrja e certifikatës së përdorimit sipas nenit 22.7 më sipër, shoqërisë koncesionare i lind e drejta për të aplikuar pranë autoritetit përkatës për certifikimin e aeroportit në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10040 datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të lëshuara në zbatim të tij.

Me marrjen e certifikates së aeroportit, shoqëria koncesionare ka për detyrë që me shpenzime të veta, të operojë objektin dhe të ofrojë shërbimet siç janë specifikuar në këtë kontratë dhe shtojcat e kësaj kontrate.

24.1 Shërbimet e Aerodromit

Duke filluar nga data e zbatimit të kësaj kontrate, përveç nëse palët bien dakort ndryshe, Koncesionari është i detyruar të sigurojë, apo të bëjë sigurimin, me kosto dhe shpenzimet të tij të Shërbimeve të Aeroportit (sipas shtojcës 4), gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate në përputhje me Standardet, Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes, Indikatorët Kyç të Performancës, Planin Emergjent të Aeroportit, Planin e Menaxhimit Mjedisor, legjislacionin në fuqi dhe kushtet e aplikueshme. Përveç për ndonjë mbyllje apo pezullim të operimeve sipas 16.1 apo që mund të rezultojë nga efektet e ndonjë Emergjence, ndonjë Force Madhore, Koncesionari pajtohet të marrë përsipër të sigurojë që aeroporti do të jetë i hapur dhe operacional gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Shoqëria Koncesionare ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të sigurojë të gjitha lejet,

miratimet, autorizimet, certifikimet dhe licensimet që nevojiten për kryerjen e shërbimeve. Autoriteti Kontraktues ka detyrimin të asistojë shoqërinë koncesionare në marrjen e lejeve.

24.2 Shërbimet në Tokë

24.2.1 Shoqëria Koncesionare do të sigurojë shërbime në tokë për ndonjë dhe për të gjitha fluturimet që arrijnë dhe largohen nga aeroporti.

24.2.2 Aksesi i hyrjes në tregun e shërbimeve të përpunimit në tokë do të jetë sipas legjislacionit në fuqi.

24.3 Perimetri i sigurise

Koncesionari duhet që me kosto dhe shpenzim të tij të mirëmbajë një perimetër adekuat të rrethuar me barriera dhe kontroll, brenda dhe rreth objektit, në përputhje me ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e aplikueshme përfshirë edhe Standardet e Aneksit 17, Dok 30 të ECAC dhe ato kombëtare.

24.4 Pajisjet

24.4.1 Koncesionari duhet që me kosto dhe shpenzimet e veta, të porosisë, sigurojë dhe mirëmbajë pajisjet që të funksionojnë si duhet, në një sasi dhe cilësi të mjaftueshme dhe në përputhje me kërkesat kombëtare sa është e nevojshme për përgatitje nga koncesionari të Shërbimeve të Aeroportit, përfshirë, por duke mos u kufizuar në: Shërbimet e Sigurisë së Aeroportit, Shërbimet CFR dhe Shërbimet Shëndetësore, në përputhje me Standardet, Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes, Programin e Sigurisë së Aeroportit, Planet e Kontigjencës, Indikatorët Kyç të Performancës, Planin Emergjent të Aeroportit, Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

24.4.2 Koncesionari duhet që me kosto dhe shpenzimet e veta të sigurojë dhe mirëmbajë në gjendje të mirë pune pajisjet ndihmëse vizuale në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ICAO SARPssa është e nevojshme në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror nga Autoriteti kompetent.

24.5 Emergjencat

24.5.1 Shoqëria koncesionare ka detyrimin të hartojë ‘‘Planin e Menaxhimit të Emergjencave’’, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standartet e miratuara, shtojca 14 e kësaj kontrate. Plani i menaxhimit të emergjencave hartohet dhe i dorëzohet për miratim Autoritetit Kontraktor jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Miratimi apo rishikimi i tij nga palët, bëhet në përputhje me nenin 20.1.2, 20.1.3, 20.1.4, 20.1.5, të kësaj kontrate.

24.5.2 Shoqëria Koncesionare bie dakord që çdo autoritet kompetent mund të ndërmarë të gjitha veprimet që i konsideron të nevojshme për të parandaluar apo për të reaguar në një rast emergjent, gjë që mund të përfshijë edhe mbylljen e objektit ose pezullimin e operimit të objektit. Koncesionari ka për detyrë që me mirëbesim dhe me kujdesin e duhur të ofrojë tërë mbështetjen që mund të kërkohej nga autoriteti kompetent.

Përgjatë Periudhës së kësaj kontrate, shoqëria koncesionare duhet të koordinohet me Operatorin dhe Autoritetet përgjegjëse që të mirëmbajë, rishikojë dhe zbatoj një Plan Emergjent të Aeroportit dhe të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve në rast të Emergjencës. Shoqëria Koncesionare pranon dhe pajtohet, megjithatë, se çdo Autoritet kompetent mund të ndërmarrë hapa të tillë siç mund nevojitet për të lehtësuar apo parandaluar çdo Emergjencë (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në mbylljen apo pezullimin e operimeve të aeroportit-së si rezultat i Emergjencës apo sipas Planit Emergjent të Aeroportit).

24.6 Shërbimet publike dhe operacionale

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, shoqëria koncesionare ka për detyrë që, me shpenzime të veta, si dhe në pajtim me ligjin, të kujdeset që objekti të furnizohet vazhdimisht dhe në sasi të mjaftueshme me (i) ujë të pijshëm, (ii) energji elektrike, (iii) shërbime për grumbullimin e ujërave të zeza, dhe (iv) shërbime të telekomunikacionit.

Për të shmangur dyshimet, Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për furnizimin me energji elektrike nga rrjeti elektrik deri tek Zona e Koncesionit. Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për furnizimin me ujë nga rrjeti hidrik/ i ujësjellësit deri tek Zona e Koncesionit. Në rast se Qeveria nuk realizon në kohë ndërhyrjen për furnizimin me energji, ujë, apo kanalizimin e ujrave të zeza, koncesionari mund ta bëjë atë me shpenzimet e tij, për të cilat ka të drejtën e kompensimit nga Autoriteti Kontraktor. Këto kushte përbëjnë shkak kompensimi, shkak lehtësimi, veçmas ose së bashku.

Shoqëria Koncesionare ka për detyrë që, me shpenzime të veta, të sigurojë të gjitha shërbimet për parandalimin e zjarrit, zjarrfikjes, shërbime mjekësore dhe të shpëtimit si dhe shërbime të sigurimit të objektit.

24.7 Mjedisi

24.7.1 Shoqëria koncesionare ka detyrimin të hartojë ‘‘Planin e Menaxhimit Mjedisor’’, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standartet e miratuara, shtojca 13 e kësaj kontrate. Plani i menaxhimit të Mjedisit hartohet dhe i dorëzohet për miratim Autoritetit Kontraktor jo më vonë se 9 (nëntë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Miratimi apo rishikimi i tij nga palët, bëhet në përputhje me nenin 20.1.2, 20.1.3, 20.1.4, 20.1.5, të kësaj kontrate.

- 24.7.2 Shoqëria Koncesionare ka për detyrë që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe që kërkohen me ligj për të mbrojtur mjedisin në objekt /territorin e projektit dhe të kufizojë dëmet, pengesat dhe rreziqet që mund t’iu shkaktohen personave dhe pronave private nga dëmtimet e mjedisit dhe pasojave të tjera të dëmshme për mjedisin që rezultojnë nga operimi i objektit. Shoqëria Koncesionare nuk është përgjegjëse ndaj personave të tretë për zhurmën që mund të shkaktohet nga operimi i objektit me kusht që zhurma është në kuadër të niveleve të lejuara me ligj. Për të shmangur çdo dyshim, koncesionari nuk do të jete përgjegjës ndaj palëve të treta për zhurmën që çlirohet nga avionët.
- 24.7.3 Koncesionari duhet të sigurojë se emetimi i ajrit, shkarkimet sipërfaqësore dhe rrjedhëse dhe trajtimi apo heqja e çdo mbeturine që del nga aeroporti gjatë Periudhës së kësaj Marrëveshje duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Planin e Menaxhimit Mjedisor.
- 24.7.4 Koncesionari nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë Gjendje Para-ekzistuese Mjedisore dhe do të jetë përgjegjës vetëm për ndonjë ndikim material negativ në mjedis apo ndotje ose ndonjë material që është i dëmshëm me pasoja në shëndet i cili del nga aeroporti pas Datës së zbatimit të kontratës.
- 24.7.5 Koncesionari duhet të sigurojë se të gjithë, nënkontraktuesit e tij, të licencuarit, shitesit ekskluzive dhe qiramarrësit pajtohen me Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e aplikueshme në lidhje me Mjedisin në lidhje me aktivitetet e ndërmarra në aeroport.

24.8 Personeli dhe Trajnimet

Koncesionari duhet me kosto dhe shpenzime të vetat të:

- a) punësojë në aeroport, apo të nxisë punësimin apo ndryshe të angazhojë si personel në të, një numër të personave të trajnuar dhe me përvojë të mjaftueshme që të bëjë aeroportin operues, të sigurojë Shërbimet e Aeroportit dhe të funksionalizojë çfarëdo Zhvillimi të Aeroportit, të gjitha në përputhje me Standardet e ICAO, të ECAC, PKSAC, Indikatorët Kyç të Performancës, Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes, Programin e Sigurisë së Aeroportit dhe Planet e Kontigjencës;
- b) sigurojë trajnime dhe programe profesionale të rregullta dhe të vazhdueshme për të gjithë punëtorët apo personelin tjetër të angazhuar nga koncesionari në përputhje me Standardet.

24.9 Periudha e Operimit

- 24.9.1 Periudha e operimit fillon pas përfundimit të plotë dhe lëshimit të Certifikates të Përdorimit, sipas të cilës vërtetohet se Punimet janë kryer sipas Projekt Zbatimit të paraqitur nga Koncesionari (në këtë kontratë “**Faza e Operimit**”), si dhe lëshimit të certifikatës së operimit.
- 24.9.2 Shoqëria Koncesionare do të ofrojë Shërbimet e Operimit, gjatë gjithë periudhës së

parashikuar për Operim, në përputhje me certifikatën e aeroportit të lëshuar nga Autoritetit përgjegjës dhe Manualin e Operimit dhe të Mirëmbajtjes sipas Shtojcës 12 dhe në zbatim të të gjithë standardeve dhe kërkesave të zbatueshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

24.9.3 Në ofrimin e Shërbimeve të operimit dhe mirëmbajtjen, Shoqëria Koncesionare gjatë gjithë kohës bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme të nevojshme për të siguruar që të mos veprojnë në ndonjë mënyrë që të ndikojë negativisht në funksionimin e aeroportit dhe të trafikut të saj.

24.10 Sherbimet Komerciale të aeroportit

Shoqëria koncesionare do të jetë e detyruar të sigurojë ose të nxisë që të sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme, të arsyeshme për operimin e sigurt dhe të vazhdueshëm të aeroportit duke përfshirë por pa kufizim, sigurimin e objekteve si dhe shërbimet komerciale të aeroportit sic janë:

- a) Ushqimi dhe pijet
- b) Shërbimet bankare dhe zyrat e këmbimit valutor
- c) Reklamimi dhe publiciteti
- d) Shitje me pakicë dhe/ose mallrave të liruara nga dogana (duty free)
- e) Si dhe çdo shërbim tjetër që ofrohet zakonisht në aeroportet ndërkombëtare, që përndryshe nuk është shërbim që sigurohet nga Autoriteti Kontraktues

NENI 25

MIRËMBAJTJA

25.1 Nëse shoqëria koncesionare nuk e kryen në formën dhe standardin e kërkuar mirëmbajtjen, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë përbushjen e këtij detyrimi sipas standardeve të parashikuara në Shtojcën 12.

25.2 Shoqëria koncesionare ka për detyrë të mbajë një regjistër të incidenteve, përfshirë shkeljet, ngjarjet dhe aktet e ndërhyrjes së paligjshme ndaj sigurisë së aviacionit, ku shënohen data dhe koha e incidentit, përshkrimi i incidentit dhe veprimet që ka ndërmarrë shoqëria koncesionare në lidhje me incidentin, përfshirë dhe detyrimet për raportimet në AAC dhe/ ose Autoritetin Kombëtar të Hetimit të Incidenteve dhe Aksidenteve .

25.3 Duke filluar në çdo moment pas Datës së Fillimit të Zbatimit të Kontratës, por jo më vonë seDitë kalendarike nga fillimi i Fazës së Operimit së aeroportit sipas Projekt Zbatimit të paraqitur nga Shoqëria Koncesionare, kjo e fundit në përputhje me kërkesat e Manualit të Operimit dhe Mirëmbajtjes sipas Shtojcës 12 (pjesë e kësaj Kontrate), përgatit dhe i paraqet Autoritetit Kontraktor të gjithë Programin në lidhje me menaxhimin e Mirëmbajtjes së aeroportit (në vijim “Plani i Mirëmbajtjes”).

25.4 BrendaDitësh Kalendarike pas marrjes nga Autoriteti Kontraktor të Planit për Mirëmbajtjen e aeroportit nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet

Autoritetit përgjegjës AAC, miraton Planin e Mirëmbajtjes ose paraqet vërejtjet apo rekomandimet e tij, gjithnjë në përputhje me Manualin e Operimit dhe Mirëmbajtjes sipas Shtojcës 12 (“Manuali i Operimit dhe Mirëmbajtjes”). Në rast se ka vërejtje dhe/ose rekomandime nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit së bashku me paraqitjen e vërejtjeve dhe/ose rekomandimeve i cakton Shoqërisë Koncesionare edhe një datë për takimin midis Palëve për të diskutuar Planin dhe vërejtjet dhe/ose rekomandimet e Autoritetit Kontraktor. Shoqëria Koncesionare angazhohet se do të vlerësojë me kujdes dhe mirëbesim çdo parashtrim të bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me Planin e Mirëmbajtjes. BrendaDitësh kalendarike pas takimit dhe gjithsesi brendaDitësh kalendarike nga data e marrjes së vërejtjeve apo rekomandimeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, ajo i dërgon Autoritetit Kontraktor, versionin përfundimtar të Planit të Mirëmbajtjes dhe në rast të mosmarrjes parasysh të vërejtjeve dhe rekomandimeve të Autoritetit Kontraktor i dërgon edhe një relacion shpjegues për arsyet e mosmarrjes parasysh. Versioni përfundimtar i dërguar nga Shoqëria Koncesionare do të konsiderohet si përfundimtari dhe nuk është i nevojshëm miratimi i mëtejshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor.

25.5 Palët do të hartojnë Planin e Mirëmbajtjes në bashkëpunim me Inxhinierin e Pavarur.

25.6 Çdo nevojë për ndryshim të mëvonshëm të Planit të Mirëmbajtjes nga ana e Shoqërisë Koncesionare do të ndjekë të njëjtën procedurë dhe afat si për miratimin e tij fillestar, sipas paragrafit të mësipërm.

NENI 26

AMENDAMENTET NË MANUALIN E OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES

26.1 Shoqëria Koncesionare mund të propozojë tek Autoriteti Kontraktor ndryshimin e Manualit të Operimit dhe të Mirëmbajtjes sipas Shtojcës 12. Brenda Ditësh kalendarike pas marrjes së propozimeve për ndryshim, Autoriteti Kontraktor vetë, ose nëpërmjet Autoritetit Përkatës përgjegjës, miraton propozimet ose paraqet me shkrim vërejtjet apo rekomandimet e tij.

26.2 Në rast se ka vërejtje dhe/ose rekomandime nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit së bashku me paraqitjen e vërejtjeve dhe rekomandimeve i cakton Shoqërisë Koncesionare edhe një datë për takimin midis Palëve për të diskutuar propozimet për ndryshimin e Manualit të operimit dhe të Mirëmbajtjes si dhe vërejtjet e rekomandimet e Autoritetit Kontraktor.

26.3 Shoqëria Koncesionare duhet të vlerësojë me kujdes dhe mirëbesim çdo parashtrim të bërë nga Autoriteti Kontraktor apo Autoritetet përgjegjëse, në lidhje me Manualin e Operimit dhe të Mirëmbajtjes.

26.4 Brenda Ditësh Kalendarike pas takimit dhe gjithsesi brendaDitësh Kalendarike nga data e marrjes së vërejtjeve apo rekomandimeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, Shoqëria Koncesionare i dërgon për miratim Autoritetit Kontraktor, versionin e rishikuar të propozimeve për ndryshimin e Manualit të Operimit dhe të Mirëmbajtjes sipas

vërejtjeve dhe rekomandimeve të Autortietit Kontraktor.

26.5 Autoriteti duhet të përgjigjet në lidhje me propozimin e ri brenda një afati prejDitësh Kalendarike nga dita e dërgimit të propozimit të ndryshuar. Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk përgjigjet apo nuk e miraton propozimin e Shoqërisë Koncesionare, atëherë do të vazhdojë të jetë në fuqi Manuali i Operimit dhe Mirëmbajtjes aktual.

26.6 Palët mund të vazhdojnë të diskutojnë dhe negociojnë për ndryshimet e nevojshme të Manualit të Operimit dhe të Mirëmbajtjes, deri në gjetjen e dakordësisë dhe dhënien e miratimit për këto ndryshime nga Autoriteti Kontraktor.

NENI 27

DETYRIMET E SHOQËRISË KONCESIONARE GJATË FAZËS SË OPERIMIT

27.1 Shoqëria Koncesionare ndërmerr (dhe angazhohet që çdo Nënkontraktor si dhe punonjësit e tij do të ndërmarrin) të gjitha veprimet e nevojshme për të operuar dhe mirëmbajtur aeroportin në atë mënyrë që të sigurojë:

- a) Shfrytëzimin e pandërprerë dhe të sigurtë të aeroportit në bazë 24-orëshe, përveç rasteve të Ngjarjeve të Forcës Madhore, aksidenteve apo ngjarjeve të tjera që e bëjnë atë të pashfrytëzueshme;
- b) Respektimin e Manualit/leve të operimit dhe Mirëmbajtjes, me kusht dhe në përputhje me kërkesat për Shërbimet e Operimit dhe Mirëmbajtjes të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor si dhe Standardet dhe Propozimet e Shoqërisë Koncesionare për Operimin sipas propozimit të ofertës fituese.
- c) Vepron sa më shpejt që të jetë e mundur ndaj, emergjencave apo incidenteve të tjerë, për aq sa parashikohet në Manualin/let e Operimit dhe Mirëmbajtjes;
- d) Përveçse rasteve të jashtëzakonshme apo të një ndodhie të paparashikuar, Shoqëria Koncesionare u jep Përdoruesve dhe Autoritetit Kontraktor, për aq sa është e mundur, paralajmërimet e nevojshme për çdo ngjarje që ndikon në përdorimin e aeroportit nga ana e tyre.
- e) Kur një Punim për mirëmbajtje, riparim apo Punime të tjera, e bën të nevojshme ndërprerjen apo pezullimin e përdorimit të aeroportit, apo mbylljen e tij për një periudhë kohe, Shoqëria Koncesionare i jep (i) Autoritetit Kontraktor, (ii) Autoritetit Përkatës të përfshirë, si dhe (iii) çdo Pale të interesuar dhe të gjithë Përdoruesve të prekur, me anë të mjeteve të disponueshme, njoftim paraprak për një rast të tillë, përveç rasteve të emergjencës ose të një çrregullimi të vogël. Në rastin e një urgjence, apo të një çrregullimi të vogël në aeroport, nuk kërkohet ndonjë njoftim paraprak, megjithatë, sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi brenda një afati të arsyeshëm, Shoqëria Koncesionare i jep Autoritetit Kontraktor dhe çdo Autoriteti Përkatës, shpjegimet e ngjarjes në fjalë
- f) Shoqëria Koncesionare bën në çdo kohë përpjekjet e saj të arsyeshme, për të minimizuar ose

- evituar shqetësimet që i shkaktohen trafikut të aeroportit.
- 27.2** Shoqëria Koncensionare do të jetë përgjegjëse për sigurinë në operim (safety) dhe sigurinë e aviacionit në Zonën e Koncensionit. Qeveria e Shqipërisë do të jetë përgjegjëse për sigurinë publike në Zonën e Koncensionit dhe jashtë saj.
- 27.3** Koncensionari duhet të pregatisë një plan sigurie, pjesë e Programit të Sigurisë së Aeroportit, sipas Kodit Ajror dhe PKSAC, jo më vonë se..... ditë përpara datës së fillimit të operimeve dhe duhet të dorëzohet tek Autoriteti Kontraktor dhe Autoriteti Përgjegjës.
- 27.4** Koncensionari duhet të pregatisë një plan të sigurisë në operim, pjesë integrale e Manualit të aerodromit dhe të Manualit të Operimit, jo më vonë seditë përpara datës së fillimit të operimeve dhe duhet të dorëzohet tek Autoriteti Kontraktor dhe Autoriteti Përgjegjës.
- 27.5** Në rast se Koncensionari vendos të nënkontrakttojë (delegojë) aktivitetet e sigurisë në aviacion apo të sigurisë në operim në Zonën e Koncensionit, Koncensionari duhet ta bëjë këtë në përputhje të plotë me këtë Kontratë dhe të gjithë legjislacionin e aplikueshëm dhe me parakusht të miratimit të këtij delegimi nga Autoriteti Kontraktues apo entitete të tjera shtetërore. Kompania e përzgjedhur nga Koncensionari do të jetë përgjegjëse për aplikimin për t'u pajisur dhe për të ruajtur të gjithë autorizimet dhe pranimet e kërkuara për zhvillimin e aktiviteteve në lidhje me sigurinë në operim apo sigurinë e aviacionit civil.
- 27.6** I gjithë stafi i angazhuar në aktivitete të sigurisë në aviacion apo sigurisë në operim të aeroportit, dhe stafi i angazhuar në operimet në zonën ajrore, do të jetë subjekt i procedurave specifike të rekrutimit dhe të trajnimit e certifikimit në përputhje me Prog. Komb. të Trajnimeve të Sigurisë së Aviacionit Civil në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm vendas dhe detyrimeve të Konventave ndërkombëtare. Asnjë person apo nënkontraktor nuk mund të ndërmarrë aktivitete që lidhen me sigurinë e aviacionit dhe/ose sigurinë në operim të aeroportit në Zonën e Koncensionit pa miratim paraprak të Koncensionarit dhe të AAC, në përputhje me këtë Kontratë dhe të gjithë legjislacionin e aplikueshëm.

NENI 28

SHËRBIME TË TJERA

28.1 Impiantet e Karburanteve dhe Shërbimet e Furnizimit

Shoqëria Koncesionare do të jetë përgjegjëse për shërbimet e furnizimit të karburanteve në aeroport dhe do të sigurojë që ruajtja adekuatë e karburantit dhe shërbimet e furnizimit janë në dispozicion në çdo kohë gjatë afatit të kësaj kontrate. Shërbimet e furnizimit me karburant duhet të plotësojnë kushtet e furnizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe me këtë kontrate. Koncesionari do të sigurojë që shërbimet e furnizimit të plotësojnë të gjitha standardet përkatëse dhe në

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurave konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

pajtueshmëri me të gjitha normat dhe ligjet në fuqi. Koncesionari mund të ofrojë shërbimet e mësipërme në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes ofruesve të shërbimeve të palës së tretë.

28.2 Kontratat dhe Qiratë

- 28.2.1 Koncesionari mund të kontrakttojë Bashkëpunëtorët e tij apo ndonjë Person tjetër për ofrimin e ndonjërës apo të gjitha Shërbimeve të Aeroportit apo Zhvillimeve të Aeroportit dhe mund të japë me qira ndonjë pjesë të objektit ndonjë Bashkëpunëtori të tij apo ndonjë Personi tjetër për të kryer ndonjë apo të gjitha Shërbimet e Aeroportit apo Zhvillimet e Aeroportit apo aktivitete të tjera. Çdo qiradhënie e tillë mund të përfshijë tërë apo një pjesë të terminalit, ndërtesës apo strukturës së vendosur mbi atë, me përjashtim të hapësirave dhe ndërtesa të aeroportit (i) të rezervuara për forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë, (ii) që kërkohen me arsye nga ndonjë Autoritet Relevant apo ndonjë Person tjetër i emëruar nga një Autoritet Relevant i tillë për të kryer ndonjë nga Shërbimet Qeveritare.
- 28.2.2 Përvec nëse koncesionari bie dakort ndryshe me shkrim, për çdo kontratë apo qiradhënie të mëparshme do të merren masa për ndërprerjen e tyre.
- 28.2.3 Asnjë nga kontratat apo qiradhëniet e tilla apo ndonjë amendament nuk e cliron koncesionarin nga ndonjë prej detyrimeve të tij persa i përket Shërbimeve të tilla të Aeroportit sipas kësaj kontrate;
- 28.2.4 Koncesionari duhet të sigurohet se kushtet komerciale të ndonjë kontrate apo qiradhënie të tillë apo amendament është në pajtim me legjislacionin në fuqi.

KREU 4

NGJARJE TË VEÇANTA

NENI 29

SHKAK KOMPENSIMI

29.1 Në rast se, si rrjedhojë e një Shkaku Kompensimi:

- a) Shoqëria Koncesionare vonohet në kryerjen e Punimeve sipas Programit; ose
- b) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tjera të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; ose
- c) Shoqërisë Koncesionare i kanë lindur ose do t'i lindin kosto që nuk do t'i kishin lindur, apo nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura që ndryshe do të ishin gjeneruar, po të mos kish ndodhur një Shkak i tillë Kompensimi,

Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të kërkojë një, disa nga ose të gjitha përfitimet e mëposhtme të aplikueshme sipas rastit, në formën e:

69 | F a q e

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit te perzgjedhur si me i suksesshmi.

- i) Një shtyrjeje të datës së programuar të përfundimit paraprak të punimeve ndërtimore për vonesën e pësuar nga Shoqëria Koncesionare sipas programit të saj;
- ii) Përjashtimit nga përmbushja e detyrimeve të saj për aq dhe në masën sa ato janë prekur nga ndodhja e Shkakut të Kompensimit;
- iii) Të drejtës për kompensim; dhe/ose
- iv) Mospalikimit të dispozitave për zgjidhjen e Kontratës për Mospërmbushjen e Detyrimeve të Koncesionarit /Shoqërisë Koncesionare për aq sa Shkaku i Kompensimit ka shkaktuar mospërmbushjen ose ka kontribuar materialisht për të.

29.2 Kur vonesa në zbatimin e afateve të poshtëpërmendura të njoftimit nuk është shkaktuar nga Koncesionari ose është shkaktuar për arsye që nuk varen nga Koncesionari, Shoqëria Koncesionare siguron përfitime sipas Nenit 29.1 më sipër, në rrethana kur ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e saj për të marrë ndonjë prej këtyre përfitimeve pa vonesa të tepërta, por gjithsesi, jo më vonë se maksimumi:

29.2.1Ditë kalendarike pasi Shoqëria Koncesionare ka marrë dijani për ndodhjen e Shkakut të Kompensimit; dhe

29.2.2 jo më vonë seDitë kalendarike pas dorëzimit të njoftimit të përmendur në paragrafin 29.2.1 më sipër:

- a) I ka dhënë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një shpjegim të plotë dhe të hollësishtëm për Shkakun e Kompensimit dhe përfitimet e kërkuara;
- b) Në rastin e një vonese, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kohëzgjatjen e përafërt të kësaj vonese;
- c) E ka vënë në dijani Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për çdo informacion tjetër përkatës, që lidhet me Shkakun e Kompensimit; dhe
- d) E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për humbjen e pritshme të të ardhurave, ose për një rritje të kostove që rezultojnë nga një Shkak Kompensimi,

me kusht që, në rast se informacioni i plotë nuk është i disponueshem brendaDitësh kalendarike nga dhënia e njoftimit sipas Nenit 29.2.1, Shoqëria Koncesionare të dërgojë një njoftim ku të parashtrijë të gjithë informacionin e disponueshem dhe çdoDitë kalendarike pas paraqitjes të këtij njoftimi t'u japë informacion të mëtejshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur; dhe

29.2.3 T'i ketë provuar Inxhinierit të Pavarur se:

- a) Shkaku i Kompensimit ka rezultuar ose do të rezultojë në shtyrjen e Punimeve, mospërmbushjen e detyrimeve të tjera të Koncesionarit, shtimin e kostove, ose mos gjenerimin e të ardhurave nga Koncesionari; dhe
- b) Koncesionari i ka bërë të gjitha përpjekjet, nëse Shkaku i Kompensimit linte mundësi të arsyeshme për përpjekje nga ana e Koncesionarit, që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Koncesionari, për të parandaluar apo zbutur pasojat e një Shkaku Kompensim. Për shmangien e çdo dyshimi, përfitimi i pretenduar i korrespondon vetëm pasojave të Shkakut të Kompensimit, e cila nuk mund të ishte parandaluar apo zbutur nga Koncesionari me anë të bërjes së përpjekjeve të tilla të arsyeshme.

29.2.4 Nëse Shoqëria Koncesionare i ka përmbushur detyrimet e parashikuara në Nenin 29.2 dhe Inxhinieri i Pavarur e ka bërë një njoftim, ku deklaron se ka ndodhur një Shkak Kompensimi dhe se Shoqërisë Koncesionare i duhet hequr përkatësisht përgjegjësia për mospërmbushjen e detyrimit të saj, në përputhje me Nenin 29.1, atëherë:

- a) Kur është e përshtatshme, data e programuar e përfundimit të punimeve ndërtimore shtyhet për një periudhë kohe të përcaktuar nga Inxhinieri i Pavarur, por gjithsesi jo më të shkurtër sesa periudha e vonësës e shkaktuar nga Shkaku i Kompensimit; dhe/ose
- b) Nëse Shoqëria Koncesionare i ka bërë, ose do të bëjë shpenzime shtesë, ose ka pësuar ose do të pësojë humbje të të ardhurave, që ndryshe nuk do t'i kishte bërë/do t'i kishte gjeneruar, po të mos kish ndodhur një Shkak i tillë Kompensimi, Autoriteti Kontraktor e rimbursion Shoqërinë Koncesionare për shpenzime të tilla dhe/ose humbje të të ardhurave, me qëllim që kthejë Shoqërinë Koncesionare në një gjendje që nuk është as më e mirë as më e keqe se më parë. Shuma e një rimbursimi të tillë do të përcaktohet, për aq sa është e mundur, me anë të përdorimit të Modelit Financiar, ose situacioneve faktike; dhe/ose
- c) Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij të Përfundimit të Parakohshëm të Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve nga Koncesionari të detyrimeve të tij, shkaktuar nga Shkaku i Kompensimit; dhe/ose
- d) Autoriteti Kontraktor i ofron Shoqërisë Koncesionare mundësinë e përjashtimit nga detyrimet e tij, që rrjedhin nga kjo Kontratë, të cilat përcaktohen nga Inxhinieri i Pavarur,

me kusht që, nëse Shoqëria Koncesionare ose Autoriteti Kontraktor nuk bien dakord me njoftimin me shkrim të bërë nga Inxhinieri i Pavarur në përputhje me këtë nen, çdo mosmarrëveshje të vendoset në përputhje me nenin 53. Njoftimi me shkrim i Inxhinierit të Pavarur është detyrues për Palët, përveçse kur njëra nga Palët e kundërshton atë brendaDitëve Kalendarike nga data e

njoftimit të Inxhinierit të Pavarur në lidhje me ndodhjen e një Shkaku Kompensimi, në përputhje me procedurën e mëposhtme:

BrendaDitëve kalendarike nga kundërshtimi i Palës, Palët do të mbajnë një takim të parë së bashku edhe me Inxhinierin e Pavarur për të diskutuar në detaj argumentat e Palëve si dhe të Inxhinierit të Pavarur në lidhje me Shkakun e Kompensimit. Palët do të mbajnë gjithsejtakime me një hapësirë kohore prej Ditësh kalendarike njëra nga tjetra. Në fund të takimeve Inxhinieri i Pavarur do të dalë me një vendim përfundimtar i cili është i detyrueshëm për Palët përveçse kur ato vendosin të zbatojnë nenin 53 të kësaj Kontrate. Palët bien dakord që, nëse Autoriteti Kontraktor vendos ti drejtohet Procesit të Arbitrazhit sipas nenit 44 të kësaj Kontrate për të zgjidhur mosmarrëveshjen e lindur sipas këtij Neni, atëherë deri në marrjen e një vendimi të Gjykatës, Shoqëria Koncesionare ka të drejtën, por jo detyrimin, që të pezullojë kryerjen e mëtejshme të Punimeve të Ndërtimit apo Operimin.

29.3 Përveçse sipas parashikimeve të Nenit 29.2, nëse Shoqëria Koncesionare nuk i jep Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur informacionin deri në njërin nga afatet e parashikuara, ai nuk merr asnjë nga përfitimet e lartpërmendura si rezultat i Shkakut të Kompensimit.

29.4 Shoqëria Koncesionare është e detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur menjëherë në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër dhe/ose material në lidhje me një Shkak Kompensimi, si dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që tregojnë se informacioni i dhënë më parë ka qenë materialisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.

NENI 30

SHKAQE LEHTËSIMI

30.1 Kur si rrjedhojë e një Shkaku Lehtësimit:

30.1.1 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë Punimet me qëllim që të mund të sigurojë Certifikatën e Përdorimit, paraprake ose përfundimtare, deri në datën e programuar të përfundimit paraprak, ose në datën e programuar të përfundimit ; ose

30.1.2 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjërin prej detyrimeve të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë;

atëherë

Shoqëria Koncesionare mund të sigurojë përfitimet e mëposhtme të aplikueshme sipas rastit, në formën e:

- i) Shtyrjes së datës së programuar të përfundimit paraprak ose të datës së programuar të përfundimit, që i përshtatet vonesës së shkaktuar Koncesionarit në bazë të Programit të tij; dhe/ose
- ii) Lehtësimit nga detyrimet e tij ose shtyrja e zbatimit të tyre, për aq dhe deri në masën sa ato janë prekur nga ndodhia e Shkakut Lehtësues; dhe/ose
- iii) Pas dhënies së lejes së Çertifikatës së Përdorimit/akt kolaudimit, në rastin e një Shkaku Lehtësues si rezultat i të cilit Koncesionari nuk është në gjendje të përmbushë të gjitha ose një pjesë materiale të detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Kontratë, për një periudhë më shumë sejavë, ose për shkak të ndonjë arsyeje tjetër të vlefshme, e cila, ka shkaktuar një vonesë prej më shumë seMuajsh (periudhë e cila përfshin çdo Shkak Lehtësues që ndodh përpara dhënies së Çertifikatës së Përdorimit, pas miratimit/konfirmimit nga Inxhinieri i Pavarur, përfiton mos-aplikimin e dispozitave për zgjidhjen e Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare të detyrimeve të saj, për aq sa Mospërmbushja nga Shoqëria Koncesionare e detyrimeve ka ardhur si rrjedhojë e një Shkaku Lehtësues, apo nëse një shkak i tillë ka kontribuar në shkallë thelbësore.

30.2 Përveçse kur vonesa në zbatimin e afateve të poshtëpërmendura të njoftimit nuk është shkaktuar nga Koncesionari ose është shkaktuar për arsye që nuk varen nga Koncesionari, Koncesionari i siguron përfitime të tilla vetëm në rrethanat kur ai:

30.2.1 E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesë, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi.....;

30.2.2 Jo më vonë seDitë kalendarike pas dorëzimit të njoftimit sipas paragrafit 30.2.1 më lart:

- a) I ka dhënë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një shpjegim të plotë rreth Shkakut Lehtësues dhe përfitimeve të kërkuara;
- b) Në rastin e një vonese të shkaktuar nga Shkaku i Lehtësimit, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kohëzgjatjen e vlerësuar të një vonese të tillë; dhe
- c) E ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për çdo informacion tjetër përkatës, me kusht që, nëse informacioni i plotë nuk është i disponueshëm brendaDitësh kalendarike nga dhënia e njoftimit sipas Nenit 30.2.1, Shoqëria Koncesionare

do t'u dërgojë një njoftim Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur, ku të paraqesë të gjithë informacionin e disponueshëm dhe më pas t'u japë informacion të mëtejshëm çdoDitë kalendarike pas paraqitjes së këtij njoftimi; dhe

30.2.3 T'i ketë provuar Inxhinierit të Pavarur se:

- a) Shkaku Lehtësues ka rezultuar në shtyrjen e Datës së Programuar të Përfundimit Paraprak ose të Datës së Programuar të Përfundimit, ose në Mospërmbushjen e Detyrimeve të tjera të Shoqërisë Koncesionare; dhe
- b) Shoqëria Koncesionare i ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme, në varësi të Shkakut të Lehtësimit, që mund t'i kërkohej Shoqërisë Koncesionare në mënyrë të arsyeshme, për të parandaluar ose zbutur pasojat e Shkakut të Lehtësimit. Për shmangien e çdo dyshimi, përfitimi i kërkuar i korrespondon vetëm pasojave të Shkakut të Lehtësimit, e cila nuk mund të ishte parandaluar apo zbutur nga Shoqëria Koncesionare.

30.3 Nëse Shoqëria Koncesionare i ka kryer detyrimet e parashikuara në Nenin 30.2, dhe Inxhinieri i Pavarur ka dhënë një njoftim me shkrim ku deklaron se ka ndodhur një Shkak Lehtësimi, dhe përcakton ndihmën e duhur që i duhet dhënë Koncesionarit në përputhje me këtë Nen 30.3, atëherë:

- a) Sipas rastit, data përkatëse e programuar për përfundimin paraprak ose data e programuar për përfundimin përkatës shtyhen me një periudhë kohe që përcaktohet nga Inxhinieri i Pavarur, por gjithsesi jo më të shkurtër sesa periudha e vonësës së shkaktuar nga Shkaku i Lehtësimit; dhe
- b) Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij për përfundimin e parakohshëm të Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve të Detyrimeve nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, në lidhje me një shkelje të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, shkaktuar nga Shkaku Lehtësues; dhe
- c) Autoriteti Kontraktor e përjashton Shoqërinë Koncesionare nga detyrimet e saj, që rrjedhin nga kjo Kontratë, të cilat përcaktohen nga Inxhinieri i Pavarur, me kusht që, nëse Shoqëria Koncesionare ose Autoriteti Kontraktor nuk bien dakord me njoftimin me shkrim të Inxhinierit të Pavarur, dhënë në përputhje me këtë nen, çdo mosmarrëveshje të vendoset në përputhje me procedurën e mëposhtme:
 - (i) Brenda Ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit me shkrim të Inxhinierit të Pavarur, Palët do të mbajnë një takim të parë së bashku edhe me Inxhinierin e Pavarur për të diskutuar në detaj argumentat e Palëve si dhe të Inxhinierit të Pavarur në lidhje me shkakun e kompensimit.
 - (ii) Palët do të mbajnë gjithsejtakime me një hapësirë kohore prejDitësh Pune nga njëri-tjetri. Inxhinieri i Pavarur do të dalë me një vendim i cili është bërë i detyrueshëm për Palët përveçse kur ato vendosin të zbatojnë nenin 53 të kësaj Kontrate. Palët bien dakord që, nëse Autoriteti Kontraktor vendos t'i drejtohet Procesit të Arbitrazhit sipas

nenin 53 të kësaj Kontrate për të zgjidhur mosmarrëveshjen e lindur sipas këtij Neni, atëherë deri në marrjen e një vendimi të Gjykatës, Shoqëria Koncesionare ka të drejtën, por jo detyrimin, që të pezullojë kryerjen e mëtejshme të Punimeve të Ndërtimit apo Operimin.

30.4 Përveçse sipas parashikimeve të Nenit 29.2, në rast se Shoqëria Koncesionare nuk u jep informacion Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur deri në njërin nga afatet e parashikuara në këtë nen, ai nuk do të marrë asnjë nga përfitimet e mësipërme që rrjedhin nga Shkaku i Lehtësimit, derisa të dërgojë një informacion të tillë brenda afatit të përcaktuar në Nenin 30.2.

30.5 Shoqëria Koncesionare është e detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur pa vonesa të justifikuar në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër material në lidhje me një Shkak të paparashikuar Lehtësues si dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që tregojnë se informacioni i dhënë më parë ka qenë materialisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.

30.6 Në rastin kur një Shkak Lehtësimi, ose pasojat e tij vazhdojnë të mbeten të tilla që:

a) Në varësi të nenit 30, vonesa në dhënien e Certifikatës së Përfundimit paraprak ose Certifikata e Përfundimit kalon Muaj; ose

b) Në varësi të nenit 30, Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë të gjithë ose një pjesë materiale të detyrimeve të saj, që rrjedhin nga kjo Kontratë, për një periudhë që i kalonMuaj,

Të dyja Palët do të takohen për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme, që ka të bëjë me të tilla Shkaqe të zgjatura Lehtësimi. Nëse të dy Palët nuk bien dakord për vazhdimin e përfitimeve të Shkakut të Lehtësimit brendaditësh kalendarike, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me nenin 53.

c) Në rastin kur Shkaku i Lehtësimit, i përshkruar në pikën (d) të përkufizimeve të Shkaku i Lehtësimit, vazhdon ose pasojat e saj vazhdojnë të mbeten të tilla që:

i) Vonesa në dhënien e Certifikatës së Përdorimit i tejkalonMuaj; ose

ii) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje që të përmbushë të gjitha ose një pjesë të rëndësishme të detyrimeve të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë për një periudhë që i tejkalon Muaj,

Të dyja Palët do të takohen për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme që ka të bëjë me të tilla Shkaqe Lehtësimi. Nëse të dy Palët nuk bien dakord për vazhdimin e përfitimeve për Shkaqet e Lehtësimit brendaditësh kalendarike, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me nenin 53 të kësaj kontrate. Për të shmangur çdo keqinterpretim, mosdhënia e miratimit, ose refuzimi duhet të jetë i argumentuar në bazë të objektit dhe detyrimeve të kësaj kontrate.

NENI 31

NGJARJE TË FORCËS MADHORE

31.1 Asnjë Palë nuk ka të drejtë të bëjë një padi ndaj Palës tjetër për shkelje të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore dhe në masën që një Ngjarje e Forcës Madhore e pengon të kryejë detyrimet e veta.

31.2 Kur ndodh një Ngjarje e një Forcë Madhore, Pala e Prekur e njofton Palën tjetër pa vonesa të arsyeshme. Njoftimi përfshin hollësitë për ndikimin e kësaj ngjarjeje në detyrimet e Palës së Prekur dhe për çdo veprim të propozuar për zbutjen e pasojave të saj.

31.3 Pa vonesa të arsyeshme, pas një njoftimi të tillë Palët konsultohen me njëra tjetrën me mirëbesim dhe bëjnë përpjekje të arsyeshme për të rënë dakord për kushtet e përshtatshme për zbutjen e efekteve të Ngjarjes së shkaktuar nga Forca Madhore dhe për të lehtësuar realizimin në vijimësi të Kontratës.

31.4 Kur Palët nuk bien dakord për kushte të tilla brendaMuajsh nga data e fillimit të Ngjarjes së shkaktuar nga Forca Madhore, dhe një forcë e tillë madhore vazhdon, ose pasojat e saj vazhdojnë të jenë të tilla saqë Pala e Prekur nuk është në gjendje t'i përmbushë të gjitha, ose pjesën më të madhe të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë një njoftim paraprakditë përpara Palës tjetër ("**Njoftim për Përfundimin e Kontratës për Shkak të Ngjarjeve të Forcës Madhore**"). Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të përfitojë Kompensimin e Zgjidhjes së Kontratës për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore.

31.5 Nëse si rezultat i një Ngjarjeje të shkaktuar nga një Forcë Madhore:

- a) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë Punimet me qëllim që të ketë mundësi të marrë certifikimet, Certifikatën e Përdorimit dhe miratimet përkatëse në lidhje me përfundimet e Punimeve sipas afateve të parashikuara në Projekt, deri në datën përcaktuar sipas grafikut të ekzekutimit të Punimeve; ose
- b) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tjera të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; atëhere

Koncesionari do të marrë një përfitim në formën e:

- (i) Një shtyrjeje të datës së programuar të përfundimit të pjesës përkatëse të Punimeve, në përputhje me vonesën e pësuar nga Koncesionari sipas Programit të tij;
- (ii) Përjashtimin nga detyrimet e saj për aq sa ato preken nga Ngjarja e Forcës Madhore;
- (iii) Në rastin e një Ngjarjeje të shkaktuar nga Forca Madhore, e cila bëhet shkas për vonesa në lidhje me një pjesë të caktuar të Punimeve, përfundimin e tyre ose lëshimin e Certifikatës së Përdorimit, dhe shkak për kosto ekstra të paparashikuara nga Projekti Përfundimtar, mund të pretendojë një Shkak Kompensimi;
- (iv) Përjashtim nga zgjidhja e Kontratës për faj të Koncesionarit për aq sa mospërmbushja është shkaktuar ose është ndikuar materialisht nga ekzistenca e Ngjarjes së Forcës Madhore.

31.6 Koncesionari mund të pretendojë përfitime të tilla vetëm në rrethana kur e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesa të arsyeshme, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:

- (i)Ditë Kalendarike pasi Koncesionari ka marrë dijani për ndodhjen e një Ngjarjeje të Forcës Madhore; ose
- (ii)Ditë Kalendarike pas ngjarjes së shkaktuar nga Ngjarja e Forcës Madhore

31.7 Nëse si rezultat i një Ngjarjeje të shkaktuar nga një Forcë Madhore Autoriteti Kontraktor nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Kontratë, atëherë Autoriteti Kontraktor mund të marrë një përfitim në formën e:

- a) Përjashtimit nga detyrimet e tij për aq sa ato preken nga Ngjarja e Forcës Madhore;
- b) Përjashtimit nga zgjidhja e Kontratës për faj të Autoritetit Kontraktor për aq sa mospërmbushja është shkaktuar ose është ndikuar materialisht nga ekzistenca e Ngjarjes së Forcës Madhore.

Autoriteti Kontraktor mund të pretendojë përfitime të tilla vetëm në rrethana kur e ka njoftuar Koncesionarin dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesa të tepërta, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:

- (i)Ditë kalendarike pasi Koncesionari ka marrë dijani për ndodhjen e një Ngjarjeje të Forcës Madhore; ose
- (ii)Ditë Pune pas ngjarjes së shkaktuar nga Ngjarja e Forcës Madhore.

NENI 32

VEPRIMI MATERIAL I PAFAVORSHËM QEVERITAR

32.1 Një “**Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar**” nënkupton rastet kur, Autoriteti Kontraktor ose ndonjë Autoritet Përkatës tjetër vendor apo qendror, pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate merr apo dështon të ndërmarrë ndonjë veprim të çdo natyre, ose nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate ose në përputhje me Ligjin (përveç veprimeve apo mosveprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktor për të zbutur efektet e shkeljes nga ana e Shoqërisë Koncesionare), efekti i të cilave ndikon direkt ose indirekt mbi Shoqërinë Koncesionare dhe/ose provokon në mënyrë direkte ose indirekte ndonjë ndryshim të pafavorshëm aktual ose të mundshëm për Shoqërinë Koncesionare në shpenzimet apo të ardhurat (përfshirë por pa u kufizuar në to, Tatimet apo Taksat), apo pozicionin ekonomik dhe financiar të saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to dhe/ose:

- a) mos kryerjen nga ana e Autoritetit Kontraktor apo ndonjë Autoriteti Përkatës tjetër, të ndonjë detyre ligjërishit të detyrueshme për to, ose të ekzekutojë ose të zbatojë ndonjë të drejtë ligjore të Koncesionarit; dhe/ose
- b) veprimet apo mosveprimet e Autoritetit Kontraktor apo ndonjë autoriteti tjetër shtetëror, të cilat, në tërësinë e tyre, tregojnë mungesën e vullnetit të autoritetit për të përmbushur këtë kontratë, apo për të krijuar rrethana që do të çonin në shkeljen e detyrimeve kontraktore nga koncesionari.
- c) një Ndryshim në Ligj i cili, pas zbatimit të dispozitave mbi Ndryshimin e Ligjit në përputhje këtë Kontratë, ende ndikon negativisht në aftësinë e Shoqërisë Koncesionare për të ndërmarrë, kryer dhe përfunduar Punimet apo realizimin e shërbimit për Operimin e Aeroportit, si dhe zbatimin në tërësi të kësaj Kontrate.
Përveç kur një ngjarje mund të parandalohet apo të kapërcehet nga Pala e prekur nëpërmjet ushtrimit të vëmendjes dhe kujdesit të arsyeshëm, siç do të ushtrohet nga një person i matur në rrethana të ngjashme.

32.2 Nëse ndodh ndonjë Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar, Shoqëria Koncesionare do të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktor duke dhënë hollësitë e arsyeshme të këtij veprimi dhe pasojat e tij të mundshme ekonomike për Koncesionarin. Autoriteti Kontraktor do të ketë një afat prej jo më shumë seDitë Pune, nga data e marrjes së këtij njoftimi me shkrim, për të bërë çdo përpjekje të mundshme për të ndrequr situatën, e cila rikthen gjendjen e përgjithshme ekonomike të Koncesionarit në atë, në të cilën do të ishte, nëse ky Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar nuk do të kishte ndodhur. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk do të ndikojë në ndreqjen e tij brenda këtij afati, Pala do të konsultohen brenda ditësh kalendarike pas skadimit të kësaj periudhe me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të përbashkët, të pranueshme për situatën.

32.3 Në rast se një zgjidhje reciprokisht e kënaqshme e situatës nuk është arritur në kuadër të kësaj periudheditore kalendarike nëpërmjet:

- a) një rregullimi apo përshtatje të nevojshme, apo pagesë dhe/ose zgjatje afati, që mund të jetë e drejtë dhe e arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat; dhe/ose
- b) një lehtësimi monetar të drejtë dhe të arsyeshëm sipas rrethanave; dhe/ose
- c) një shtyrje të Periudhës së Koncesionit

atëherë, Koncesionari mundet që (i) të vazhdojë zbatimin e detyrimeve të tij në bazë të Kontratës duke e konsideruar Veprimin Material të Pafavorshëm Qeveritar si Shkak Kompensimi, ose (ii) të ndërpresë Kontratën në përputhje me klauzolën për zgjidhjen e parakohshme të Kontratës për Mospërbushje të Autoritetit Kontraktor, pa asnjë përgjegjësi apo dëm, apo kosto për Koncesionarin, në rast se çdo mjet juridik tjetër i parashikuar në këtë Kontratë nuk do të jetë i mjaftueshëm për të vendosur Koncesionarin në një pozicion ekonomik të njëjtë krahasuar me pozicionin në të cilin ndodhej, përpara ndodhjes së Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar, duke mbajtur parasysh të drejtat dhe detyrimet e vazhdueshme të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, Projektit dhe çdo marrëveshjeje tjetër të parashikuar në këtë Kontratë. Çdo Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar do të konsiderohet si Mospërbushje e Kontratës nga Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari ka të drejtë të marrë të gjitha kompensimet dhe shpërblimet e parashikuara në këtë Kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për zgjidhjen e Kontratës.

KREU 5

NENI 33

NDRYSHIMET NË LIGJ

- 33.1** Nëse ndodh një Ndryshim në Ligj, i cili nuk është Ndryshim Cilësues në Ligj dhe që kërkon nga Shoqëria Koncesionare të ndryshojë ose amendojë Projektin, cilësinë ose vëllimin e Punimeve apo Shërbimeve, Shoqëria Koncesionare paraqet një propozim për ndryshim në përputhje me nenin 33.2.
- 33.2** Nëse një Ndryshim Cilësues në Ligj ndodh, ose pritet të ndodhë së shpejti, secila nga Palët mund të njoftojë Palën tjetër dhe Inxhinierin e Pavarur me shkrim për efektet e mundshme të një ndryshimi të tillë, duke specifikuar:
- 33.2.1 Nëse kërkohet përjashtim nga përbushja e detyrimeve, duke përfshirë detyrimin për të arritur datën e programuar të përfundimit;
 - 33.2.2 Çdo ndryshim të nevojshëm në Punime apo Shërbimet e Operimit që shkaktohet apo rezulton nga një Ndryshim i tillë Cilësues në Ligj;
 - 33.2.3 Nëse kërkohet ndonjë ndryshim në kushtet e kësaj Kontrate ose të Dokumenteve të tjerë të Projektit;
 - 33.2.4 Nëse zbatimi i Ndryshimit Cilësues në Ligj do të rezultojë drejtpërdrejt në rritjen e kostove apo në humbjen e të ardhurave të Koncesionarit;
 - 33.2.5 Çdo Shpenzim Kapital që kërkohet për të zbatuar Ndryshimin Cilësues në Ligj, ose që mund të kursehet;

33.2.6 Çdo Miratim i Nevojshëm që do të kërkohet për të zbatuar një Ndryshim Cilësues në Ligj; dhe

33.2.7 Mënyrën në të cilën Ndryshimi Cilësues në Ligj mund të prekë çmimet e vëna nga furnitorët për Shërbimet, duke përfshirë firmat e operuara nga Aksionerët e Shoqërisë Koncesionare, ose Shoqëritë e tyre të Lidhura.

33.3 Nëse, si rezultat i një Ndryshimi Cilësues në Ligj:

33.3.1 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë Punimet, me qëllim që të jetë në gjendje të sigurojë certifikimet përkatëse në lidhje me përfundimin e punimeve ndertimore deri në datën e programuar për përfundimin e tij;

33.3.2 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjërin nga detyrimet e saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; ose

33.3.3 Shoqërisë Koncesionare i kanë lindur ose do t'i lindin kosto, të cilat ndryshe nuk do t'i kishin lindur, ose nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura, të cilat ndryshe do t'i kishte gjeneruar po të mos kishte ndodhur një Ndryshim i tillë Cilësues në Ligj,

Shoqëria Koncesionare mund të sigurojë një përfitim në formën e:

33.3.4 Shtyrjes së duhur të datës së programuar të përfundimit të Punimeve, e cila do të jetë e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të përfunduar Punimet;

33.3.5 Ndryshimet e nevojshme të Dokumenteve të Projektit për të marrë parasysh dhe reflektuar Ndryshimin Cilësues në Ligj;

33.3.6 Të drejtën e kompensimit; dhe/ose

33.3.7 Mos-aplikimin e dispozitave për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës për faj të Koncesionarit, nëse ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur lidhur me këto pretendime brenda një afati jo më shumë seDitë Pune nga hyrja në fuqi e ndryshimit të Ligjit.

Palët do të takohen për të diskutuar për efektet e sjella nga Ndryshimi Cilësues i Ligjit brenda Ditësh Pune nga aprovimi i tij dhe do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje brendaDitësh Pune nga takimi i tyre.

NENI 34

NDRYSHIME NË PUNIMET APO SHËRBIMET

34.1 Ndryshime të Kërkuara nga Autoriteti Kontraktor

34.1.1 Autoriteti Kontraktor mundet që të kërkojë ndryshime në Projekt Zbatim, në Punime ose në Shërbimet e Operimit (duke përfshirë një ndryshim në shkallën e Shërbimeve) nëpërmjet një kërkesë me shkrim që ia dorëzon Koncesionarit (“**Njoftimi për Ndryshime nga Autoriteti Kontraktor**”), ku përcaktohen detajet e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me këtë Kontratë. Çdo ndryshim i kërkuar dhe i propozuar duhet të rakordohet dhe dakordësohet paraprakisht me Koncesionarin. Palët do të bien dakord lidhur me kostot e ndryshimit, nëse ka, përpara fillimit të punimeve apo Shërbimeve për realizimin e këtyre ndryshimeve.

34.1.2 **Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të bëjë:**

- a) Kërkesë, sipas të cilës Punimet e ndërtimit objekt Koncesioni i kësaj Kontrate, apo Shërbimet e Operimit duhen ofruar në një mënyrë që bie ndesh me Legjislacionin në fuqi, siç është përcaktuar në Projekt Zbatim;
- b) Ndryshime që kërcënojnë, ose do të kërcënonin seriozisht shëndetin apo sigurinë e Personave;
- c) Ndryshime që do të ndryshonin thellësisht natyrën e Projekt Zbatimit, duke përfshirë natyrën e risqeve dhe Standardet;
- d) Ndryshime që nuk bëjnë pjesë në të drejtat e Autoritetit Kontraktor;
- e) Ndryshime që do të kërkonin Truall Shtesë ose Truall Ekstra (dhe një Truall i tillë Shtesë ose Truall Ekstra nuk jepet ose nuk përballohet financiarisht nga Autoriteti Kontraktor); dhe
- f) Ndryshime që do të shkaktonin heqjen, pezullimin ose ndryshimin e çdo miratimi të nevojshëm ekzistues, ose do të kërkonin një pëlqim/leje të re të nevojshme dhe kur nuk ka gjasa të arsyeshme që Shoqëria Koncesionare do të mund t’a merrte miratimin e nevojshëm, brenda afatit kohor të propozuar për zbatimin e ndryshimit të propozuar nga Autoriteti Kontraktor; dhe
- g) Ndryshime që do të përbënin kosto dhe shpenzime që në total kalojnë vlerën eEurove për Shoqërinë Koncesionare, duke vënë kështu në rrezik dhe vështirësi Shoqërinë Koncesionare dhe Projektin, përveç rasteve kur Autoriteti Kontraktor merr përsipër mbulimin e menjëhershëm të shpenzimeve dhe kostove.

34.1.3 **Në Njoftimin për Ndryshime, Autoriteti Kontraktor jep:**

- a) Detaje të mjaftueshme për ndryshimin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, me qëllim që Shoqëria Koncesionare të jetë në gjendje të kryejë një vlerësim të ndryshimit, të çmuar në kostot e Projekt Zbatimit;
- b) Të dhëna mbi kostot e ndryshimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në çdo rast përballimi i kostove për ndryshimin e kërkuar do të bëhet nga Autoriteti Kontraktor;
- c) Afatin kohor brenda të cilit Shoqëria Koncesionare duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor një përgjigje dhe ndryshimin e çmuar në kostot dhe të ardhurat e Projektit, por gjithsesi, një

afat i tillë nuk duhet të jetë më shumë seDitë Pune pas dorëzimit të kërkesës së Autoritetit Kontraktor për ndryshim;

- d) Opinionin e Inxhinierit të Pavarur në lidhje me arsyeshmërinë e propozimit të Autoritetit Kontraktor.

34.1.4 Shoqëria Koncesionare i paraqet një përgjigje sa më shpejt që të jetë e mundur por gjithsesi, jo më vonë se në afatin e paraqitur në Njoftimin për Ndryshim të Autoritetit Kontraktor, i cili nuk mund të jetë më pak sesaDitë Pune.

34.1.5 Me rënie dakord të palëve për ndryshimet e propozuara nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit, vë menjëherë në dispozicion fondin përkatës për kompensim. Koncesionari nuk ka asnjë detyrim të realizojë këto ndryshime, nëse fondi nuk është vënë në dispozicion.

34.2 Ndryshimet e Propozuara nga Koncesionari

34.2.1 Shoqëria Koncesionare mundet që të propozojë ndryshime në Punimet apo Shërbimet, duke i paraqitur një njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktor (“Njoftim për Ndryshime nga Koncesionari”).

34.2.2 Në Njoftimin e propozimit të tij për Ndryshime, Shoqëria Koncesionare bën të ditur:

- a) Natyrën e ndryshimit të propozuar nga Shoqëria Koncesionare me detaje të mjaftueshme, me qëllim që t’i japë mundësi Autoritetit Kontraktor të vlerësojë propozimin në mënyrë të kualifikuar;
- b) Nëse në lidhje me ndryshimin e kërkuar nga Shoqëria Koncesionare është e nevojshme të kërkohet shlyerja e detyrimeve të tij, sipas kësaj Kontrate, dhe nëse një ndryshim i tillë nga Shoqëria Koncesionare ka gjasa të shkaktojë vonesa në datën e programuar të përfundimit të periudhës ndërtimore;
- c) Një shpjegim të shkaqeve për të cilat ndryshimi kërkohet nga Shoqëria Koncesionare;
- d) Një shpjegim të efektit të pritshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare përfshirë dhe kostot shtesë që duhet të përballohen nga Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare;
- e) Nëse është e nevojshme, datën në të cilën Autoriteti Kontraktor është i detyruar të konfirmojë nëse e pranon apo e refuzon propozimin.

34.2.3 Autoriteti Kontraktor e vlerëson me mirëbesim njoftimin e Shoqërisë Koncesionare për ndryshim, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përfshirë, por pa u kufizuar me:

- a) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në realizimin e Punimeve, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit, si dhe riskun e cënimit të ecurisë së punës;
- b) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në marrëdhëniet ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe të tretëve;

- c) Opinionin e Inxhinierit të Pavarur në lidhje me arsyeshmërinë e propozimit të Koncesionarit;
- d) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në gjendjen e Aeroportit pas datës së përfundimit; dhe
- e) Ndikimin e mundshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në risqet dhe kostot e përballuara nga Autoriteti Kontraktor.

34.2.4 Palët e diskutojnë brendaDitësh Pune Njoftimin për Ndryshim të Koncesionarit dhe Autoriteti Kontraktor mund të propozojë ndryshime të tjera dhe të pranojë ose të hedhë poshtë propozimin për ndryshim nga Koncesionari, duke argumentuar shkaqet e refuzimit, me kusht që Autoriteti Kontraktor të mos hedhë poshtë një ndryshim të propozuar nga Koncesionari, kur një ndryshim i tillë kërkohet si rezultat i një Ndryshimi në Ligj ose kur ky ndryshim është i nevojshëm si rrjedhojë e ndonjë Ngjarjeje të Forcës Madhore, Shkaku Kompensimi apo Shkaku Lehtësimit, siç parashikohet në dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate.

34.2.5 Nëse Autoriteti Kontraktor e pranon Njoftimin për Ndryshim nga Koncesionari, Palët bien dakord për ndryshimet e nevojshme në kushtet e kësaj Kontrate dhe në Dokumentet e tjera të Projektit.

KREU 6

NENI 35

ZHDËMTIMI NË RAST PËRGJEGJËSIE DHE SIGURIMI

35.1 Përgjegjësia dhe Premtimi për Zhdëmtim

Përpara fillimit të Punimeve, Shoqëria Koncesionare merr përsipër të kompensojë dëmin, humbjen ose kërkesën për dëmshpërblim të Autoritetit Kontraktor ose të çdo Pale të Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë humbje ose kërkesë të pranuar me vendim Gjykate të formës së prerë, lidhur me plotësimin e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, ose me ndonjë veprim apo mosveprim tjetër të Shoqërisë Koncesionare, përveç në rrethana kur, dhe në masën që kërkesa për dëmshpërblim vjen nga:

- a) Veprimi apo mosveprimi me dashje ose pakujdesia e Autoritetit Kontraktor ose e Palës së Autoritetit Kontraktor ose e një pale të tretë;
- b) Shkelja nga Autoriteti Kontraktor e kësaj Kontrate ose e Ligjit, si dhe shkelja e Autoriteteve Përkatëse;
- c) Një kërkesë e një pale të tretë, që lidhet plotësisht me një periudhë përpara Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate;

- d) Veprimi i Shoqërisë Koncesionare sipas udhëzimeve të Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor dhe kur përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është vënë në dijeni nga Shoqëria Koncesionare nëpërmjet një njoftimi me shkrim, se veprimi në bazë të këtyre udhëzimeve do të shkaktonte një humbje ose kërkesë për dëmshpërblim sipas këtij Neni;
- e) Reabilitimi, operimi ose mirëmbajtja sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate, Ligjit dhe lejeve ekzistuese dhe e certifikuar nga Autoritetet Përkatëse.

35.2 Në veçanti, Shoqëria Koncesionare merr përsipër të kompensojë çdo dëm, humbje, ose kërkesë për dëmshpërblim të Autoritetit Kontraktor ose ndonjë Pale të Autoritetit Kontraktor, si rezultat i:

- a) Një të drejtë për kompensim që rrjedh nga vdekja ose lëndimi personal i një Pale të Autoritetit Kontraktor, ose i një pale të tretë gjatë Punimeve, kur përgjegjësia e Shoqërisë Koncesionare është konstatuar me vendim Gjykatë të formës së prerë;
- b) Një e drejtë për kompensim që rrjedh nga një dëm, shkaktuar një prone të një Pale të Autoritetit Kontraktor, një Përdoruesi, apo një pale të tretë, kur përgjegjësia e Shoqërisë Koncesionare është konstatuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, përveç në rrethana kur kërkesa ka ardhur si rezultat i një veprimi a mosveprimi apo pakujdesie të Autoritetit Kontraktor apo të një Pale të Autoritetit Kontraktor.

35.3 Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenet e kësaj Kontrate, do të dëmshpërblejë plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe do të mbajë të padëmtuar Shoqërinë Koncesionare ndaj çdo pretendimi të ndonjë pale të tretë në bazë të ngjarjeve apo mosveprimeve apo ndonjë rrethane tjetër të lidhur me Aeroportin, me origjinë para Datës së Fillimit të Zbatimit të Kontratës, përveçse në rastet kur, kërkesat e tilla janë të shkaktuara nga veprime ose mosveprimet neglizhente të Shoqërisë Koncesionare ose ndonjë prej punonjësve të tij, agjentët dhe kontraktorët ose shkelje nga ana e Koncesionarit e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate. Detyrimi i Autoritetit Kontraktor për të dëmshpërblyer Shoqërinë Koncesionare siç parashikohet në këtë nen do të reduktohet në mënyrë proporcionale me masën që veprimet ose mosveprimet neglizhente të Shoqërisë Koncesionare ose ndonjë prej punonjësve të saj, agjentët dhe kontraktorët kanë kontribuar për këtë dëmtim, humbje, dëm, kosto dhe shpenzim.

NENI 36

SIGURIMI I NEVOJSHËM

36.1 Sigurimet e nevojshme

36.1.1 Shoqëria Koncesionare blen dhe mban sigurimet e nevojshme në bazë të Shtojcës 8 me kushtet e përcaktuara në këtë Shtojcë dhe nenin 36 (“**Sigurimet e Nevojshme**”). Shoqëria Koncesionare ia dërgon kushtet e propozuara të Sigurimeve të Nevojshme Autoritetit

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

Kontraktor për t'i parë dhe për të dhënë pëlqim të paktënDitë Pune përpara blerjes së një Sigurimi të tillë të Nevojshëm. Autoriteti Kontraktor, në çdo kohë brendaDitësh Pune, ka të drejtë të kërkojë amendamente në kushtet e propozuara të Sigurimeve të Nevojshme (duke vepruar me arsye), nëse këto nuk pasqyrojnë kërkesat e Shtojcës 8 ose të këtij neni.

36.1.2 Shoqëria Koncesionare blen dhe mban, si dhe siguron që Nënkontraktorët të blejnë dhe mbajnë, të gjitha Sigurimet e Nevojshme me Ligj.

36.1.3 Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse të përballojë me shpenzimet e veta pagesën e të gjitha Kostove Faktike të Sigurimeve, të primeve në lidhje me Sigurimet e Nevojshme dhe sigurimet e kërkuara me Ligj, si dhe përballon rreziqet që lidhen me shumatat e zbritshme dhe/ose tepricat ose pamjaftueshmërinë e shumës së siguruar. Fakti që Shoqëria Koncesionare është ose jo e detyruar të blejë sigurimin e risqeve të caktuara sipas kësaj Kontrate, nuk e cënon Palën që përballon pasojat financiare të një risku të tillë.

36.2 Kushtet dhe Afatet e Sigurimeve të Detyrueshme dhe të Nevojshme

36.2.1 Sigurimet e Detyrueshme dhe të Nevojshme:

- a) Do të bëhen me kompani sigurimi;
- b) Do të mbajë të pacënuar kërkesat për dëmshpërblim të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor;
- c) Parashikojnëditë kalendarike përpara njoftimit me shkrim për anulimin, mos-rinovimin apo ndryshimin që i duhet dërguar Autoritetit Kontraktor; dhe

36.2.2 Shoqëria Koncesionare bën kërkesë për dëmshpërblim nga Sigurimet që Koncesionari ka në shkallë të disponueshme, për të ulur vlerën e çdo kërkesë të Shoqërisë Koncesionare ndaj Autoritetit Kontraktor, në bazë të kësaj Kontrate. Vlera e një kërkesë të Shoqërisë Koncesionare për dëmshpërblim nga Autoritetit Kontraktor, në bazë të kësaj Kontrate, duke përfshirë edhe në lidhje me një Shkak Kompensimi, Shkak Lehtësimi dhe me një Ngjarje të Forcës Madhore, do të ulet me shumën e përfutur efektivisht nga Shoqëria Koncesionare në bazë të Sigurimeve të Nevojshme dhe/çdo sigurimi tjetër që ajo ka.

36.2.3 Secila nga Palët do të shmangë kryerjen e veprimeve, ose do të kryejë të gjitha veprimet e arsyeshme, me qëllim mënjanimin e situatave që do të rezultojnë në refuzimin nga ana e një siguruesi të Sigurimit të Detyrueshëm dhe të Nevojshëm për të paguar një kërkesë për dëmshpërblim në bazë të çdo Sigurimi të Nevojshëm ku ajo palë është e siguruar, ose e bashkësiguruar, ose një Person shtesë i siguruar.

36.3 Dokumentacioni

Shoqëria Koncesionare i jep Autoritetit Kontraktor:

- 36.3.1 Me kërkesë, kopje të të gjitha policave të sigurimit që lidhen me Sigurimet e Detyrueshme dhe të Nevojshme (bashkë me çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me këto polica sigurimi) dhe Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i inspektojë ato gjatë orëve të zakonshme të punës.
- 36.3.2 Dëshmi se primet e pagueshme sipas të gjitha policave të sigurimit, të lidhura me Sigurimet e Nevojshme, janë paguar dhe sigurimet e nevojshme janë në fuqi të plotë, në përputhje me këtë Nen dhe Shtojcën 8; dhe
- 36.3.3 Sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi në apo përpara datës së rinovimit, kopje të dokumentit provizor të sigurimit në lidhje me Sigurimet e Detyrueshme dhe të Nevojshme, nëse është e zbatueshme.

36.4 Mosblerja dhe Mosmbajtja e Sigurimeve të Detyrueshme dhe të Nevojshme

- 36.4.1 Nëse Shoqëria Koncesionare është në shkelje të Nenit 36.1, Autoriteti Kontraktor i kërkon Shoqërisë Koncesionare të paraqesë menjëherë pranë tij Sigurimet e Detyrueshme dhe të Nevojshme me vlefshmëri të plotë. Nëse Koncesionari është në shkelje të këtij Neni, Autoriteti Kontraktues mund të paguajë çdo prim të kërkuar për të mbajtur në fuqi sigurimet e përcaktuara në Nenin 36.1, ose mund të blejë vetë një sigurim të tillë të nevojshëm dhe në secilin rast, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i rikuperojë këto shuma nga Koncesionari me anë të një kërkesë me shkrim.
- 36.4.2 Asnjë parashikim i këtij neni nuk e detyron Shoqërinë Koncesionare të blejë një sigurim në lidhje me një Risk të Pasigurueshëm, përveçse kur shkakun që një risk është bërë i pasigurueshëm, është një veprim ose mosveprim me faj i Koncesionarit, ose i një Pale të Koncesionarit.

36.5 Risku i Pasigurueshëm

Në rast Risku të Pasigurueshëm, ai do të jetë subjekt negociimi me marrëveshje midis Palëve.

36.6 Ndertimi dhe Pagesa e të Hyrave

Të gjitha të ardhurat e marra nga sigurimi sipas çdo police të dëmit fizik do të përdoren për ndertimin e aeroportit në lidhje me të cilat janë marrë të ardhurat ose për kompensimin e tyre.

36.7 Plani i ndertimit

Nëse bëhet një kërkesë për dëmshpërblim sipas një Police të dëmtimit fizik:

- 36.7.1 Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktor sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por në çdo rast brendaDitësh kalendarike pas bërjes së kërkesës, një plan (“**Plani i Ndertimit**”) të përgatitur nga Koncesionari për kryerjen e Punimeve të nevojshme (“**Punimet e ndertimit**”), të cilat janë subjekt i kërkesës apo kërkesave përkatëse në

përputhje me Nenin 36.7.2;

36.7.2 Plani i Ndertimit përcakton:

- a) identitetin e Nënkontraktorëve të Ndertimit ose Nënkontraktorëve të Mirëmbajtjes dhe operimit; dhe
- b) Kushtet dhe afatet e propozuara, në të cilat Punimet e Ndertimit duhet të realizohen;

36.7.3 Autoriteti Kontraktor brendaDitësh Kalendarike nga marrja e Planit të propozuar të Ndertimit, njofton Koncesionarin nëse Autoriteti Kontraktor e pranon apo jo identitetin e Nënkontraktorit, të përcaktuar për të realizuar Punimet rehabilituese në Planin e propozuar të Ndertimit; dhe

- a) duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, kërkon informacion shtesë; ose
- b) Pranon apo hedh poshtë, në varësi të përfshirjes së komenteve të Autoritetit Kontraktor (të cilët mund të ofrojnë një propozim për ndryshimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor), kushtet dhe afatet e Planit të propozuar të Ndertimit;
Për të vendosur nëse duhet të shprehë pëlqimin e vet për çështjet në bazë të Nenit 36.7.3 Autoriteti Kontraktor vepron në mënyrë të arsyeshme.

36.7.4 Nëse Autoritetit Kontraktor nuk e jep pëlqimin e tij, apo bën komente për ndonjë pjesë të Planit të propozuar të Ndertimit, atëherë në njoftimin që ai paraqet në bazë të Nenit 36.7.3, parashtron arsyet apo komentet e tij me hollësi të mjaftueshme, me qëllim që t'i japë mundësi Koncesionarit të kuptojë natyrën dhe shkallën e komenteve dhe të vlerësojë nëse pëlqimi i Autoritetit Kontraktor është refuzuar pa pasur ndonjë arsye. Koncesionari e ndryshon dhe ia riparaqet Planin e Ndertimit Autoritetit Kontraktor për shqyrtim në bazë të Nenit 36.7.3 dhe nëse plani prapë nuk miratohet, secila nga Palët mund t'ia referojë çështjen Inxhinierit të Pavarur për vendim përfundimtar; dhe

36.7.5 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk e paraqet njoftimin e tij në bazë të Nenit 36.7.3 brendaDitësh Kalendarike nga marrja e Planit të propozuar të ndertimit, ose kur Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar në mënyrë të arsyeshme ndonjë informacion tjetër nga Koncesionari brendaDitësh Kalendarike nga marrja e Planit të propozuar të Ndertimit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor e ka refuzuar Planin e propozuar të Ndertimit. Kur Plani i propozuar i ndertimit konsiderohet i refuzuar nga Inxhinieri i Pavarur, Palët takohen për të diskutuar Planin e propozuar të ndertimit maksimumi, brendaDitësh Kalendarike nga kërkesa e Koncesionarit për një gjë të tillë dhe nga marrja nga Autoriteti Kontraktor e informacionit të mëtejshëm, nëse është rasti. Dispozitat e Nenit 36.7, zbatohen për pëlqimin apo refuzimin nga Autoriteti Kontraktor të Planit të propozuar të ndertimit në një takim të tillë dhe, nëse përsëri ky Autoritet nuk e jep pëlqimin e tij, secila nga Palët mund t'ia referojë çështjen Inxhinierit të Pavarur për vendim përfundimtar.

KREU 7

DISPOZITA PËR PËRFUNDIMIN DHE ZGJIDHJEN E PARAKOHSHME TË KONTRATËS

NENI 37

KTHIMI I PRONËS DHE PËRFUNDIMI I KONTRATËS

37.1 Shoqëria Koncesionare ia kthen objektin Autoritetit Kontraktor në Datën e Përfundimit të kësaj Kontrate, në gjendje të mirë dhe funksionale, të mirëmbajtur brenda Standardeve të përcaktuara në Projekt, dhe pa ndonjë barrë. Shoqëria Koncesionare pas dorëzimit nuk mban më përgjegjësi për operimin, mirëmbajtjen dhe riparimet e dëmtimeve të mëpasshme të aeroportit.

37.2 Jo më vonë sevjet përpara Datës së Përfundimit të Vlefshmërisë së Kontratës, Shoqëria Koncesionare:

37.2.1 Kryen vrojtimin fillestar për kthimin, me qëllim që të vlerësojë gjendjen e objektet dhe të ndërmarrë masat e nevojshme, për të kryer planin në lidhje me nevojën e Investimeve Kapitale, nëse ka, si dhe çdo Punim që do të dakordësohet ndërmjet Palëve.

37.2.2 Jo më vonë seMuaj përpara kthimit, në bashkërendim me Inxhinierin e Pavarur, përgatit një plan paraprak të vlerësimit të kthimit, i cili do të përdoret për të përcaktuar ecurinë e operimit dhe mirëmbajtjes së aeroportit për pjesën e mbetur të afatit.

37.2.3 Vrojtimi paraprak i kthimit, identifikon çdo Punim rregullues që mund të nevojitet, me qëllim që objekti të ruajë Standartet e kërkuara si dhe kërkesat e dorëzimit në Datën e Përfundimit të Kontratës si dhe kostot e vlerësuara të kryerjes së këtyre Punimeve.

37.3 Palët do të negociojnë lidhur me hapat dhe procedurat që do të ndiqen në kohën e transferimit të asetit tek Autoriteti Kontraktor.

NENI 38

ZGJIDHJA E PARAKOHSHME E KONTRATËS DHE KOMPENSIMI

38.1 Zgjidhja e Parakohshme

- 38.1.1 Përveç përfundimit të afatit të kësaj Kontrate në Datën e Përfundimit të saj, Palët mund ta zgjidhin këtë Kontratë në përputhje me dispozitat e këtij Neni.
- 38.1.2 Palët bien dakord se Kontrata mund të zgjidhet ose nga ajo mund të hiqet dorë, për shkaqet e shprehura shprehimisht në dispozitat e këtij Neni si dhe në kushtet e parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm për koncesionet.
- 38.1.3 Përfundimi i parakohshëm i kësaj Kontrate bëhet pa cënuar të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në rastet kur ato janë të parashikuara shprehimisht në këtë Kontratë, ose ato që zbatohen pas Datës së Përfundimit të Kontratës për shkak të natyrës së tyre.

38.2 Mospërmbushja nga koncesionari

- 38.2.1 Në varësi të nenit 38, 38.2.1 dhe 38.3, në rrethanat kur ka ndodhur një mospërmbushje nga Shoqëria Koncesionare, i dërgon njoftim Shoqërisë Koncesionare për të korrigjuar mospërmbushjen e saj (“**Njoftimi për Korrigjim**”), i cili përmban një përshkrim të mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare dhe një periudhë për korrigjimin e tyre, e cila do të jetë jo më pak seDitë Kalendarike pas dorëzimit të Njoftimit për Korrigjim te Shoqëria Koncesionare. Autoriteti Kontraktor, pas njoftimeve dhe mospërmbushjes nga koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë menjëherë pas një njoftimi me shkrim që i bën Shoqërisë Koncesionare (“**Njoftimi për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Koncesionari**”).
- 38.2.2 Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Shoqëria Koncesionare, të identifikuar në paragrafët (a),(d),(e),(g),(h),(i) të përkufizimit të kësaj Mospërmbushjeje ne nenin 1 përpara se Njoftimi për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare t’i dërgohet Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor i dërgon njoftim Shoqërisë Koncesionare për të korrigjuar mospërmbushjen e saj (“**Njoftimi për Korrigjim**”), i cili përmban një përshkrim të mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare dhe një periudhë për korrigjimin e tyre, e cila do të jetë jo më pak seDitë Pune pas dorëzimit të Njoftimit për Korrigjim te Shoqëria Koncesionare.
- 38.2.3 Autoriteti Kontraktor mund të mos i dërgojë Shoqërisë Koncesionare Njoftim për Mospërmbushje nëse:
- a) Shoqëria Koncesionare e korrigjon mospërmbushjen deri në datën e parashikuar në Njoftimin për Korrigjim; ose
 - b) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Shoqëria Koncesionare, të përcaktuar në gërmat a, b(ii), (iii), (iv), (v),(vi) të përkufizimit të kësaj Mospërmbushjeje në nenin 1, Shoqëria Koncesionare i dorëzon Autoritetit Kontraktor brenda periudhës së korrigjimit të parashikuar në Njoftimin për Korrigjim, një plan të pranueshëm nga Autoriteti Kontraktor për korrigjimin e Mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare dhe Shoqëria Koncesionare, pa asnjë vonesë të mëtejshme, nis zbatimin e planit në përputhje me

kushtet e tij.

38.2.4 Nëse në ndonjë kohë, Shoqëria Koncesionare nuk e përmbush planin korrigjues të pranuar nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Nenin 38.2.3, Autoriteti Kontraktor mund t'i dërgojë Shoqërisë Koncesionare një Njoftim të dytë për Korrigjim, ku i kërkohet përmbushja e planit brenda një afati të arsyeshëm dhe në rast të mos përmbushjes së planit brenda këtij afati, atëherë Autoriteti Kontraktor i dërgon Shoqërisë Koncesionare, Njoftimin për Mospërmbushje të Detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare dhe kjo Kontratë merr fund në datën e dorëzimit të Njoftimit për Mospërmbushje të Koncesionari. Në këtë rast, Autoritetit Kontraktor i lind e drejta të kërkojë ekzekutimin e Garancisë së Kontratës.

38.3 Shkeljet e vazhdueshme

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë, të zgjidhë këtë Kontratë për shkak të shkeljeve të vazhdueshme, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme ("**Shkelje të Vazhdueshme**"):

38.3.1 Nëse Shoqëria Koncesionare e ka shkelur të njëjtin detyrim sipas kësaj Kontrate në të paktën 2 (dy) raste në çdoMuaj të njëpasnjëshëm, Autoriteti Kontraktor do ta njoftojë Shoqërinë Koncesionare me shkrim ("**Paralajmërimi i Parë**"), duke vënë në dukje:

- a) Detyrimin e shkelur; dhe
- b) Shumën e penalteteve për t'u paguar sipas Shtojcës 10;
- c) Duke e njoftuar se ky është Paralajmërimi i Parë në bazë të kësaj Kontrate; dhe
- d) Duke deklaruar se kjo është një shkelje e kësaj Kontrate e cila, nëse do të përsëritej, mund të rezultonte në përfundimin e parakohshëm të Kontratës;

38.3.2 Nëse, pas marrjes së Njoftimit të Parë, shkelja e konstatuar vazhdon për një periudhë që i tejkalonDitë Pune, ose përsëritet në të paktën raste në një periudhë prejmuajsh në vijimësi, Autoriteti Kontraktor mund të njoftojë Shoqërinë Koncesionare me shkrim ("**Paralajmërimi i Dytë**"), duke përcaktuar:

- a) detyrimin që është shkelur;
- b) duke e njoftuar se ky është Paralajmërimi i Dytë në bazë të kësaj Kontratë; dhe
- c) duke deklaruar se kjo është një shkelje e kësaj Kontrate e cila, nëse përsëritet, do të çojë në përfundimin e parakohshëm të saj si dhe në ekzekutimin e Garancisë së Kontratës;

38.3.3 Nëse, pas marrjes së Paralajmërimin të Dytë, shkelja e përcaktuar vazhdon për një

periudhë që i tejkalonDitë Pune, ose përsëritet në njërin ngaMuajt vijues, Autoriteti Kontraktor do të njoftojë Koncesionarin se ka ndodhur një Shkelje e Vazhdueshme dhe në atë rast, zbatohen dispozitat për Mospërmbushjen e Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare, në përputhje me Nenin 38.2.

38.4 Mospërmbushja e detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor

38.4.1 Në rrethana kur ka ndodhur një Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë, me dërgimin e një njoftimi paraparak për mospërmbushjet nga Autoriteti Kontraktor, (“**Njoftimi për Mospërmbushje nga ana e Autoritetit Kontraktor**”).

38.4.2 Në rastin e një Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, përpara se të dërgohet Njoftimi për Mospërmbushje nga ana e Shoqërisë Koncesionare duhet t’i dërgohet Autoritetit Kontraktor një njoftim për të korrigjuar mospërmbushjen e tij (“Njoftimi për Korrigjim”), i cili përmban një përshkrim të mospërmbushjeve nga Autoriteti Kontraktor dhe një periudhë për korrigjimin e tyre, e cila do të jetë jo më pak seDitë Kalendarike pas dorëzimit të Njoftimit për Korrigjim te Autoriteti Kontraktor.

38.4.3 Shoqëria Koncesionare mund të mos i dërgojë Autoritetit Kontraktor Njoftimin për Mospërmbushje, nëse:

- a) Autoriteti Kontraktor e korrigjon mospërmbushjen deri në datën e parashikuar në Njoftimin për Korrigjim; ose
- b) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit i dorëzon Shoqërisë Koncesionare, brenda periudhës së korrigjimit të parashikuar në Njoftimin për Korrigjim, një propozim të pranueshëm nga Shoqëria Koncesionare, për korrigjimin e Mospërmbushjeve nga Autoriteti Kontraktor dhe Autoriteti Kontraktor pa asnjë vonesë të mëtejshme nis zbatimin e planit në përputhje me kushtet e tij.

38.4.4 Data e Përfundimit të Kontratës:

- a) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor të përcaktuar në gjermën (c) të nenit 1, të përkufizimit të tij, (Mospërmbushja e Autoritetit Kontraktor) është data e dorëzimit të njoftimit për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor; ose
- b) Në rastin e të gjitha Mospërmbushjeve të tjera nga ana e Autoritetit Kontraktor, është një datë jo më vonë seDitë Pune pas dorëzimit tek Autoriteti Kontraktor të Njoftimit të Mospërmbushjeve nga ana e Autoritetit Kontraktor.

38.4.5 Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, të përcaktuar në gjermën (a) të nenit 1, të përkufizimit të tij, (Mospërmbushja e Autoritetit Kontraktor), Autoriteti Kontraktor mund t’i parandalojë pasojat e tërheqjes dhe kjo Kontratë nuk përfundon në datën e përcaktuar në Njoftimin për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, në rrethanat kur Autoriteti Kontraktor e korrigjon Mospërmbushjen nga ana e Autoritetit

Kontraktor brendaDitësh Kalendarike nga marrja e Njoftimit nga Koncesionari për Mospërbushje.

NENI 39

VAZHDIMI I DETYRIMEVE DERI NË PËRFUNDIM

Palët do të vazhdojnë të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Kontrate, pavarësisht nga ndonjë njoftim për përfundim për mospërbushje, derisa përfundimi i kësaj Kontrate të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 38 dhe 40.

NENI 40

TRANSFERIMI I AKTIVEVE DHE TË DREJTAVE PAS PËRFUNDIMIT TË KONTRATËS

Në Datën e Përfundimit të Kontratës:

- 40.1** Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria Koncesionare ka në lidhje me Projektin përfundojnë dhe Autoriteti Kontraktor merr përsipër dhe përfton të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Koncesionare ndaj aeroportit. Në rastet kur Autoriteti Kontraktor i mban këto të drejta në bazë të dispozitave të tjera të Kontratës, për kryerjen e transferimit të të drejtave, Autoriteti Kontraktor i siguron Shoqërisë Koncesionare hyrje-dalje dhe përdorim të arsyeshëm të objektit që i nevojitet për largimin e personelit, stafit, pajisjeve dhe makinerive;
- 40.2** Nëse njoftimi për përfundim bëhet përpara dhënies së Certifikatave të Përdorimit, Palët do të bien dakord lidhur me dorëzimet e objektit të ndërtuar tek Autoritetit Kontraktor, i cili merr ato në dorëzim (duke përfshirë edhe Punimet e përkohshme), si dhe mund të diskutojnë lidhur me mundësinë e marrjes së pajisjeve dhe mjeteve të Shoqërisë Koncesionare nga ana e Autoritetit kontraktor me qëllim përfundimin e Punimeve, pasi Koncesionari të kompensohet për kostot e tyre me vlerën kontabël;
- 40.3** Të drejtat e Koncesionit të dhëna Koncesionarit në bazë të kësaj Kontrate (përveç të drejtave të shprehura se do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të kësaj Kontrate), duke përfshirë detyrimin e Shoqërisë Koncesionare për të operuar aeroportin do të përfundojnë automatikisht;
- 40.4** Shoqëria Koncesionare i dorëzon Autoritetit Kontraktor, Manualet e Operimit dhe të Mirëmbajtjes, së bashku me të gjitha dokumentet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me Projekt Zbatimin dhe të dhënat e përditësuara gjatë ndërtimit, në shkallën që ato janë finalizuar në kohën e përfundimit, ose përndryshe skicat siç janë në gjendjen aktuale;

40.5 Shoqëria Koncesionare bashkëpunon dhe e ndihmon Autoritetin Kontraktor për të siguruar transferimin e operimit dhe mirëmbajtjes së aeroportit te një palë e tretë kontraktore, e caktuar nga Autoriteti Kontraktor për të shfrytëzuar dhe operuar objektin pas Datës së Përfundimit të Kontratës.

NENI 41

SHUMAT E KOMPENSIMIT

41.1 Kompensimi për Zgjidhjen e Kontratës

41.1.1 Nëse kjo Kontratë përfundon përpara kohe, pas dërgimit të njoftimit për përfundim të parakohshëm në përputhje me nenin 38, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të marrë shumën e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës në përputhje me këtë nen.

41.1.2 Çdo shumë e zgjidhjes së Kontratës, e pagueshme sipas këtij Neni, është një pagesë që bëhet për shkak të një detyrimi që rrjedh sipas kësaj Kontrate. Palët e konsiderojnë të drejtën për të marrë shumën e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës si të vetmen kërkesë të Koncesionarit ndaj Autoritetit Kontraktor në lidhje me përfundimin e parakohshëm të kësaj Kontrate, Marrëveshjet e Financimit dhe Dokumentet e Projektit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë.

41.1.3 Palët pranojnë se e drejta për përfundimin e parakohshëm dhe pagesën e shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, ose, sipas rastit, e drejta për zbritjen e pagesave, është një zgjidhje e mjaftueshme për kërkesat e dyanshme në lidhje me përfundimin e parakohshëm të kësaj Kontrate, çdo Marrëveshjeje të Financimit dhe të Dokumenteve të Projektit, dhe për çdo shkak që rezulton në përfundimin paraprak të Kontratës, përveç sa parashikohet ndryshe shprehimisht në këtë Kontratë.

41.2 Kompensimi për Zgjidhje të Kontratës për Mospërmbushje të Koncesionarit

41.2.1. Në rrethana kur kjo Kontratë zgjidhet për Mospërmbushje, vetëm në përputhje me Nenin 28.2. Autoriteti Kontraktor i paguan Shoqërisë Koncesionare një shumë për ndërprerjen e Kontratës, të llogaritur në përputhje me këtë kontrate.

41.2.2. Kur zbatohet Neni 41, Autoriteti Kontraktor i paguan Shoqërisë Koncesionare, një shumë të barabartë me shumën midis:

- a) Detyrimeve Kundrejt Huadhënësve, dhe
- b) Vlerës së Tregut të Projektit të përcaktuar sipas përkufizimit të dhënë në nenin 1.

- 41.2.3. Të gjitha shumat e parashikuara për përcaktimin e shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës duhet të llogariten në terma nominale me çmimet aktuale. Shuma e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës do të rregullohet në momentin e pagesës për të marrë parasysh inflacionin e pritur plus një shtesë prej **1 (një) %**, për periudhën ndërmjet datës së llogaritjes dhe datës së pagesës, siç është përcaktuar në këtë Kontratë.
- 41.2.4. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me shumat e llogaritura apo të përcaktuara, në përputhje me këtë nen, vendoset në bazë nenit 53, mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Për të shmangur çdo dyshim, në përlllogaritjen lidhje me Kompesimin per Zgjidhje të Kontratës për Mospërbushje të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përdorë së pari vlerën e Garancisë së Kontratës, me qëllim përmbushjen e dispozitave të këtij Neni.

41.3 Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak Mospërbushjeje nga ana e Autoritetit Kontraktor

Nëse kjo Kontratë përfundon para kohe, për Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit i paguan Koncesionarit shumën e llogaritur sipas përkufizimit “Kompesimi i Zgjidhjes së Kontratës për shkak të Mospërbushjes nga Autoriteti Kontraktor” në nenin 1, pa përjashtuar ndonjë kompensim ose dëm të shkaktuar kundrejt Koncesionarit, i cili i takon sipas zbatimit të dispozitave të Ligjeve në fuqi.

NENI 42

LLOGARITJA DHE PAGESA E KOMPENSIMIT

42.1 Balancimi i Tatimeve

42.1.1 Në rast se, për shkak të aplikimit dhe pagesës së një Tatimi apo Takse (përveç Tatimeve apo Taksave të pagueshme nga Shoqëria Koncesionare gjatë ecurisë së zakonshme të punës, që nuk lidhen me këtë Kontratë), mbi shumat e kompensimeve për zgjidhjen e Kontratës në rast të mospërbushjes nga Autoriteti Kontraktor, Koncesionari merr një shumë të Kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës, nga e cila është zbritur tatimi i aplikuar, atëherë Autoriteti Kontraktor i paguan Koncesionarit edhe një shumë shtesë, të barabartë me vlerën e Tatimit të aplikuar mbi shumën e kompensimit, me qëllim që ta vëjë Koncesionarin në të njëjtën situatë në të cilën ai do të kishte qenë, nëse nuk do t'i ishte aplikuar një Tatim apo Taksë e tillë dhe për aq kohë sa ky Tatim ose Taksë nuk ishte llogaritur dhe përfshirë më parë, në shumën përkatëse të Kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës. Në kuptim të sa më sipër, koncesionari do të marrë vlerën e dëmit që i është shkaktuar duke përfshirë cdo tatim/takse/tarife kur koncesionari i ka paguar ato.

42.1.2 Përveçse kur është rënë dakord shprehimisht në këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktor nuk përdor asnjë shumë (që i takon Shoqërisë Koncesionare për Kompensim për Zgjidhjen e Kontratës,) të pagueshme në përputhje me Nenin 42.3 (por jo të një shume për zgjidhje Kontrate të pagueshme në bazë të Nenit 42.2), nëse si rezultat i një kompensimi/mbajtje të tillë, shuma që i është paguar faktikisht Koncesionarit në lidhje me zgjidhjen e Kontratës do të jetë më e vogël sesa Detyrimet e papaguara të Koncesionarit Kundrejt Huadhënësve. Në respektim të sa më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të kompensojë çdo shumë që i detyrohet atij nga Koncesionari me shumën për zgjidhjen e Kontratës, vetëm nëse është rënë dakord për një gjë të tillë shprehimisht në këtë Kontratë dhe nëse kjo lejohet sipas Ligjeve.

42.2 Metoda e Pagesës

42.2.1 Nëse Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare brendaDitësh Pune nuk bien dakord që Autoriteti Kontraktor të paguajë një shumë për zgjidhjen e Kontratës me këste në marrëveshje me Koncesionarin, ai është i detyruar të paguajë shumën e zgjidhjes së Kontratës në një llogari të përcaktuar nga Shoqëria Koncesionare, duke filluar nga:

- a) Data e zgjidhjes së Kontratës; dhe
- b) Data në të cilën çdo mosmarrëveshje në lidhje me një shumë të tillë për zgjidhje Kontrate, është përcaktuar përfundimisht.

42.2.2 Në rrethanat e parashikuara në Nenin 41.2, 41.3, Autoriteti Kontraktor mund të zgjedhë të paguajë me këste çdo Detyrim Kundrejt Huadhënësve, që bën pjesë në shumën e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, dhe Autoriteti Kontraktor përcakton shumën dhe datat e pagesave të kësteve, me kusht që:

- a) Shuma dhe data e secilit këst të bëjnë të mundur të paktën pagesën e Huadhënësve në përputhje me Marrëveshjet e Financimit, në rast se nuk do të kish ndodhur përfundimi i parakohshëm;

42.2.3 E gjithë shuma e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, duke përfshirë interesin, paguhet jo më vonë se duke filluar nga data e fundit për pagesë të shumave të kërkueshme sipas Marrëveshjeve të Financimit;

- a) Pjesët e shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, data e pagimit të të cilave është shtyrë (nuk është paguar në kohë), do të prodhojnë interes të barabartë me Marrëveshjet e Financimit, duke filluar nga Data e Përfundimit të Kontratës, ndërsa Autoriteti Kontraktor mundet që në çdo kohë ta parapaguajë të gjithë përqindjen e mbetur të shumës së

Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, me kusht që ta bëjë këtë në datën e duhur të pagimit të kështit dhe ta njoftojë Koncesionarin jo më vonë seDitë Pune më përpara; dhe

- b) E gjithë shuma për Kompensimin e Zgjidhjes së Kontratës të paguhet sa më shpejt që të jetë e mundur, duke marrë parasysh fondet e disponueshme të Autoritetit Kontraktor dhe të gjitha mundësitë e pritshme në mënyrë të arsyeshme të Autoritetit Kontraktor për të përfituar fonde për pagesën e të gjithë shumës së plotë të Kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës sa më shpejt që të jetë e mundur dhe pa përbërë kjo nje shkak për tejzgjatje të pajustificueshme dhe një cënim të rëndë të së drejtës Ligjore të Koncesionarit, për të marrë shumën që i takon.

42.2.4 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk arrin të paguajë ndonjë nga këstet e përcaktuara sipas nenit 42, Koncesionari mund të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumës së mbetur pa paguar nga shuma e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, duke përfshirë interesin e lindur, duke dërguar një njoftim me shkrim brendaDitësh Pune nga data e marrjes dijeni.

42.2.5 Në lidhje me të gjitha pagesat që Autoriteti Kontraktor do duhet të bëjë në bazë të kësaj Kontrate, në rastin kur monedha Euro nuk ekziston më, atëherë llogaritë do të bëhen në monedhën e dollarit Amerikan, me një kurs këmbimi ekuivalent me kursin e këmbimit në Datën e Hyrjes në Fuqi.

42.3 Informacioni i Kërkuar për Përcaktimin e Shumës së Kompensimit

Në përcaktimin e shumës për Zgjidhjen e Kontratës, Autoriteti Kontraktor mund të mbështetet në çdo dokument të dhënë nga Huadhënësit, për përcaktimin e Detyrimeve Kundrejt Huadhënësve. Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të paguajë një shumë në lidhje me Detyrimet Kundrejt Huadhënësve, e cila e tejkalon shumën e përcaktuar në një dokument të dhënë nga Huadhënësit, ku përcaktohen Detyrimet Kundrejt Huadhënësve.

NENI 43

NDËRHRYJA E AUTORITETIT KONTRAKTOR

43.1 Nëse Autoriteti Kontraktor ka të dhëna të arsyeshme se ka:

- a) një rrezik serioz për jetën apo shëndetin dhe sigurinë e Personave apo sigurinë së aeroportit;
- b) një rrezik serioz ndaj pronës apo mjedisit; ose
- c) një shkelje të detyrës së parashikuar me Ligj;

në lidhje me Punimet, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit ose ofrimin e Shërbimeve, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrë të arsyeshme në Punimet, operimin ose ofrimin e Shërbimeve për të larguar një rrezik të tillë.

43.2 Palët do të bien dakord brendaMuajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate për procedurën që do të ndiqet në rastin që Autoriteti Kontraktor dëshiron të ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij Neni, sipas propozimit të bërë nga Shoqëria Koncesionare. Koncesionarit i lind e drejta të kompensohet për dëmin dhe humbjen që mund t'i vijnë nga ndërhyrjet e Autoritetit Kontraktor.

KREU10

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 44

KONFIDENCIALITETI

44.1 Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me dispozita të tilla të Kontratës, Shtojcave të kësaj Kontrate dhe Dokumenteve të Projektit, si dhe çdo të dhënë të krijuar dhe mbajtur në përputhje me këtë Kontratë, që përcaktohen në bazë të ligjit si “sekrete tregtare”.

44.2 Ky nen nuk zbatohet në rastin kur informacioni që vihet në dispozicion:

- a) U jepet Palëve që duhet dhe në shkallën që nevojitet për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;
- b) Zakonisht është i disponueshëm, përveç rasteve kur sigurohet si rezultat i shkeljes së detyrimeve në këtë Kontratë;
- c) Në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 53, mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- d) Nëse kërkohet sipas Ligjit ose rregullave që rregullojnë tregun publik të titujve dhe/ose letrave me vlerë;
- e) U jepet këshilltarëve profesionistë të Koncesionarit;
- f) Huadhënësve apo këshilltarëve të tyre dhe këshilltarëve të tyre të sigurimeve; dhe
- g) Për respektimin e një urdhri të Gjykatës apo një urdhri rregullator të një Autoriteti Përkatës.

Dispozitat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë pikë, do të vijojnë të mbeten në fuqi gjatë dhe pas përfundimit të kësaj Kontrate.

NENI 45

TË DHËNAT E KONCESIONARIT

Koncesionari mban dhe ruan të dhëna të plota në lidhje objektin duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me, të dhënat për kostot faktike apo të parashikuara për operimin dhe mirëmbajtjen aeroportit dhe ofrimin e Punimeve dhe Shërbimeve, kostot e ndërtimit, shfrytëzimit dhe financimit për gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës.

NENI 46

TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

46.1 Licensa Për Autoritetin Kontraktor

Shoqëria Koncesionare i jep, dhe nëse ai nuk i ka të drejta të tilla, merr përsipër të bëjë përpjekje të arsyeshme t'i sigurojë Autoritetit Kontraktor të drejtat për të gjitha objektet e pronësisë intelektuale, të nevojshme për kryerjen e Punimeve, operimit të objektit dhe ofrimin e Punimeve dhe Shërbimeve:

- a) Pa pagesë (përveç tarifave për licencat e pronësisë intelektuale të vendosura nga palë të treta në lidhje me softuerët që zakonisht sigurohen në mënyra komerciale);
- b) Për Operimin e objektit dhe sigurimin e Punimeve dhe Shërbimeve;
- c) Për një periudhë të pakufizuar kohe nga fillimi i përdorimit të objekteve të pronësisë intelektuale për Punimet, Aeroportin ose Shërbimet;
- d) Jo ekskluzivisht, në lidhje me objektet e pronësisë intelektuale të krijuara në mënyrë të pavarur, dhe të licensuara për përdorim vetëm sipas kësaj Kontrate, ose ekskluzivisht, në rastin kur objektet e pronësisë intelektuale janë krijuar veçmas për realizimin e kësaj Kontrate; dhe
- e) Për zbatimin e kësaj Kontrate (përveç softuerit që sigurohet në mënyrë komerciale) në mënyrë të transferueshme, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të mund t'ua japë të drejtën e përdorimit të objekteve të pronësisë intelektuale Personave të tjerë ose t'ia transferojë plotësisht të drejtën e tij një Personi tjetër.

46.2 Koncesionari premtan ta zhëdmojë Autoritetin Kontraktor, për dëmin e shkaktuar ndaj tij ose Palëve të Autoritetit Kontraktor, si rezultat i kërkesave të bëra nga këto të fundit në lidhje me përdorimin e objekteve të pronësisë intelektuale të marra nga Koncesionari në përputhje me këtë Kontrate.

NENI 47

TRANSFERIMI

47.1 Përveçse në rrethanat kur lejohet shprehimisht sipas kësaj Kontrate dhe në bazë të të drejtave (interesave) mbi garancinë, asnjë Palë nuk ka të drejtë t'ia transferojë ndonjë nga të drejtat e saj një pale të tretë, pa pëlqimin e Palës tjetër. Pavarësisht nga sa më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të autorizojë subjekte të tjera shtetërore brenda kontrollit të tij për të ushtruar disa nga të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate, me kusht që Autoriteti Kontraktor të njoftojë Koncesionarin për një autorizim të tillë dhe që të mos rezultojë asnjë detyrim shtesë për Koncesionarin si rezultat i një autorizimi të tillë.

47.2 Autoriteti Kontraktor do i njoh dhe do i pranojë interesat e sigurimit të huasë dhe garancitë që Koncesionari u ka dhënë Huadhënësve në përputhje me Marrëveshjet e Financimit dhe çdo transferim i të drejtave dhe detyrimeve të kësaj Kontrate, që mund të vijë si pasojë e ekzekutimit të këtyre instrumentave, do të pranohet nga Autoriteti Kontraktor.

NENI 48

GJUHA E KONTRATËS

Kjo Kontratë është hartuar në **gjuhën shqipe dhe angleze**, në 4 (katër) kopje të barazvlefshme.

NENI 49

NJOFTIMET

49.1 Mënyra dhe Adresa e Njoftimeve

49.1.1 Të gjitha komunikimet me shkrim, të bëra sipas kësaj Kontrate, ose çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë Kontratë, nga secila nga Palët, Palës tjetër i dërgohen me një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) Dorëzim në dorë të komunikimit me shkrim;
- b) faks; dhe/ose
- c) me postë ose me shërbim korrieri.

49.1.2 Komunikim me shkrim u dërgohet palëve në adresat e mëposhtme:

a) Kur i dërgohet Autoritetit Kontraktor:

99 | F a q e

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, Nr.1 Tiranë

Web:<http://www.infrastruktura.gov.al>

Për: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

B)Kur i dergohet shoqerise koncesionare:

Adresa: Njesia administrative

Tel:

Email:

Për: VLORA INTERNATIONAL AIRPORT

49.2 Afati i Përgjigjeve

Përveç rasteve kur është përcaktuar shprehimisht ndryshe në Kontratë, Palët bien dakord që kur një njoftim apo kërkesë kërkon përgjigjen, miratimin, refuzimin, apo argumentimin e Palës tjetër, Pala që ka marrë njoftimin apo kërkesën do të shprehet me shkrim në lidhje me qëndrimin e saj brendaDitësh Kalendarike duke e argumentuar atë. Çdo vonesë apo kosto e shkaktuar kundrejt Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare si rrjedhojë e vonesës së Autoritetit Kontraktor, do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi dhe/ose Shkak Kompensimi, veç e veç ose së bashku.

NENI 50

TË PJESSHME

Nëse ndonjë dispozitë këtu është, ose bëhet e pavlefshme apo e pazbatueshme, një pavlefshmëri ose pazbatueshmëri e tillë nuk i çënon dispozitat e tjera të kësaj Kontrate. Palët marrin përsipër të zëvendësojnë dispozitën e pavlefshme dhe të pazbatueshme sa më shpejt që të jetë e mundur me një dispozitë tjetër të vlefshme dhe të zbatueshme, përmbajtja e së cilës është e ngjashme me dispozitën e pavlefshme ose të pazbatueshme.

NENI 51

MBROJTJA E TË DHËNAVE

- 51.1 Nëse të dhënat personale, përpunohen në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10 Tetor 2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, Koncesionari plotëson secilën dhe të gjitha dispozitat që rrjedhin nga ky Ligj dhe nëse kërkohet pëlqimi i subjektit të të dhënave, një pëlqim i tillë do të merret me qëllim që të dhënat personale të mund t’i jepen Autoritetit Kontraktor. Shkelja e Ligjit në lidhje me menaxhimin e të dhënave personale nga Koncesionari, do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate dhe Koncesionari do të jetë përgjegjës vetëm në lidhje me shkeljen e Ligjit.
- 51.2 Autoriteti Kontraktor nuk do ti japë një pale të tretë (përfshijto entet publike), asnjë prej të dhënave konfidenciale pjesë e ofertës së Koncesionarit, pa miratimin e Koncesionarit.

NENI 52

LIGJI RREGULLUES

Kjo Kontratë rregullohet nga Ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 53

PËRSHKALLËZIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

53.1 Negociata në Mirëbesim

Nëse lind një mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin e ndonjë dispozite të kësaj Kontrate, kjo mosmarrëveshje në fillim dërgohet për zgjidhje tek përfaqësuesit e Palëve si më poshtë:

- a) Në rast të një mosmarrëveshjeje i njoftohet me shkrim Palës tjetër nga Pala që e nis atë, duke deklaruar përfaqësuesin e saj të autorizuar që do të merret me mosmarrëveshjen;
- b) Pala tjetër i përgjigjet njoftimit të Palës së parë brenda Ditësh Pune, duke deklaruar përfaqësuesin e saj të autorizuar, i cili do të merret me mosmarrëveshjen;
- c) Përfaqësuesit e Palëve janë Personat që nuk kanë marrë pjesë në mënyrë materiale në ngjarjet që i kanë paraprirë mosmarrëveshjes;
- d) Përfaqësuesit e palëve negociojnë mosmarrëveshjen me mirëbesim dhe me qëllimin për ta

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit te perzgjedhur si me i suksesshmi.

zgjdhur atë në një mënyrë që t'i përmbahet më mirë frymës dhe qëllimit të saj; dhe, Nëse përfaqësuesit e Palëve nuk arrijnë të bien dakord për një zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda 18 (tetëmbëdhjetë) Ditësh Kalendarike nga lindja e mosmarrëveshjes, secila nga Palët mund ta çojë mosmarrëveshjen për gjykim përpara Ekspertit Teknik (siç përkufizohet më poshtë) në përputhje me Nenin 53.2 Eksperti Teknik.

53.2 Eksperti Teknik

53.2.1 BrendaDitësh Pune pas kalimit të afatit të përcaktuar në Nenin 53.1, secila Palë mund t'a referojë mosmarrëveshjen me shkrim të Eksperti Teknik i cili do të veprojë si një mekanizëm paraprak për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me natyrë teknike, vendimi i të cilit do të jetë detyrues për palët, në rast se nuk do të kundërshtojnë brenda një afati të përcaktuar dhe të dakortësuar nga palët.

53.2.2 Eksperti Teknik do të emërohet me konsensusin e Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare brenda Muajve nga Hyrja në Fuqi e Kontratës dhe do të jetë një person me kualifikimet përkatëse dhe me përvojë në llojin e ndërtimit të Punimeve dhe projekte të ngjashme (“**Eksperti Teknik**”). Emërimi i Ekspertit Teknik mund të ndërpritet me marrëveshje të dyanshme mes Shoqërisë Koncesionare dhe Autoritetit Kontraktor.

53.2.3 Kushtet e shpërblimit të Ekspertit Teknik, duke përfshirë shpërblimin e çdo eksperti tjetër me të cilin konsultohet Eksperti Teknik, do të vendosen kur të bien dakord mbi kushtet e emërimit. Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare do të jenë secila përgjegjëse për të paguar gjysmën e këtij shpërblimi.

53.2.4 Nëse aplikohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme, përkatësisht:

- a) Palët nuk arrijnë të bien dakord për emërimin e Ekspertit Teknik deri në datën e përcaktuar në pikën 53.2.2 apo
- b) Nëse Eksperti Teknik refuzon të veprojë ose nuk është në gjendje të veprojë si pasojë e vdekjes, pamundësisë, aftësisë së kufizuar, dorëheqjes ose ndërprerjes së emërimit dhe Shoqëria Koncesionare dhe Autoriteti Kontraktor nuk arrijnë të bien dakord për emërimin e një personi zëvendësues brendaDitëve Kalendarike pas datës në të cilën Eksperti Teknik nuk është në gjendje të veprojë për një nga shkaqet e mësipërme;

atëherë secila nga Palët mund të depozitojë një kërkesë në Qendrën e Ekspertizës Teknike të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, në Paris, Francë, për caktimin e një eksperti në përputhje me rregullat e saj. Ky emërim do të jetë përfundimtar dhe detyrues. Shpenzimet që mund të kërkojnë në lidhje me emërimin e Ekspertit Teknik nga kjo qendër do të përballohen nga Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare duke paguar secila gjysmën e tyre.

53.2.5 Palët do të vënë në dispozicion të Ekspertit Teknik të gjithë informacionin shtesë, akses në Territorin e Projektit dhe lehtësitë e duhura, siç Eksperti Teknik mund të kërkojë, me qëllim

- marrjen e një vendimi mbi këtë mosmarrëveshje. Eksperti Teknik do të konsiderohet se nuk vepron si arbitër.
- 53.2.6 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) Ditësh Kalendarike pas pranimit të kërkesës për vendim nga Eksperti Teknik, ose brenda një periudhe tjetër që mund të propozohet nga Eksperti Teknik dhe të miratohet nga Palët, Eksperti Teknik do të japë vendimin e tij, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe me shkrim. Përveç kur Palët bien dakord ndryshe, nëse Eksperti Teknik nuk jep vendimin e tij brenda 60 (gjashtëdhjetë) Ditëve Kalendarike pas depozitimit të kërkesës, atëherë secila Palë mund të vijojë me procedurat e Nenit 53.3.
- 53.2.7 Nëse ndonjëra Palë është e pakënaqur me vendimin e Ekspertit Teknik, atëherë kjo Palë, brenda 20 Ditëve Kalendarike pas njoftimit të vendimit, mund t'i japë një Njoftim Mospranimi Palës tjetër, që tregon mosdakordësinë dhe synimin e saj për të filluar arbitrazhin sipas Nenit 53.3, me **“Njoftim Mospranimi”**. Njoftimi i Mospranimit do të deklarojë se është dhënë sipas këtij Neni dhe do të përcaktojë çështjen në diskutim dhe arsyen/et e mospranimit. Përveçse siç parashikohet në këtë nen, asnjëra Palë nuk do të ketë të drejtë të fillojë arbitrazhin, nëse nuk është dhënë Njoftimi i Mospranimit në përputhje me këtë paragraf.
- 53.2.8 Nëse Eksperti Teknik ka dhënë vendimin e tij për një çështje në mosmarrëveshje nga Palët dhe asnjë Njoftim Mospranimi nuk është dhënë nga asnjëra prej Palëve brenda 20 Ditëve Kalendarike pas marrjes së vendimit të Ekspertit Teknik, atëherë vendimi do të bëhet përfundimtar dhe detyrues për Palët.
- 53.2.9 Kur njëra Palë ka dhënë Njoftim Mospranimi, Palët bien dakord që do të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore para fillimit të arbitrazhit. Megjithatë, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, Pala që jep një Njoftim Mospranimi në përputhje me paragrafin më sipër duhet të nisë arbitrazhin brenda Ditëve Kalendarike nga dita në të cilën është dhënë Njoftimi i Mospranimit, edhe nëse nuk është bërë asnjë përpjekje për një zgjidhje miqësore.

53.3 Arbitrazhi

- 53.3.1 Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet me negociata sipas Nenit 53.1, secila nga Palët mund ta dërgojë mosmarrëveshjen në Procesin e Arbitrazhit sipas rregullave të arbitrazhit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (“International Chamber of Commerce – ICC”). Çdo Proces Arbitrazhi i nisur në përputhje me këtë nen (**“Procesi i Arbitrazhit”**) do të zhvillohet me pjesëmarrjen e një paneli arbitrash të përbërë nga tre arbitra (**“Gjykata”**), nga të cilët 1 (një) emërohet nga Autoriteti Kontraktor, 1 (një) nga Koncesionari. Arbitri i tretë caktohet nga dy arbitrat e tjerë dhe vepron si kryetar Gjykate. Vendimi i Gjykatës është i formës së prerë, detyrues dhe i pa apelueshëm për Palët.
- 53.3.2 Vendi i arbitrazhit ështëdhe gjuha e arbitrazhit është gjuha
- 53.3.3 Gjykata zbaton kushtet e kësaj Kontrate dhe dispozitat e Ligjeve që përdoren herë pas here.
- 53.3.4 Gjykata ka të drejtë, brenda objektit të një mosmarrëveshjeje ligjore që pritet të zgjidhet, të marrë vendime për masa të ndërmjetme.

53.4 Mosmarrëveshje me institucionet në fushën e Tatimeve dhe Doganave

Mosmarrëveshjet dhe konfliktet ndërmjet shoqërisë koncesionare dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtari në fushën e tatimeve dhe doganave do të zgjidhen në Gjykatën kompetente të Republikës së Shqipërisë.

NENI 54

AMENDAMENTET E KONTRATËS

Kjo Kontratë mund të ndryshohet me anë të amendamenteve me shkrim të nënshkruara nga të dyja Palët, me përjashtim të Nenit 3, nenit 9, nenit 12, nenit 13, neni 38, nenit 52, nenit 53 të cilët mund të ndryshohen me nënshkrimin e Palëve dhe miratimin e Këshillit të Ministrave.

NENI 55

KOSTOT DHE SHPENZIMET E PALËVE

Kur nuk parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, ose në ndonjë dokument tjetër të Projektit, secila Palë i përballon vetë të gjitha kostot që i rrjedhin në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate dhe të amendamenteve të saj.

NENI 56

KONFLIKTI I KONTRATËS KUNDREJT MARRËVESHJES/VE TË TJERA

Nëse dispozitat e kësaj Kontrate bien në kundërshtim me dispozitat e një marrëveshjeje ose kontrate tjetër ndërmjet Palëve në këtë Kontratë, në lidhje me të njëjtin objekt, pavarësisht nëse një marrëveshje e tillë është bërë përpara ose pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, kjo Kontratë do të ketë gjithmonë përparësi.

Në emër të Autoritetit Kontraktor:

104 | F a q e

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Emri:

Zëvendësministër

Përfaqësues me Autorizim

Data:

Në emër të Shoqërisë Koncesionare:

“.....”

Emri:

Data:

SHTOJCA 1

**VENDODHJA /TERRITORI I PROJEKTIT DHE TË DHËNAT E VËNA NË
DISPOZICION NGA AUTORITETI KONTRAKTOR**

ZONA E KONCESIONIT

Zona e Koncesionit përfshin certifikata të rregjistruara ne Zyren Vendore Vlore te Agjencise Shteterore te Kadastrës qe do te behen pjese integrale e kësaj kontrate

TË DHËNA TË TJERA TË VËNA NË DISPOZICION NGA AUTORITETI KONTRAKTOR

SHTOJCA 2

DOKUMENTAT E PROJEKTIT

DRAFT

SHTOJCA 3

PROJEKT IDEJA, SKICAT, PLANIMETRITË DHE GRAFIKU I PUNIMEVE/
SHËRBIMEVE SIPAS OFERTËS TË PARAQITUR NË TENDER

DRAFT

SHTOJCA 4

SHËRBIMET E AERODROMIT

Pjesa A. Shërbimet e Autoritetit Kontraktues/Përgjegjese

Autoritetit Kontraktues/Përgjegjese do të jetë i detyruar të sigurojë shërbimet e mëposhtme në aeroport:

1. Shërbimet e Lundrimit Ajror, që ofrohen në aerodrome për nisjen dhe mbërritjen e fluturimeve.
2. Sigurimin, mirëmbajtjen dhe operimin e asistencës së navigacionit dhe pajisjeve tjera të Kontrollit të Trafikut Ajror (duke përfshirë, sistemin e navigacionit ajror në pronësi dhe që mirëmbahet nga ofruesi i shërbimit përkatës i navigacionit ajror siç janë, kulla e kontrollit dhe zyra të dedikuara të ANSP-së, radarin dhe instrumentet e sistemit të uljes (ILS); lokalizuesin dhe antenën për kalim rruge, pajisjet matëse për distancë (DME); Linjën Doppler me frekuencë shumë të lartë me drejtim omni (D-VOR), dhe furnizimin me energji të dedikuar për mjetet e navigacionit dhe instalime të tensionit të ulët të komunikimit).
3. Shërbimi i Informacioneve të fluturimeve dhe Zyra e Planifikimit të Fluturimeve.
 - A. Shërbimi Informativ mbi Fluturimet apo qëllimi i dhënies së këshillave dhe informatave të dobishme për zhvillimin e sigurt dhe efikas të fluturimeve.
 - B. Plani Fluturimeve ka të bëjë me informacione të caktuara të siguruara për njësitë e trafikut ajror, në lidhje me një fluturim të caktuar ose pjesë të një fluturimi të një aeroplani.
4. Shërbimi Njoftimit dhe Veprimit Emergjent në rast të Aksidenteve të Aviacionit, të administrimit të krizës. Shërbimi i ofruar për të njoftuar organizatën përkatëse lidhur me avionët që kanë nevojë për ndihmë në kërkim dhe shpëtim, dhe të ndihmojnë organizata të tilla sipas nevojës.
5. Shërbimet Meteorologjike.
6. Shërbimet e Policisë Kufitare dhe Migracionit.
7. Shërbimet e Emigracionit.
8. Doganat dhe Inspektimet Bujqësore.
9. Zonimi, përputhja me rregulloret e sigurisë dhe aeronautike jashtë objektit

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me përshtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

10. Rregullorja e Sigurimit. Autoriteti do të ketë përgjegjësinë të përcaktojë rregullat dhe rregulloret për zbatim në Shqipëri lidhur me sigurimin e aeroportit dhe të sigurojë koncesionarin me direktivat përkatëse për shërbimet e sigurimit në aeroport.
11. Rregullorën e Sigurimit, siç përcaktohet në ligjin 10040 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë “ të ndryshuar
12. Hetimet Aksidenteve dhe Incidenteve të Aviacionit.
13. Furnizimi i licencave dhe të autorizimeve tjera të aeroportit të kërkuara me ligj.

Pjesa B. Shërbimet e Aeroportit

Me përjashtim të Shërbimeve Qeveritare, Koncesionari do të jetë i detyruar të sigurojë ose të nxis që të sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme të arsyeshme për operimin e sigurt dhe të vazhdueshëm të aeroportit, duke përfshirë, pa kufizim, sigurimin e objekteve dhe shërbimeve në vijim:

1. Operim të sigurt dhe të qetë të aeroportit (me përjashtim të Shërbimeve Qeveritare).
2. Shërbimet ARFF dhe CFR, duke përfshirë aksidentet, zjarrfikjet, shpëtimet nga zjarri, kërkimin dhe shpëtimin, shërbimet emergjente mjekësore dhe të ndihmës në ANP.
3. Shërbimet e sigurisë (siç është e përcaktuar në Marrëveshje), përfshirë ofrimin e personelit dhe pajisjeve për skanimin e personave (përfshirë pasagjerët, ekuipazhin), bagazhin e kabinës, bagazhin e hambarit, të kargos dhe postës. Kryerjen e kontrolleve të sigurisë në hyrje të personave të tjerë jo pasagjerë dhe sendeve që ata mbartin, ekzamimin e automjeteve dhe sigurinë e avionit, në përputhje me SARPs, ECAC Dok.30 dhe kërkesat kombëtare., bagazhit dhe ngarkesave.
4. Menaxhimi i sigurisë së aeroportit nga nderhyrjet e paligjeshme (ICAO Dok 8973) dhe Menaxhimi i sistemit të sigurisë në operim (safety) në përputhje me ICAO DOC 9859.
5. Menaxhimi i Emergjencës.
6. Kontrolli i lëvizjes së automjeteve rreth aeroplanëve.
7. Caktimi i vendeve, planifikimi dhe caktimi i daljeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi
8. Shërbimet e përpunimit në tokë të avionëve, ku përfshihen, por pa u kufizuar në to:
 - shërbimet e administrimi dhe mbikqyrjes;
 - Përpunimi i pasagjereve;

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

- perpunim i bagazheve;
 - perpunimi i mallrave dhe postes;
 - perpunimi i avioneve ne VQA(rampe) (si shtyrja po terheqja e avioneve, drejtimi i mareshalleve, vendosja e pajisjeve te nevojeshme per perpunimin e avionit, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave, hipjen apo zbritjen e pasagjerve, etj;
 - sherbimet e avionit si pastrimi si brendeshem dhe i jashtem) dhe ftohja dhe ngrohja e kabines;
 - sherbimet ne platformen e lëvizjes të aeroplanëve;
 - furnizimin e avioneve me karburant dhe vaj;
 - transporti tokesor i pasagjerve, bagazheve, mallrave dhe postes;
 - sherbimet e furnizimit te avioneve me catering;
 - heqja e ujrave te perdorur dhe plehrave nga avioni;
 - furnizimin e avionit me uje te pishem;
 - Furnizimin e avioneve me energji elektrike gjate qendrimit ne rampe;
 - furnizimi i mallrave pa taksa doganore;
9. Mirëmbajtja, pastrimi i pistës dhe ofrimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të pistës dhe shenjat duke përfshirë aeroportin, vendparkimin dhe ndriçimin e pistës (duke përjashtuar sistemin e navigimit ajror në pronësi dhe që mirëmbahet nga ofruesi i shërbimit të navigacionit ajror).
 10. Operimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ekspozimit të informacionit të fluturimit, sistemeve të bagazhit dhe karrocave të bagazheve.
 11. Operimi, mirëmbajtja dhe pastrimi i zonave publike dhe të kufizuara (përfshirë hapësirat e banjove) dhe heqjen e plehrave dhe mbeturinave.
 12. Trajtimin, regjistrimin dhe kontrollin e nisjes së Udhëtarëve dhe bagazhit të tyre dhe/apo të kargos, (duke përfshirë magazinimin) dhe transferimin e Udhëtarëve, bagazhit të tyre apo kargos në dhe nga aeroplani.
 13. Vendparkim të veturave për stafin e punësuar në aeroport dhe Udhëtarët në aeroport dhe të personave tjerë që vizitojnë atë në vazhden e zakonshme të punës dhe sigurimin e shërbimeve të ndërlidhura me parkimin e veturave.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

14. Produkte për konsumatorë (qoftë me ose pa doganë) dhe shërbimet për stafin dhe Udhëtarët dhe/ose personat tjerë që vizitojnë aeroportin, duke siguruar shërbim adekuat të udhëtarëve dhe vizitorëve gjatë çfarëdo periudhe të orarit të fluturimeve komerciale.
15. Shërbime të informimit të përgjithshëm për Udhëtarët dhe/ose Personat tjerë që vizitojnë aeroportin;
16. Sigurimi i ekraneve për shpalosjen e informatave të fluturimeve dhe planifikimi dhe alokimi i tavolinave për regjistrim për linjat ajrore për të mundësuar përdorim efikas të tavolinave të regjistrimit, duke përfshirë sistemet për përdorim të zakonshëm (CUTE);
17. Operimi dhe mirëmbajtja e sistemeve për hipje në aeroplan dhe zbarkim të Udhëtarëve, duke përfshirë veturat për të kryer hipjen në largësi; hipjen dhe zbritjen e Udhëtarëve me aftësi të kufizuara dhe të ngarkim-shkarkimit të mallrave.
18. Operimi dhe mirëmbajtja e përgjithshme dhe riparimi i aeroportit, duke përfshirë терминаlet e Udhëtarëve, zonat e gjelbra (përfshirë shërbimet për zbukurim të peizazheve), sistemet rrugore, hapësirat për parkim të veturave (përfshirë, shenjat e trafikut dhe shërbimeve).
19. Sigurimi i zyrave adekuate për linjat ajrore dhe zyrave mbështetëse.
20. Mirëmbajtja e hapësirave të zyrave të siguruara për kryerjen e Shërbimeve Qeveritare
21. Sigurimi i trajtimit të ujërave të zeza (përfshirë rjedhjen e ujërave sipërfaqësore) dhe heqjen e mbeturinave.
22. Funkcionet e përgjithshme administrative dhe menaxheriale të nevojshme për operimet e aeroportit, si faturimi dhe inkasimi.
23. Gatishmëria operationale e aeroportit, siç është e përcaktuar me Manualet e Shërbimeve të Aeroporteve ICAO, duke përfshirë:
 - a. Operimin, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin me kohë të të gjitha objekteve brenda aeroportit;
 - b. Inspektimin dhe testimin e sipërfaqes së Aeroportit;
 - c. Kontrollin tokësor dhe ajror në mjetet vizuale;
 - d. Objektet dhe operimet për mot të keq;
 - e. Zvoglimin e rrezikshmërisë nga zogjët;
 - f. Menaxhimin e platformave dhe sigurinë e platformave;
 - g. Kontrollin e zhurmës tokësore;
 - h. Ndarjen e zonave të aeroportit dhe kontrollin dhe largimin e pengesave;

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

- i. Menaxhimin e aksidenteve dhe incidenteve të aeroplanëve, në koordinim me Autoritetet Relevante;
 - j. Planin e Emergjencës së Aeroportit; dhe
 - k. Qendrën emergjente të kontrollit të Aeroportit;
24. Shërbimet Mjekësore)
 25. Lehtësimet (ndihmat)
 26. Ekzaminimi i sigurisë së stafit të bagazhit, udhëtarëve, vizitorëve, automjeteve dhe mallrave;
 27. Zhvillimi, operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të sortimit të bagazhit;
 28. Ofrimi i ndihmës për operimin e fluturimeve dhe sistemet për përkrahjen e ekuipazhit;
 29. Mirëmbajtja dhe riparimi i përgjithshëm i aeroportit
 30. Menaxhimi dhe operimi i hapësirave për VIP dhe CIP;
 31. Menaxhimi Sistemit Qendror të Aeroportit për Menaxhimin e Informatave dhe infrastrukturave të ndërlidhura; Ofrimi i të dhënave ekskluzive mbi aerodromin, me të dhënat të ndërlidhura me Shërbimet e Kontrollit të Trafikut Ajror; Informata mbi flutrimet edhe përbrenda Aeroportit edhe jashtë Aeroportit për aviokompanitë, Udhëtarët dhe shfrytëzuesit tjerë.
 32. Menaxhimi dhe administrimi i personelit të punësuar nga koncesionari dhe lejimi dhe kontrolli i hyrjes i të gjithë personelit përbrenda zonës së sigurisë së Aeroportit.
 33. Koordinimi i të gjitha aktiviteteve në Aeroport, duke përfshirë edhe themelimin dhe administrimin e të gjitha komisioneve koordinuese për shfrytëzuesit, rregullatorët dhe aksionarët e ndryshëm të Aeroportit.
 34. Menaxhimi dhe monitorimi mjedisor i Aeroportit;
 35. Marketingu i Aeroportit dhe zhvillimi i linjave.
 36. Shërbimet Komerciale të Aeroportit, siç janë
 - a) Ushqimi dhe pijet
 - b) Shërbimet bankare dhe këmbimoret
 - c) Reklamimi dhe publiciteti
 - d) Shitja me pakicë dhe e mallrave të liruara nga dogana (Duty Free)
 37. Çdo shërbim tjetër që parashtrohet zakonisht në aeroporte ndërkombëtare, që përndryshe nuk është Shërbim që sigurohet nga Autoriteti Kontraktues.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

SHTOJCA 5

TREGUESIT KYC TË PERFORMANCËS

(Shtojcë e cila paraqitet nga Shoqëria Koncesionare dhe rregullohet sipas dispozitave të kësaj kontrate)

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim të pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 6
PREVENTIVI

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 7

MODELI FINANCIAR PARAQITUR NË TENDER

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 8

SIGURIMET QË KËRKOHEN (TË NEVOJSHMET)

Pjesa 1. – Sigurimet per periudhen e punimeve te ndertimit.

Kerkesat minimale per sigurim

Shoqeria koncensionare pajiset dhe mban sigurimet si percaktuar me poshte pergjate gjithe periudhes se punimeve te ndertimit te objektit te koncensionit, nga sigurues dhe risigurues te pranueshem per Entin Kontraktor.

Sigurimi nga te gjitha rreziqet CAR/EAR i punimeve te ndertim & montimit:

- Mbulimi, per te gjithe periudhen e parashkuar per kryerjen e punimeve si ato provizore nese parashikohen te tilla, ashtu dhe punimet kapitale ose perfundimtare, plus periudhen e garancise se punimeve te ndertimit;
- Shuma e sigurimit e shenuar ne police, jo me e vogel se vlera e preventiivuar per realizimin e punimeve te kontraktuara;
- Personi i siguruar Kontraktori dhe nenkontraktoret apo furnizuesit e kontraktorit lidhur me punimet e objektit te koncensionit;
- Polica CAR/EAR duhet te perfshije Seksionin e mbulimit te pergjegjesise ndaj paleve te treta, me kufi minimal pergjegjesie prej jo me pak se EURper ngjarje sigurimi dhe jo me pak se EURpergjate gjithe periudhes se sigurimit.

- Te pergjithshme
 - a) Demet potenciale paguhen ne monedhen qe palet dakortesojne ne percaktimin e shumes se sigurimit ne police. Si rregull monedha e percaktuar ne kontraten e koncensionit eshte edhe monedha e polices se sigurimit;
 - b) Siguruesit heqin dore nga te gjitha te drejtat e regresit kundrejt paleve te percaktuara si “person i siguruar”, ne policen e sigurimit. Per efekt te kesaj klauzole “te drejtes se regresit”, do te konsiderohet se Siguruesi i ka leshuar police te vecante seciles pale te perfshire ne ”personin e siguruar” ne police;
 - c) Shuma e cdo demshperblimi potencial do te llogaritet ne koston e plote te zevendesimit te asetit te demtuar pjeserisht apo plotesisht dhe pershin edhe çdo material te furnizuar koncensionarit pa pagese;
 - d) Polica e sigurimit perfshin edhe mbulimin e shkaktuar nga projekti i gabuar;
 - e) Pjeset e zbritshme dhe shtojcat e percaktuara ne policen e sigurimit, ne lidhje me çdo nje ngjarje dhe per cdo rrisht te mbuluar(peril) percaktohen ne pajtim me traditen me te mire te praktikuar ne vendin e leshimit te polices se sigurimit.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim të përshtatjes me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

Pjesa 2. – Sigurimet ne periudhen e shfrytezimit.

Kerkesa minimale per sigurim

Konçensionari pergjate te gjithë periudhes se shfrytezimit te konçensionit eshte i detyruar te pajiset e te mbaje ne fuqi dhe efektive polica sigurimi qe mundesojne me mbarimin e afatit te konçensionit kthimin e objektit ne gjendje pune e te mirembajtur te objektit te konçensionit Autoritetit Kontraktor.

1) Mbulimi nga te gjitha rreziqet per deme materiale “All risks” ose nga te gjitha rreziqet i objektit te konçensionit;

- Mbulimi, i te gjitha asetëve te trupezuara dhe te pa trupezuara te objektit te konçensionit, si ndertesat, Makinerite & pajisjet, Instalimet te gjitha inventarin e pajisjeve, perfshi edhe avarine e makinerive qe mundesojne ushtrimin normal te aktivitetit te objektit te konçensionit;
- Mbulohen gjithashtu edhe rreziqet shtese qe kerkojne prim te vecante si Aktet vandaliste, terrorizmi & sabotazhi, trazirat civile, grevat e demonstrimet;
- Shuma e siguruar, ne pajtim me vlerat e inventarit te asetëve, por ne asnje rast me e vogel se vlera e zevendesimit te cdo aseti, qe mundeson zevendesimin e cdo artikulli te demtuar pjeserisht apo totalisht;
- Afati, e gjithë periudha e percaktuar per kohezgjatjen e konçensionit;
- Person i siguruar, konçensionari dhe Enti Prokurues me cilesin e te bashkesiguarit;
- Siguruesit heqin dore nga te gjitha te drejtat e regresit kundrejt paleve te percaktuara si “person i siguruar”, ne policen e sigurimit. Per efekt te kesaj klauzole “te drejtes se regresit”, do te konsiderohet se Siguruesi i ka leshuar police te vecante seciles pale te perfshire ne ”personin e siguruar” ne police;
- Pjeset e zbritshme e percaktuara ne policen e sigurimit, ne lidhje me çdo nje ngjarje dhe per cdo rrisht te mbuluar(peril) percaktohen ne pajtim me traditen me te mire te praktikuar ne vendin e leshimit te polices se sigurimit.

2) Sigurimi i Pergjegjesise Ligjore Civile ndaj Paleve te Treta GTPL – General Third Party Liability,

Objekti i kësaj kontrate është marrëdhënia juridike në të cilën Siguruesi, brenda limitit të dëmshpërblimit dhe në përputhje me këto kushte sigurimi, në zbatim të vendimit të gjykatës për ngarkimin me përgjegjësi ligjore të të Siguarit e kompenson atë, përkundrejt pagimit të primit te sigurimit prej tij, për:

- Dëmshpërblimin e humbjeve dhe demeve te palëve të treta duke perfshire edhe shpenzimet dhe kostot ligjore të të Siguarit për mbrojtjen e interesave të tij gjatë procesit të gjykimit, të shkaktuara nga ngjarje te papritura, te pa parashikuara (aksidente) te ndodhura ne ambjentet ku ushtrohet aktiviteti i te Siguarit qe rezulton me pasoja në:

Shëndetin e palëve të treta, që nënkupton demtime fizike, sëmundjen ose vdekjen e çdo personi qe nuk eshte pale ne kete kontrate sigurimi (deme ne njerez);

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si per qellim me pershtatjen me oferten fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit te perzgjedhur si me i suksesshmi.

Sendeve të palëve të treta, që nënkupton dëmtime fizike ose shkatërrim të pronës në zotërim të çdo personi ose enti që nuk është palë në këto kontrata (deme në sende).

- Limiti i Dëmshpeblimit; jo më pak se EUR 2,000,000. për një ngjarje të sigurimit dhe jo më pak se EUR 2,500,000. për gjatë të gjithë periudhës së sigurimit.
- Nenlimiti për çdo një person: EUR 20,000;
- Personi i siguruar, konçensionari dhe Enti Prokurues me cilësinë e të bashkësiguruarit;

3) Sigurime të tjera.

Konçensionari në zbatim të përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.10076, dt. 12.02.2009 “Për sigurimin e Përgjegjësisë së sektorit të Transportit” është i detyruar që të lidhë kontrata për shfrytëzimin e objektit të konçensionit vetëm me operatore të transportit ajror që respektojnë detyrimet ligjore në fuqi në Republikën Shqiptare, si përcaktuar në Ligjin e sipërpermendur dhe konsistojnë:

- Detyrimin për të siguruar të Pronarit dhe Përdoruesit të Mjetit Ajror, Ligji 10076 dt.12.02.2009, Neni 4 & 5,
- Sigurimin e Pasagjerëve nga Aksidentet në Transportin Publik, Ligji 10076 dt.12.02.2009, Neni 17/dh;
- Sigurimin e Përgjegjësisë së Pronarëve të Avioneve për Deme shkaktuar Paleve të Treta- Ligji 10076 dt.12.02.2009, Neni 48/1, për mjetet ajrore të rregjistruara në Republikën e Shqipërisë; dhe Ligji 10076 dt.12.02.2009, Neni 48/8, për mjetet ajrore të rregjistruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Limitet e Përgjegjësisë për mbulimet e mjeteve ajrore të transportit përcaktohen në Ligji 10076 dt.12.02.2009, Neni 49.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim të përshtatjes me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 9

DOKUMENTACIONI I TENDERIT

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim të përshatjen të ofertës fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 10

PLANI I TARIFAVE TË SHERBIMIT

TARIFAT DHE TË ARDHURAT NGA TARIFAT

Tarifat e Aeroportit të Vlores janë:

- Kosto e uljes /Landing Cost
- Parkimi
- Tarifa ndërkombëtare/ International pax fee
- Tarifa për sigurinë/ Security fee
- Ground handling
- Shërbimet e komunikimit/ Communication service
- Taksa për kalimin e kufirit/ Border crossing tax

Të ardhurat e Aeroportit të Vlores realizohen nga:

- Të ardhurat nga shërbimet e aviacionit (aviation services)
 - Tarifat e pasagjerëve/ Passenger Service Fee Revenues
 - Ruajtja e kargove/ Storage Cargo Revenues
 - Tarifat e sigurimit/ Security Charge Revenue
 - Shërbimet e uljes/ Landing Revenues
 - Parkim/ Parking Revenues
 - Ndricim/ Lighting Revenues
 - Ground Handling Revenues
 - Tarifat për kargot/ Cargo Charge Revenues
- Të ardhurat nga shërbimet e tjera që nuk lidhen me aviacionin (non-aviation services)
 - Nga dyqanet/ Retail income
 - Parkim për makinat/ Car parks and access income
 - Nga qeratë/ Rentail income
 - Të ardhura nga marketingu/ Marketing Revenues
 - Restorante dhe bare/ Food & Beverage

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim të përshtatjes me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 11

DETYRAT KRYESORE TË INXHINIERIT TË PAVARUAR

Roli i Inxhinierit të pavarur

Inxhinieri i pavarur (IP) kontraktohet nga Autoriteti Kontraktues (AK) për të menaxhuar dhe përmirësuar disa aspekte të caktuara të Kontratës së Koncesionit, kryesisht në lidhje me verifikimin e përmbushjes nga Koncesionari të Kërkesave teknike të Autoritetit Kontraktues (Kërkesat e Investitorit, KI).

Në përgjithësi, roli i Inxhinierit të pavarur duhet të zgjerohet për të mbuluar funksione për cilat Autoriteti Kontraktues nuk është plotësisht i pajisur.

Inxhinierit të pavarur konsulent i kërkohet të ofrojë ekspertizë në të gjitha fushat e Koncesionit pa përjashtim. Çdo aspekt i ecurisë së Koncesionit duhet t'i nënshtrohet certifikimit në bazë të Sistemeve të tij të cilësisë dhe auditimit sa i takon cilësisë në lidhje me rezultatet e Koncesionarit me cilësi të siguar dhe kontrolluar. Për këtë arsye dhe në mbështetje të funksioneve që duhet të kryejë Inxhinieri i pavarur duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm, i cili duhet të zotërojë njohuritë e duhura të fushës. Si minimum, personeli i Inxhinierit të pavarur duhet të përfshijë specialitetet e mëposhtme:

- Kryeinxhinier
- Inxhinier të materialeve
- Inxhinier Gjeolog
- Inxhinier gjeoteknik
- Inxhinier strukturor
- Inxhinier për sinjalistikën
- Inxhinier mjedis
- Inxhinier elektronike
- Inxhinier topograf
- Inspektor për sigurinë dhe shëndetin në punë

Roli i Inxhinierit të pavarur është certifikimi i pavarur i punës konform kërkesave dhe që çdo punë bëhet nëpërmjet sigurimit të cilësisë/kontrollit të cilësisë të Koncesionarit, sic mund të jetë e nevojshme herë pas here, në përputhje me udhëzimet ekzekutive të Autoritetit Kontraktues për të konfirmuar dhe/ose korrigjuar ecurinë.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

Inxhinieri i pavarur mbikëqyr dhe kontrollon, nëpërmjet Sistemeve të veta të cilësisë, ecurinë e Koncesionarit. Inxhinieri i pavarur kryen auditim të kontrollit të cilësisë sipas nevojës (në bazë të variancës statistikore të ecurisë së Koncesionarit), për të konfirmuar certifikatën e përputhshmërisë të Koncesionarit.

Nëse certifikata e Inxhinierit të pavarur për punën e Koncesionarit, si për Koncesionarin ashtu edhe për Autoriteti Kontraktues, thotë se ka mosplotësim, atëherë Sistemet e cilësisë të Koncesionarit duhet të diktojnë që puna të korrigjohet/përsëritet.

Më me hollësi, Inxhinieri i pavarur ndërmer funksionet e mëposhtme:

I-Funksione të përgjithshme

1. kryen kontrole të përgjithshme, auditon dhe asiston në prova ose hetime në lidhje me Punimet ose Shërbimet, duke pasur në çdo moment liri të pakufizuar për të hyrë në çdo territor ose punishte ku prodhohen materiale, në varësi të ndjekjes së të gjitha procedurave përkatëse të sigurisë;
2. mbikëqyr plotësimin nga Koncesionari të dispozitave të Kontratës së Koncesionit, me përshatjet përkatëse që lejon Kontrata, dhe informon menjëherë Autoritetin Kontraktues dhe Koncesionarin nëse konstatohet mosplotësim;
3. ka liri të pakufizuar hyrjeje në Territorin e Projektit në çdo moment të arsyeshëm gjatë të gjithë Periudhës së Kontratës në mënyrë që të kryejë funksionet e tij;
4. ka të drejtë të hyjë në çdo pronë që përdor Koncesionari për realizimin e Punimeve dhe Shërbimeve, për të kontrolluar plotësimin e tyre nga koncesionari në zbatim të kontratës ;
5. ka të drejtë të hyjë në çdo moment në vendet ku përgatitet puna ose nxirren materialet për Projektin, për ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Koncesionari;
6. ka të drejtë të thërrasë palët në takim, kur e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e problemeve ligjore ose tekniko ekonomike që bien ndesh me zbatimin/ecurinë e kontratës.
7. ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet ku diskutohet ecuria mujore ose me shpeshtësi tjetër në lidhje me Punimet dhe/ose Shërbimet dhe të marrë njoftim në kohën e duhur për këto mbledhje nga Koncesionari;
8. ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të të gjitha skicave, lidhjeve, specifikimeve dhe shtojcave, pas çdo modifikimi që u bën Koncesionari;
9. ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të ndreqë çdo defekt në plotësimin e detyrimeve në bazë të Kontratës dhe të vlerësojë se sa janë korrigjuar këto defekte;
10. ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të largojë nga Territori i Projektit çdo agjent ose punëmarrës të Koncesionarit ose çdo Nënkontraktor të cilitdo nivel, sipas rastit, që, sipas mendimit të Inxhinierit të Pavarur, bën shkelje ose është i paaftë ose tregon pakujdesi në

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurave konkurruese, si për qellim me përshatjet me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

kryerjen siç duhet të detyrave në lidhje me Projektin, ose prania e të cilëve konsiderohet e padëshirueshme në Territorin e Projektit;

11. konsultohet me Palët për çdo çështje që ka të bëjë me Punimet dhe Shërbimet;

12. u jep raporte ose informacione Autoritetit Kontraktues,

13. shqyrton shfuqizimin ose ndryshimin me ndikim negativ të të gjithave ose disave prej Dokumenteve të projektit dhe jep kundërshtimin e vet për këtë nëse është nevoja;

14. sa herë i kërkohet të japë vendim, opinion ose pëlqim apo të shprehë bindjen ose aprovimin e tij ose të kryerje veprime të tjera që mund të prekin të drejtat dhe detyrimet e Palëve të përfshira (“Konstatim”), nëse nuk parashikohet ndryshe, Inxhinieri i pavarur e bën këtë Konstatim sapo ta ketë të mundur dhe në çdo rast brenda afatit të parashikuar në Kontratën e Koncesionit dhe/ose në Kërkesat e Autoritetit Kontraktues sipas çështjes në fjalë dhe i komunikon komentet që mund të ketë në lidhje me këtë Konstatim brenda afatit përkatës;

15. jep vlerësim mospranues për raportet që janë mbështetur në informacione ose të dhëna të gabuara ose që nuk janë në përputhje me këtë Kontratë;

16. ka të drejtë të shikojë, auditojë dhe marrë kopje të evidencave të Koncesionarit në çdo moment;

17. e ndryshon adresën pasi i ka njoftuar Palët e përfshira.

II-Funksione të veçanta në lidhje me Aspektet e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe Kontratën e Koncesionit

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

1. Aprovon dhe jep komente për Manualin e kontrollit të cilësisë për operimin dhe mirëmbajtjen.

2. Këqyr dhe auditon Sistemin e menaxhimit të cilësisë të Koncesionarit dhe planet e lidhura të cilësisë, përfshirë edhe ato të projektuesve, Nënkontraktorëve dhe furnitorëve të tij, në intervalet që i konsideron të arsyeshme Inxhinieri i pavarur.

3. Shqyrton dokumentacionin e cilësisë në përputhje me standardin e kërkuar.

4. Aprovon dhe komenton për Sistemet përkatëse të cilësisë të hartuara nga Koncesionari përpara fillimit të çdo pjese të Punimeve ose Shërbimeve dhe përditësimet e tyre gjatë Periudhës së vlefshmërisë së Kontratës.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

5. Merr pjesë së bashku me menaxherin e projektit të Koncesionit në kontrollet zyrtare dhe të parashikuara me grafik të niveleve të shërbimit që zhvillohen dhe që realizohen nga Njësia e Zbatimit të Projektit.

Operimi dhe Mirëmbajtja

1. Aprovon dhe jep komente për projekt-versionin e hollësishëm të:

- Manualit të kontrollit të cilësisë për operimin dhe mirëmbajtjen
- Manualit të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës për operimin dhe mirëmbajtjen
- Manualit të operimit dhe mirëmbajtjes rutinë
- Manualit ose manualeve të kontrollit dhe monitorimit
- Planit të administrimit mjedisor

2. Bie dakord, shqyrton përditësimet vjetore dhe aprovon ndryshimet për dispozita të posaçme për kërkesat për operimin dhe mirëmbajtjen të cilat janë pjesë e Manualit të operimit dhe mirëmbajtjes.

3. Shqyrton dhe aprovon justifikimin e paraqitur nga Koncesionari për devijimin nga afatet e kundërpërgjigjeve për shkak të kushteve të ashpra të motit.

4. Miraton (së bashku me policinë) gamën e shërbimeve në rast aksidenti.

5. Aprovon ose komenton për Planin në kundërpërgjigje të situatave të forces madhore ose situata të tjera të rënda.

6. Merr raportet dhe evidencat e Koncesionarit për situatat e forces madhore ose situata të tjera të rënda.

7. Konsultohet me Koncesionarin në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të situatave të forcës madhore ose situata të tjera të rënda, në varësi të llojit të tyre.

8. Aprovon projekt-versionin e hollësishëm, versionin përfundimtar dhe përditësimet e përvitshme të Planit të mirëmbajtjes gjatë dimrit të Koncesionarit.

9. Bie dakord dhe jep aprovimin për shfrytëzimin e teknologjive të ngjashme ose të përmirësuara që duhen përdorur për matjen topografike.

10. Merr raporte tremujore nga Koncesionari ku përshkruhen me hollësi punimet e realizuara në tremujorin e fundit apo që propozohen për të ardhmen.

11. Këshillon për hetimet shtesë që duhen kryer në lidhje me kushtet ekzistuese gjeoteknike dhe rreziqet urgjente të mundshme.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

12. Identifikon bashkërisht me Koncesionarin riparimet që duhen kryer nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues.

13. Aprovon kohën shtesë të nevojshme për riparime në përputhje me këtë kontratë koncesioni, në rast se do kërkohen nga palët.

14. Aprovon dhe auditon programin që do zbatohet nga koncesionari sipas parashikimeve të kësaj kontrate koncesioni.

15. Bie dakord dhe shqyrton çdo vit përditësimet e programit që do zbatohet nga koncesionari sipas parashikimeve të kësaj kontrate koncesioni

16. Aprovon ndryshimet që i bëhen programeve të parashikuara që do zbatohen nga koncesionari në rast se nuk arrihen objektivat e parashikuara.

Sistemet e kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit

1. Këshillon për kohën e lejuar për riparimet e defekteve në rastet kur këto riparime janë të nevojshme dhe nuk mund të përfundohen brenda afatit kohor të dakordësuar të palëve.

2. Jep këshilla dhe orientime për kontrollet e strukturave në lidhje me përmbushjen e standardeve shqiptare dhe evropiane dhe të Praktikës së mirë të sektorit ekonomik, si edhe sistemin e menaxhimit të strukturave.

3. Aprovon projekt-propozimin e hollësishëm për zhvillimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës.

4. Aprovon/konfirmon demonstrimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës.

5. Aprovon sistemet e menaxhimit me licencë të blerë.

Punimet kapitale dhe Riparimet kapitale

1. Bashkërendon dhe mbikëqyr Punimet kapitale dhe/ose Riparimet kapitale, që merr përsipër Autoriteti Kontraktues dhe/ose nënkontraktori i Autoritetit Kontraktues gjatë kohëzgjatjes së Koncesionit, të cilave duhet t'u bëjë vend Koncesionari.

2. Jep rekomandime (shtesë) për standardet e projektimit që duhen përdorur në propozimet e reja si edhe në përgatitjen e të gjitha projekteve kryesore përfundimtare të elementeve të Punimeve kapitale nga Koncesionari.

3. Aprovon paketën e plotë të standardeve të projektimit për secilin element të Punimeve që ka përpiluar Koncesionari përpara fillimit të çdo projekti teknike kryesor përfundimtar.

4. Konfirmon miratimin e tij për projekt-propozimin me shkrim me t'u arritur marrëveshja për këtë.

Ky draft kontratë, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim të përshtatjes me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

5. Shqyrton dhe aprovon shtesat dhe ndryshimet në projekt-propozimin e pranuar të paraqitur nga Koncesionari si shtojca përpara fillimit të punës për aspektet e punimeve që preken nga shtojca në fjalë.
6. Kontrollon efektin që kanë Objektet e përkohshme tek struktura e përhershme (por nuk kontrollon Objektet e përkohshme).
7. Shqyrton vlefshmërinë e projektit dhe verifikon certifikatat e të gjitha Objekteve të përkohshme.
8. Shqyrton dhe pranon (ose refuzon) projektin e plotë përfundimtar për elementet e Punimeve kapitale që duhet të përfshijnë evidencat të plota të projektit të aprovuar.
9. Kërkon dhe përdor manualin e projektimit si tekst të plotë mbështetës dhe dokument efikas pune.
10. Komenton dhe aprovon programin e punës për projektet teknike të paraqitura nga Koncesionari për të gjitha elementet që përbëjnë Punimet kapitale.
11. Shqyrton projekt-propozimet e paraqitura, në konsultim me Autoritetit Kontraktues. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i pavarur:
 - aprovon materialin e paraqitur,
 - jep aprovim të kushtëzuar që kërkon bërjen dhe përfshirjen e rishikimeve në skicat e punës ose
 - refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues dhe/ose kriteret e projektimit.
12. Shqyrton skicat teknike të punëve të paraqitura. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i pavarur:
 - aprovon materialin e paraqitur,
 - refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues dhe/ose kriteret e projektimit ose me komentet e bëra nga Inxhinieri i pavarur si pjesë e aprovimit të kushtëzuar të propozim-projektit.
13. Monitoron Punimet në përputhje me Kontratën e Koncesionit.
14. Merr dhe aprovon planin për menaxhimin e ndërtimit të Punëve kapitale për të gjitha Aspektet e punëve kapitale.
15. Aprovon programin e hollësishëm të projektimit dhe ndërtimit të paraqitur nga Koncesionari.
16. Aprovon raportet mujore të ecurisë dhe përditësimet e programit sipas kërkesave.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

17. Merr pjesë në procesin vjetor të konsultimeve dhe aprovimeve në lidhje me realizimin e Punimeve në bazë të datave të paracaktuara të fillimit dhe përfundimit (ose datave të kushtëzuara të fillimit dhe data përkatëse të përfundimit, sipas rastit).

Menaxhimi dhe vlerësimi i ecurisë

1. Monitoron dhe raporton për ecurinë e Koncesionarit kundrejt kërkesave kontraktore në bazë të Relacioneve mujore/vjetore të ecurisë, Manualit të operimit dhe mirëmbajtjes, planit të ndertimit të aeroportit, Sistemeve të cilësisë dhe sistemit të menaxhimit mjedisor që japin informacionet e nevojshme për drejtimin.

2. Ndërmerr auditime teknike të punimeve faktike.

3. Ndërmerr auditime teknike të Shërbimeve dhe Punimeve të monitoruara nga Njësia e dedikuar e kontrollit të cilësisë e Koncesionarit.

4. Ka të drejtë të rrisë, me shpenzimet e Koncesionarit, nivelin ose shpeshtësinë e monitorimit, auditimit, testimin dhe inspektimit të objektit dhe respektimit nga Koncesionari të detyrimeve të veta në bazë të kësaj Kontrate, në atë nivel që Autoriteti Kontraktues ose Inxhinieri i pavarur e konsideron të përshtatshëm, sipas Kontratës së Koncesionit.

Kthimi

1. Mund të udhëzohet nga Autoriteti Kontraktues të kryejë një inspektim të objektit për të konstatuar nëse Koncesionari po i përmbush apo jo kërkesat e kësaj Kontrate dhe në veçanti nëse do të përmbushen Kërkesat për kthimin brenda Datës së përfundimit të vlefshmërisë.

2. Shqyrton dhe aprovon planin e vlerësimit për kthimin përpara fillimit të çdo pune nga Koncesionari.

3. Konsultohet me Koncesionarin në lidhje me përditësimin e planit të vlerësimit për kthimin sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet e kushteve të projektit ose të metodikës së vlerësimit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues ose nga personi i caktuar prej tij.

4. Shqyrton dhe aprovon procedurat e hollësishme të testimin dhe inspektimit sipas kërkesave të kontratës.

5. Bashkërendon me Koncesionarin të gjitha aspektet e planit të punimeve rinovuese për kthimin.

6. Merr në dorëzim dokumentacionin nga Koncesionari ku bëhet e ditur se Koncesionari i ka përmbushur udhëzimet dhe përfunduar detyrimet për çdo ndreqje siç e kërkon legjislacioni shqiptar në lidhje me ato fusha ku është dashur të merren masa.

7. I asiston Koncesionarit në kryerjen e Vrojtimit përfundimtar për kthimin në mënyrë që të përcaktohen se çfarë punimesh riparuese kanë mbetur pa u bërë.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurave konkurruese, si për qellim me përshatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

Funksione të tjera:

1. Certifikon që Trualli shtesë kërkohet nga Koncesionari për realizimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.
2. Jep opinion për pretendimet e Nënkontraktorëve dhe çdo dokument që lidhet me to. Aprovon dhe komenton Programin fillestar të Koncesionarit (ose shtesat dhe ndryshimet në të).
3. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit paraprak.
4. Kontrollon dhe vërteton nëse janë përfunduar Punimet e nevojshme për shfrytëzimin pa rrezik të aeroportit.
5. Vlerëson rezultatin e procedurës së dorëzimit teknik dhe konstaton nëse Koncesionari i ka përmbushur të gjitha Kërkesat e Autoritetit Kontraktues për punimet, ose informon Koncesionarin për çdo kundërshtim.
6. Konsulton Koncesionarin me qëllim arritjen e një marrëveshjeje për masat që kërkohet të merren në mënyrë që të arrihet përmbushja e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues në rast se ka kundërshtim.
7. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit .
8. Kontrollon dhe vërteton nëse Punimet janë përfunduar dhe se kushtet e përcaktuara në Certifikatën paraprake të Përfundimit janë përmbushur.
9. Përcakton se çfarë shtesash dhe ndryshimesh duhen bërë në Manualet e operimit dhe mirëmbajtjes në rast se Palët nuk merren vesh për shtesat dhe ndryshimet e duhura.
10. Konstaton nëse ka ndodhur ndonjë defekt, shkelje dhe/ose mosplotësim dhe afatin e ndreqjes në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me defektet e identifikuara dhe të nevojshme për t'u ndrequr.
11. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të kompensimit.
12. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të kompensimit.
13. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të lehtësimit nga detyrimi.
14. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të lehtësimit nga detyrimi.
15. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të forcës madhore.
16. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të forcës madhore.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

17. Njoftohet me shkrim për pasojat e mundshme të një Ndryshimi cilësues të ligjit që është bërë ose do të bëhet shumë shpejt.
18. I vihet në dispozicion një shpjegim i plotë dhe i hollësishëm dhe dëshmi në lidhje me Ndryshimin cilësues të ligjit dhe përfitimet e kërkuara, kohëzgjatjen e çmuar të vonesës në fjalë, çdo informacion përkatës që ka të bëjë me Ndryshimin cilësues të ligjit dhe humbjen e pritur të të ardhurave ose rritjen e kostove që vjen nga Ndryshimi cilësues i ligjit.
19. Jep opinion për arsyeshmërinë e propozimeve të Koncesionarit në Njoftimin për ndryshim.
20. Ofron marrje vendimi në përputhje me klauzolën në lidhje me Defektet e fshehta.

SHTOJCA 12

MANUALI I OPERIMIT DHE MIRËMBAJTES

(Shtojcë e cila paraqitet nga Shoqëria Koncesionare dhe rregullohet sipas dispozitave të kësaj kontrate)

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

SHTOJCA 13

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

(Shtojcë e cila paraqitet nga Shoqëria Koncesionare dhe rregullohet sipas dispozitave të kësaj kontrate)

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 14

PLANI I MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE

(Shtojcë e cila paraqitet nga Shoqëria Koncesionare dhe rregullohet sipas dispozitave të kësaj kontrate)

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 15

132

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim të pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

PËRFAQËSUESIT E PALËVE

f) **Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor**

Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është një person i autorizuar për të përfaqësuar Autoritetin Kontraktor në lidhje me realizimin e kësaj Kontrate.

Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është kreu i njësisë së zbatimit të Projektit, që krijohet nga Autoriteti Kontraktor për qëllimet e zbatimit të kësaj Kontrate, ose një person tjetër që caktohet nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zëvendësojë Përfaqësuesin e tij, për te cilin njofton me shkrim Koncesionarin.

Veprimet ose udhëzimet e Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, për aq sa parashikohen këtu, konsiderohen veprime ose udhëzime të Autoritetit Kontraktor, përveçse kur Autoriteti Kontraktor e njofton Koncesionarin paraprakisht që një veprim ose udhëzim i caktuar nuk është veprim ose udhëzim i Autoritetit Kontraktor.

Çdo kërkesë për t'i dhënë informacion ose dokumente Autoritetit Kontraktor, sipas Kontrates, është një kërkesë që dokumente të tilla t'i bëhen të njohura Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, përveçse kur Autoriteti Kontraktor e vë në dijeni Koncesionarin për një person tjetër të cilit i duhen dërguar dokumente të tilla.

Kur i dërgohet Autoritetit Kontraktor:

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nr.1 Tiranë

Ëeb:<http://www.infrastruktura.gov.al>

Për: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Njesia e Zbatimit të Projektit)

g) **Përfaqësuesi i Koncesionarit**

Përfaqësuesi i Koncesionarit është një person i autorizuar për të përfaqësuar Koncesionarin në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate.

Koncesionari mund ta zëvendësojë Përfaqësuesin e tij, duke i dërguar një njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktor të paktën 10 (dhjetë) ditë pune më parë.

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me përshtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

Veprimet ose udhëzimet e Përfaqësuesit të Koncesionarit, për aq sa ato parashikohen këtu, konsiderohen veprime ose udhëzime të Koncesionarit, përveç se kur Koncesionari e njofton Autoritetin Kontraktor paraprakisht që një veprim ose udhëzim i caktuar nuk është veprimi ose udhëzimi i Koncesionarit.

Për “.....” shpk

Kur i dërgohet shoqëria koncesionare:

Adresa:

Tel:

Email:

Për: VLORA INTERNATIONAL AIRPORT

SHTOJCA 16

MASTERPLANI

(Shtojcë e cila paraqitet nga Shoqëria Koncesionare dhe rregullohet sipas dispozitave të

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të perzgjedhur si me i suksesshmi.

kësaj kontrate)

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qëllim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.

SHTOJCA 17

SISTEMET E LUNDRIMIT AJROR

(Shtojcë e cila paraqitet nga Shoqëria Koncesionare dhe rregullohet sipas dispozitave të kësaj kontrate)

SHTOJCA 18

TE ARDHURAT MINIMALE TE GARANTUARA DHE PRAGU PER NDARJEN E TE ARDHURAVE

(Shtojcë e cila paraqitet nga Shoqëria Koncesionare dhe rregullohet sipas dispozitave të kësaj kontrate)

Ky draft kontrate, mund të ndryshohet, si në përputhje me dokumentet e procedurës konkurruese, si për qellim me pershtatjen me ofertën fituese dhe negociatave midis Autoritetit dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi.